

Gjush Sheldija (1902 - 1976)

## Kryepeshkvia Metropolitane e Shkodrës dhe Dioqezat Sufragane

( shënime historike )

Gjithsejt: 68 faqe  
Shkodër, 1957-1958

### **Përmbajtja:**

- Parathania nga Imz. Ernest M. Çoba Ipeshkëv, Ordinar i Arkidioqezat të Shkodrës.
- Përmbledhje e historisë së Shkodrës gjatë shekujve. Kronologjia e ngjarjeve që nga 360 para Krishtit deri më sot.
- Përshkrimi i qytetit.
- Randësia dhe ndryshimet historike të Kishës së Shkodrës.
- Themelimi dhe përshkrimi i Kishës Katedrale.
- Ngjarjet më të rëndësishme rreth Kishës Katedrale.
- Vargu i ipeshkvijve dhe arqipeshkvijve metropolitë të Arkidioqezat të Shkodrës.
- Shënime historike rreth dioqezeve sufragane me vargun e ipeshkvijve.
- Shtojcë
- Biografi e autorit

*Kolec Çefa*

### **H Y M J E**

Botimi i kësaj vepre ka qenë një dëshirë e largët, pothuaj e harrueme.

U njoha me këte daktiloshkrim në dhomën e Pader Marin Sirdanit, të cilin e shifshë tue e lexue e tue ba shënimet e veta. Një ditë, si e pashë të përqendruem mbi këtë daktiloshkrim, i thashë: "Pader, a mendon se do të botohet kjo vepër?" Ai, me buzë në gaz, m'u përgjegj: " Do të vijë dita e do ta botosh ti". Për vete ishte i sigurtë se nuk do ta shifte shembjën e komunizmit, për mue ishte i bindun. Disa vjetë ma vonë, u njoha me daktiloshkrimin në shtëpinë e autorit dhe aty dallova shënimet e Mons. Çobës, me atë shkrimin e tij karakteristik dhe ato të Pader Marinit, me atë shkrimin e tij të avashtë e të kujdesshëm. Kur u interesova ma vonë, daktiloshkrimi kishte "humbë" ndër arkiva, atëherë tabu për mue.

Kjo vepër monografike ka karakter divulgativ, por përmban material të pasun e të larmishëm, nxjerrë prej burimesh historike kishtarë, të pashfrytëzue prej historianëve të diktaturës, si edhe prej burimesh laike, të cilat përbajnë një sine qua non për historinë tonë kombëtare. Autorë të përmendun të historisë kishtarë, si: Farlati, Zeiller, Baroni,, P.Allard, Bolandistat, L. De Tillemont e deri te Cordignano e Valentini; historianë e medievistë, si: Taloczy, Shuflai, Jireçek, Mommsen, K.Paç; udhëpërshkrues e të huej që kanë njohtë e punue në vendin tonë, si: Ippen, Hecquard, Pouqueville e mandej autorë tanë shqiptarë, ma të vjetër e ma të rij; janë shfrytëzue shënime e ditare të famullisë, regjistra të vjetër kishtarë dhe asht pasunue me të dhana të mbledhuna nga tradita gojore e materiale të gjetuna në familjet shkodrane parë me sy që dinë të shohin e ndigjue me

veshë që dinë të ndigjojnë.

Lexuesi ka për t'u njohtë me ngjarje nga historia e Kryepeshkvisë Metropolitane të Shkodrës dhe me dioqezet sufragane që në zanafillë e sidomos në ditët e vona; me prelatët e Kishës e me ndihmesat e tyne kishtare e shoqnore; me pamje e ngjarje të qytetit tonë, pajisë me kronologji historike; me të dhana nga lëvizja artistike e kulturore e me përpjekjet për arsim e qytetnim. Në monografi ka njoftime për punime artistike, tashma të zhdukuna nga diktatura, me dhunimin e Katedrales tue e kthye në pallat sporti. Duhet ta ilustroj me nonjë shembull: lexoni punën e madhe që kan ba piktorët e skulptorët Kolë e Arsen Idromeni, për të cilat nuk flasin biografët e Kolë Idromenos, skulpturat e Fratel Salës, zanafillen e veprimtarinë e bandave etj. etj.

Materialet e shumta, herë-herë tue u hapë e kapërcye qellimin e veprës e dobësojnë kompozicionin e saj. Gjuha gegnishte e veprës, sado që asht zbutë e afrue me të sotmën që të bahet ma e lehtë e ma e kuptueshme, prapëseprapë ka edhe ndonjë inkonveniencë, për të cilën kerkojmë të falun, por asht punue me një fotokopjim të paqartë, madje, ndoshta, të daktiloshkrimit jo përfundimtar e jo të përgatitun për botim.

Materiali i dhanë në vepër mund të ketë edhe mangësi e pasaktësi, prapëseprapë po ia dhurojmë lexuesit tanë, sepse asht një kontribut për njohjen e vendit tonë.

**Imz. Ernest M. Çoba, Ipeshkëv, Ordinar i Arkidioqezës së Shkodrës.**

## P A R A T H A N I E

Kishën Katedrale Metropolitane të Shkodrës populli, me të drejtë, e quen Kisha e Madhe, pse asht Kisha ma e madhe në Ballkan. Me entuziazem Parvet Opus për përfundimin e lterit të ri artistik, i cili po shugurohet shi sot në kishë, me rastin e 100-vjetorit të Bekimit të Gurit të parë prej shkruarit të Kryesisë, në sa Gjon Shllaku e Martin Trushi po kryejnë së kopjuemit punimin që studiuesi i vendit tonë, Gjush Sheldija, pat mirësinë me ia dhurue Klerit katolik shqiptar me rastin e këtyne kremtimeve.

Shkrimtari i zellshëm veprën e paraqiti me titullin e kauzalitetit të qindvjetorit të Katedrales, me thanë të vërtetën vepra asht shumë e hapët e po përfshinë një pjesë mjaft të gjanë të historisë së Kishës dhe të qytetit të Shkodrës që në kohët e vjetra, tue bamë një përmbledhje të veprimtarisë së gjithë dioqezave sufragane të Shkodrës dhe një kronologji në bazë të ngjarjeve ma të randësishme të historisë së Kishës sonë.

Por, sikurse në çdo vepër tjeter njerëzore, në mes të shkëlqimit dallohen edhe të metat, lusim të ndershmin lexues të ketë mirësinë me na sjellë shënimet e kritikën e veta, me qëllim që vepra të dali sa ma e vertetueme, për të kenë vertetë një kontribut për historinë, sidomos kishtare të vendit tonë.

Ky asht dishiri i autorit e najazi i të nënshkruarit që pat nderin të bashkëpunojë me të vlerit autor në rreshtimin e kësaj vepre.

Qytet, 19.IV.1958

## H I S T O R I A E S H K O D R Ë S

Paraqitja: Atij që vjen nga ura e Drinit, Shkodra i paraqitet si e mbyllun prej një perdeje

të madhnueshme e njiherit të frikësueshme: nga e majta zbret kah qyteti vargu i gjatë që, tue u nisë prej Rumie, mbaron me Taraboshin, buzë Bunës. Prej së djathti, ma larg, mali piktoresk i Sheldisë i kunoruem me do dardha të mëdha të vetmueme. Barleti e quejti Mali Sardonik për shkak të qytetit meskohuer të Sardës që ka në rranxën tjetër kah lindja; ky prej malit të Shën Markut nga Veri e prej Jugut me kalanë e Dejës. Mes Taraboshit dhe malit të Sheldisë shtrihet një varg kodrash gurakeqe; ma e nalta që duket se zatetë në ballë për t' i pre udhën shtegtarit me atë profil të vetin të këputun e të kunoruem e me atë brijë thik, asht Rozafa. Në kohë të vjetër e të mesme qyteti shtrihej rranxë kodre, i ruejtun prej kështjellës që i çelë dyert e bahej strehë në rasë lufte. Kohën e Venedikut prej luftimevet të padame dhe kërcenimesh, banesat mbetën shkret dhe bile u rrafshuen fare për t' i dhanë mundësi mbrojtësve për të pengue sa ma shumë sulmuesit anmiq. Lulëzoi mandej rishtas qyteti në pagjë për dyqind vjet, mes fiqve dhe shegave që blerojnë në rranxa, derisa në shek. XVIII malarja nisi me e shkretue tue e shty popullsinë kah veriu.

Shkodra e sotme në fushë të hapët, asht e re mjaft për kah mosha, por e moçme për kah stili. Secila shtëpi ka oborrin me lule të ndryshme dhe kopshtin me pemë e barishte gjithfarësh. Për shtëpiat do të flasim në një kapitull të veçantë.

Shkodra (Scodra në transkriptimin latin) qe së pari qytet i ilirëvet Labeatë prej të cilëve mori emnin edhe Liqeni: Palus Labeatis, ma vonë kryeqytet i mbretenvet ilirë që, si thuhet, e shtrinë sundimin që prej Friulit deri n'Ambrakje në kufi të Greqisë.

Me rrugë të hapun kah deti, n'ato kohë të lashta, i a shtini tmerrin Adriatikut mbarë ku shtynte anijet liburnike të vetat.

Kështu, pak a shumë, vazhdoi deri në shek. II para Krishtit e, kur u kthye Genci, u quejt "oppidum civium romanorum" nder dokumenta romakë dhe ka gjasë, sepse, siç u vertetue ma vonë, ilirët mbërrijtën me hypë nder zyre të nalta romake dhe deri me u ba perandorë, si p.sh. Probi, Valentiniani, Diokleciani etj., etj.

Rrebeshi sllav i kohës së mesme e bani "xhevahir i kunorës së Rashës" e për një kohë prove, të princit trashigimtar të Derës së Nemanjes, i cili banonte pak larg qytetit, n'at vend që Venedikasit vijuen tue e quejtë "La corte de lo imperator"; kjo krahinë, ndoshta, në kuptim të atyne princavet që bajshin titullin e vjetër ilirian "Jupan" ase "Zhupan", toponimet e të cilëve i ruen sot Jubani dhe Zhubi.

Si ra poshtë dera e Nemanjëve në shek. XIV, trashigimin i a muer në mbarë Zeten me kryeqytet për do kohë Shkodrën, dera e Balshajvet, që shtrini zotimin deri në Vlonë.

Vjetin 1396 ia shiti Venedikut bashkë me Drisht e me Dejën e vazhdoi me kërkue kthimin, derisa në vitin 1420 mbylli sytë ma i mbrami pinjuell i familjes.

Venediku ia besoi sundimin një proveditori në rasë lufte dhe rektori në kohë paqeje.

Administrata civile, gjyqi i paqit, gjyqi civil e penal i mbështeteshin këshillit populluer (Senati) vendas simbas zakoneve të vendit.

Mbasi ra në dorë të Turkut, më 1479 populli mori arratinë dhe një pjesë mergimin; mirëpo qysh në fillim të shek. XVII populli i malevet filloi me iu afrue qytetit dhe xunë vend në Kazenë; një pjesë pa ndërrue fe, muer sherbim në roje të kështjellës. Mandej afer 1700, tue marrë mbrapa viçekonsullin venedikas Duoda (shqiptar me fis i kthym n'atdhe të vjetër) nisi qyteti i ri kah veri, nder lagjet Tophanë, Parrucë, Perash, Gjuhadol e Rëmaj. Në vjetin 1392 u dukën afer Shkodrës turqit dhe me 1396 Shkodra hyni nën sundimin e Venedikut dhe tre vjet mbrapa d.m.th. me 1399 plasi një kryengritje e madhe kundra Venedikut që pati si përfundim fitimin e disa të drejtavet, mbasi gjyqi i paqit, gjyqi civil

dhe penal, administrata bashkiake ishin në dorë të këshillit populluer (Senatit) dhe të gjyqtarëve vendas simbas zakoneve të vendit; në këtë këshillë merrshin pjesë pesë vetë nga vegjelia dhe pesë nga parësia. Sundimtari venedikas kishte përbri edhe një përkthyes. Të hymet asokohe ishin të pakta: dogana, konçesionet e dajlanavet dhe taksat nga pronarët, ndersa shpenzimet ishin ma të mëdha për të përballue forcimet, me mbajtë ushtrinë dhe pagesa "për një politikë afrimi kundrejt princave të vogjël të vendit". Në këtë kohë Shirqi ishte skelja e Shkodrës prej kah eksportoheshin landë ndërtimi, lëkura, peshk i thatë, sidomos saraga, putarga dhe njala të krypuna.

Shkrimtarët Gopçeviq dhe Hecquard vërtetojnë se Venediku bani shumë meremetime në kështjellë të Shkodrës dhe, ndër të parat punime me karakter të përhershëm, qe ndërtimi i saranxhave në vitin 1394 ku mblidhej ujët e shiut me anë akuaduktesh gurit të gjallë dhe derdheshin mbrenda për ta pasë si depozitë në rasë qarkullimi nga anmiku. Këto shifen edhe sot dhe ka ndonjë që ujët e depozitue e ruen aq mirë dhe pastër, sa jo vetëm që mund të pihet, por edhe nuk i len gja mangut ujit të pusave të qytetit.

Prej viti 1461-1474 vazhdoi forcimi i murevet të kalasë ku punuen mjeshtra vendas dhe dalmatinë; mbrenda kësaj kohe u muer pjesa verilindore që ishte pronë e familjes shkodrane Jonima tue i dhanë si shpërblim për këtë ndërrim tokë afër kishës së Shëna Vlashit, ku tani asht Hamami. Në vjetin 1474 turqit e mësyen Shkodrën nën komanden e Sulejman Pashës, i cili e mbajti të rrethueme prej 17 majit deri me 17 gusht, por pa muejtë me e shtie në dorë.

Në pranverë të vitit 1474 Sulltan Muhameti II erdhi vetë me 150.000 luftarë, 10.000 deve me topa e municione. Kuartierin e përgjithshëm e nguli në Berdicë, në kala të Katalinës, shatorret tjera te Gomna e Harapit dhe topat, me metal që kishte pru nga Anadollu, i shkriu në lagjen Tophanë që thuhet se qysh atëherë i mbet ky emën. Më 27 Qershuer 1477, tue kundrue nga Gomna e Harapit kështjellën e Shkodrës, tue pa madhninë, bukurinë dhe qendresën heroike të të qarkuemve, tha këto fjalë: "Sa çerdhe të bukur paska zgjedhë shqipja me ruejtë zogjtë e vet". Dhe, me të vertetë; tue mos dijtë kurrsesi me e shtie në dorë, u drodh i koritun kah Stambolla, mbasi kishte hjedhë mbi kështjellë 3000 gjyle hekurit dhe aq gurit ! Në dalëzotje të kalasë luftojshin me trimni të pashoqe vetëm 1.600 shkodoranë nën prijësin Bartolome Epiroti, domenikan dhe të Palit prej Matit, françeskan. Marin Barleti dishmon açik se asht shqiptar, kur thotë se në fjalimin trimnues që u mbajti në tri gjuhë luftarëve mbrojtës: italisht venecianëvet, sllavisht mercenarëve dhe... "tash po sillem e u flas të mijve", u flas shqip shqiptarëve. Kur dolën nga rrethimi të dy vojtën në Venedik, ku u pritën me nderime të mëdha nga ana e Senatit.

Për të vazhdue qarkimin la këtu Ahmet Evrenoz Pashën me 40.000 ushtarë ku ishin ma të zgjedhunit.

Ngushtue prej ujet dhe paksue numri i mbrojtësavet, me 25.I.1479 Shkodra ra në dorë me qyshke të ndershme:

1) Me marrë me vedi armët;

2) Me marrë plaçkat sa mund të barshin

3) Me marrë të gjitha enët shejte dhe gjanat e kushtueshme. Pasha dhe vetë ushtarët dhe oficerat turq mbetën të mrekulluem, kur panë tue dalë andej vetëm 450 ushtarë që kishin teprue dhe 150 gra e pleq.

Gjergj Merula, i cili ka ndodhë në kështjellë nder të rrethuemit, e pershkruen bukur e thekshëm qendresën heroike të shkodoranëve dhe ndërsa tjera, tregon se vetëm luftëtarëve u epej me pi nga një putir ujë çdo 24 orë dhe për gjellë kishin nga një grusht krunde të

kavertisuna, sepse bukë nuk kishte për askënd.

Pak para se të ngushtohet qarkimi, pleq, plaka, fëmijë, të paftë për luftime kjenë çue n'Ulqin, ndër të cilët ndodhej dhe Marin Beçikemi, një ndër humanistët e përmendun të mesjetës; ky e ndoq për së afërmi luftën heroike të dalëzotësve të Shkodrës, sikurse e dishmon në fjalimet e tija që mban në rasi të ndryshme.

Me ramjen e Shkodrës në dorë të turqve, qyteti u rrafshue, populli mori arratinë, kush maleve e kush në mërgim. Ndër familjet që dolën nga Shkodra kjenë ndër të tjera edhe këto: Bogana, Zakarija, Negri, Martini, Spani, Zoima, Dukagjini, Dulçikja, Mateu, Milutini, Angjeli, Kalaci, Jak Moneta, Pjetër Pojani, dhe prifti shkodran Marin Barleti.

Për do kohë qyteti mbet shkret dhe popullsisë së vjetër, ia xuni vendin një koloni turke; turqit kishin prur me vedi, të marrun nga fundi i Anadollit disa vetë për shërbime kuajsh dhe, kur pushtuen qytetin, kërkuen me u riatdhesue, por komanda ushtarake nuk i lejoi dhe kështu derguen e morën familjet e tyre dhe xunë vend në anën veriore të kështjellës. Këta qënë magjypët e soçëm: andej fjala shkodrane se "Shkodranë janë vetëm magjypët". Dalëngadalë popullsia e krishtënë e maleve filloi prapë me iu afrue qytetit; një pjesë xuni vend në lagjen Kazenë pa ndërrue fe, të tjerët i islamizuen.

Me 25 prill 1467, ndjekë prej dy shkodranëve, Gjergji e De Sclavis, fugurja e Zojës së Këshillit të Mirë që ndodhej në Kishën e Nunciatës bri kalaje, iku këtej dhe vojt e xuni vend mbi muret e Kishës së Shëna Vlashit, në Gjenacan, që kishte nisë me rindertue plaka Pjetrushë, në orën katër mbas dreke, në praninë e një shumice të madhe të popullit që kishte rrâ aty për festë. Shtëpia e de Sclavis u shue në shek. XVII, ndersa ajo e Gjergjit vazhdon edhe sot. Imzot Dillon e çoi pemën e gjenealogjisë deri në Gjergjin, më 1467. Benedikti XIV, më 1753, botoi "Bulla-n" Iniunctae nobis që do të thotë se në katund të Gjenacanit gjindet kapela ku nderohet fugurja e Virgjinës Mëri, e Këshillit të Mirë e cila, si thotë gojëdhana, qe bartë prej engjujve nga Shkodra e çue aty.

Me 9 fruer 1753, Z. Kolë Kamsi, dishmoi me betim para dy vetëve, Guido Mondì dhe D. Gaspër Azzurri (Curri) që e shoqnonte prej Shkodre, sa vijon:

1. Para se me u pushtue qyteti i Shkodrës prej turqve, fugurja e Zojës së Këshillit të Mirë, nderohet në Shkodër në një kishë të vogël.
2. Kisha e vogël e rrethue nderohet gjithnjë, sepse gojëdhana thotë se aty ishte dikur fugurja e shejtë.
3. Të krishtenët në nevojë vrapojshin në atë kishë me gjetë nderna.
4. Ndashkimet që kishin pasë dy vetë: i pari, se kishte dashtë me e shndërrue në xhami dhe i dyti se kishte marrë me ndertue një urë.
5. Se kisha e gremisun kishte tri të ndame; mjedisin me gungë, e qemer, dy tjerat anash ende me pikëzime shenjtnish në mur, pa pullaz, gjysmë mil larg Shkodre, ishte e vendosun bri kodre ku derdhej Buena."

Me 1742, Imzot Pal Kamsi, ipeshkëv i Shkodrës, Dom Ndoc Borci, Dom Gjon Kabashi e ma vonë Dom Ndue Logoreci, Dom Shtjefen Predanji përforcuen thaniet e siperme.

Asokohe lagjja thirrej Alibeg Mahallasi.

Me 8 korrik 1878, shkuen me vërejtë rrenimet e kishes, A. Giampiero da Bergamo, prefekt Apostolik i Misioneve të Kastratit, Imzot Engjëll Radoja, famullitar i Shkodrës, Dom Pashko Junki, Fr. Anselm da Gorle, e vulosë prej Imzot Karl Pootën, Arqipeshkëv i Tivarit e i Shkodrës, i shkruen A. Belgrano agustinian tue i rrëfye gjanë e gjatë hetimet dhe rrëfimet e tyre që përputhen me sa u shkruet për fjalët e Kamsit, e se lagjja aty dikur e

banueme, tashti s'kishte tjetër veçse muret e rrenueme të kishës.

Me 1896 sundimtari i vendit deshi me pengue shtegtinë aty, por populli mbarë u çue peshë dhe protestoi e qe tue shkue puna gjatë, mos të nderhynte konsullata austriake. Imzot Guerini në formë miqësore nxori nga Hafiz Doçi mos ta kryente një ndertesë të fillueme aty pari.

Në vitin 1577 plasi një kryengritje e madhe kundër turqve në Shkodër ku morën pjesë 20.000 vetë dhe mbas një luftimi të rreptë dhe të përgjakshëm që u ba te "Lama e Spahive" (ndermjet Urës së Madhe dhe Urës së Kirit) ushtria turke u thye keqas dhe shkodranët fituen të drejtën që me kenë të qeverisun nga sundimtarë vendas dhe për këtë arsye u vunë Begollejt e Pejës. Të tjera kryengritje me randësi kjenë ba edhe ndër vjetët 1602-1614, por ma e madhja qe ajo e vitit 1647 që, po t'u printe mbarë lufta, shkodranët patën me e fitue lirinë e pavarësinë qysh atëherë.

Në vitin 1621, në vjeshtë, Imzot Pjetër Budi, nësa Turqia ishte e xanë në luftë me Poloninë, përgatiti një kryengritje të përgjithshme kundër Turqisë dhe shtroi planin e luftës për çlirimin tue përcaktue edhe numrin e luftarëve që përmblihdeshin në 30.000 vet, dhe i njoftoi Vatikanit me letër se asht marrë vesh me krenët e vendit, myslimanë e të krishtenë. Pesë herë shkoi në Romë, për t'i kja hallin Shqipënisë dhe me kërkue ndihmë, po t'mos ishte vdekja e papritun, qe mbytë në Dri në vitin 1623, ndoshta Shqipnia do të ishte shkëputë që asokohe nga zgjedha turke.

Kah gjysa e shek. XVIII Mehmet Pashë Plaku, i derës së Bushatlijve që rrjedhin nga shtëpia e Jakajve të Gojanit, thirri për drekë pashën turqeli që sundonte Shkodrën dhe e mbajti aty peng tue e shtrëngue me i shkruie Derës së Lartë se kishte ardhë koha që vendi të qeverisej nga sundimtarët vendas. Stambolla e pranoi dhe e emnoi sundimtar Mehmetin, të cilit iu dha titulli Pashë. Mbas tij sundoi Mustafë Qorri, trim e i mendshëm sa ta lypish, por qe helmatisë nga dy gra të haremit që ia kishte çue peshqesh Stambolla. Ia xuni vendin Mehmet Pasha e mbas tij Kara Mahmut Pasha, i cili me 25.II.1787 u pajtue me Mirditë e me ndihmen e tyne thei turqit në një luftë kryengritëse dhe në vitin 1796 i qe pre kryet në luftë. Kryet e tij gjindet i balsamuem në Muzeumin e Cetinës. Ia xuni vendin Brahim Pasha, por ky tue kenë fanatik çarti gjithë punën që kishte ba Kara Mahmuti dhe si vegël e verbër e Stambollës, ngjalli ngatërresa e përçamje ndermjet myslimanëve dhe krishtenëve.

Mbas tij hypi në sundim me dredhi e dhelpni Mustafa Pasha, i cili ndertoi Bexhistenin, i dha lulëzim tregtisë, siguroi udhën e Kosovës nga kusarët, por bani krimin e madh tue zhbi kulm e themel familjet kundërshtare të tijat, Dervishajt, Çausollajt e Gjylbegajt dhe tue vramë në befasi Mehmet Begun të nipin, dhe tue helmatisë në burg dy nipat e tjerë, Dervish Begun e Tahir Pashën me dorën e dajës së tij Xheladinit. Tue dashtë me i dalë doret Turqisë më 1831 shpalli luftën dhe u thye në Babune, ku mbet i vramë edhe kumbara i tij Gjon Leka i Gegajvet të Shllakut i cili i shpëtoi jetën Mustafës. Erdh e u ndry në kështjellë të Shkodrës e ra në dorë; qe lidhë e çue në Stambollë bashkë me të birin e me një djalë që mbante mbas vedit si besnik. Gjykata kishte dhanë vendim me ia pre kryet. Sadrazemi, kryeministri, ishte mik i ngushtë i Mustafa Pashës. Kur mori vesht lajmin e dënimit me vdekje besniku i tij Mustafë Suma i cili i përngjante shumë nga fytyra, iu lut t'i jepte teshat e tij dhe të shkonte ai me u pre për te.

Të nesermën ndersa Sulltani drejtohej kah Ajia Sofija me falë Xhumanë, i biri i Mustafë Pashës i doli para dhe iu lut me ia falë babën. Mbreti për ta largue i premtoi se po, dhe në atë çast doli Mustafë Pasha i gjallë. Si i treguen gjithshkafen, i fali jetën dhe e emnoi

sundimtar Vali në Diarbekir. Vdiq dhe u vorrue në Stamboll.

Mbas Bushatlijve erdhën pashallarë turq.

Në vitet 1834-1835 një tjetër kryengritje e madhe plasi në Shkodër nën udhëheqjen e fshatarit Dasho Shkrelit, e cila ngujoi në kështjellë Valinë, Ali Namikun dhe gjithë ndihmën e madhe që erdhi nga Stambolla, 8 batalione nën urdhënat e Hafiz Pashës dhe të Mahmut Pashës të Rumelisë, mbet i rrethuem për gjashtë muaj rresht dhe kështu valia që i shtrenguem me kërkue një marrëveshje dhe me ba një falje të përgjithshme; falja që sa për faqe, sepse, ma vonë, Ymer Pasha shtroi Shkodrën, xuni dhe burgosi parësinë e vendit dhe udhëheqësit e kryengritjes dhe i mergoi në Anadoll.

Simbas Pouqueville, konsull francez, Shkodra si qytet kishte 18.000 banorë.

Me 1856 Valia i Shkodrës, Menemenli Mustafë Pasha, krijoi Komisionin e Xhibalit tue vu në krye si sergjerde Haxhi Agë Lohen.

Prej vitit 1844 deri 1875 Shkodra ndej krejt në qetësi.

Në "Lidhjen e Prizrenit" Shkodra mori pjesë aktive dhe pati përfaqësues në komisionin drejtues dhe si komandarë të Ushtrisë Vullnetare kjenë Hodo Beg Sokoli, Bibë Doda dhe anëtar i komisionit Shan Deda, të cilët me armë mbrojtën, së parit Plavë e Guci, e mandej Ulqin e Tivar, por qenë trarhtue prej vetë qeverisë turke e cila i xuni dhe i internoi në Azi të Vogël, Kastamun, ndër të cilët edhe Rust Marku i Dushit të Pukës. Lidhja e Prizrenit u quejt "Lufta e Miletit" (popullit).

Me 10 korrik 1908 u shpall Konstitucioni dhe në Shkodër u banë kremtime të mëdha tue kujtue dhe shpresue se njimend u fitue njifarë soj lirie, por nuk vonoi shumë dhe ia behi Shefqet Turgut Pasha, i cili çarmatosi, xuni dhe burgosi atdhetarë të vërtetë dhe bani njëmijë dhunë sidomos ndër malsinat kah shkeli kamba e tij shfarosëse, por i ndeshi sharra në gozhdë në Malsi të Madhe dhe në Dukagjin e u nda me faqe të zezë. Me 23.III. 1911 filloi Kryengritja e Malsisë së Madhe.

Me 6 prill 1911 Dedë Gjo Luli , ngriti flamurin kombëtar në majë të Deçiqit; ai flamur ruhet sot në Muzeun Historik të Tiranës. ( Sot i zhdukun, shënim i red. ).

Me 21 tetuer 1912 plasi lufta Ballkanike e Shkodra qëndroi e rrethume per 7 muaj rresht; 36.000 gjyle u hodhën mbi qytet, por Shkodra nuk ra në dorë. Vetëm trarhtia e Esat Toptanit bani që këtu të hyjshin malazetët me 23 prill 1913. Ai ia kishte shitë që me 19 mars 1913 për dy milionë florinta. Malazetët e krajl Nikollës, Petroviq Njegosh, qenruen deri me 24 maj të atij vjeti dhe punen ma të parë që banë, xunë dhe internuen në kala të Shpuzës një grusht patriotësh që nuk dojshin me iu përulë sunimit të huej. Në kaq u muer vesh Shpallja e Pavarsisë Kombëtare në Vlonë. Me 7 mars, në sa këtu sunojshin 5 Fuqitë e Mëdha, që naltue në kështjellën Rozafat flamuri kombëtar. Në këtë rast u ba një miting i madhnueshëm në kala, ku morrën pjesë i madh e i vogël. Fjalimin e mbajti Karlo Suma.

Si plasi lufta botnore dhe dolën internacionalët, qyteti me rrethe kaloi një periudhë anarshie dhe veprimi të dobët, sepse Esat Pasha kishte ngjallë fitme dhe ngatrra e kishte asish që kërkujshin ende Turqinë. Në vitin 1916, si thyen Malin e Zi dhe Krajl Nikolla u përshkue nëpër Shkoder i merguem, u futën ushtritë Austro-Hungareze që ndejtën deri me 1918 tue ia lëshue vendin një komisioni aleat.

Rreth vjetëve 1920 ndodhi lufta e Koplikut në të cilën mori pjesë Shkodra me rrethet e malsinat në dalëzotje të lirisë të cilën dojshin me ia grabitë disa shovenista serbo-malazet, me 1921 ngjau kryengritja e Mirditës kryesue nga dera e Gjonmarkajve kundra

qeverisë qendrore të Tiranës, edhe në këtë, Shkodra mori pjesë vullnetarisht për shuemjen e saj.

Në vitin 1920 Shkodra u bashkue me qeverinë e Tiranës dhe ushtria shqiptare u prit me entuziazmin ma të madh.

Me 6 qershuer 1924 plasi kryengritja kundra Ahmet Zogut dhe shkodranët, malsorë e fshatarë moren pjesë vullnetarisht.

Me 24 dhetuer 1924, Ahmet Zogu me ndihmen e vrangjelistëve dhe të Pasiqit kthehet në Shqipni dhe në Shkoder krijohet gjykatorja politike ushtarake tue dënue dhe varë patriotët që e urrejshin rregjimin e tij. Ndër të tjera, shtini me vra në Bari të Italisë Luigj Gurakuqin, me 2 mars 1925.

Me 1926 shpërthei Kryengritja e Dukagjinit dhe mos të ishte trathtia në mes, malsorët patën me u futë në Shkodër, me marrë sundimin në dorë, mbasi kishin arrijtë deri te Ura e Mesit. Përshtypje jashtëzakonisht të madhe bani në popullin e Shkodrës varja në litar e priftit katolik Dom Gjon Gazullit, me 4.III. 1927.

Kur Italia fashiste sulmoi Shqipninë, me 7 Prill 1939, djelmnia shkodrane kërkoi armë për dalëzotje, por i qenë mohue: me gjithëkëtë, këmishat e zeza të qeverisë fashiste i pritën nga kalaja dhe nga brigjet e Drinit të turbullt me pushkë në faqe. Dishmi e gjallë qe vrasja e Toger Bombigi te Ura e Drinit.

Si përfundim, del se kurr populli shqiptar nuk e duroi zgjedhën e huej dhe kjo, kur për rrethana të ndryshme u sipërvu me forcë, populli nuk ndej gjatë, por me armë në dorë kërkoi me shkundë robninë dhe me fitue lirinë. Le të mjaftojë me çekë luften e madhe që banë fiset ilire të bashkueme dhe të prime nga trimi Bato i cili, tue u nisë nga Mirdita, mësyni Shkodren dhe kaq të haptë mori kjo lëvizje, sa që në Senatin e Romës u tha: "Në kjoftë se na nuk marrim masa për ta shue këtë kryengritje shpejt, kemi për t' i pa aradhet iliriane përpara mureve të Romës" dhe, kur lufta nga fitorja u suell në humbje, gratë iliriane morën pjesë vepruese në te dhe të rrethueme për anë nga anmiqtë parapelqyen me i dhanë zjarr banesave të tyne dhe me u djegë mbrenda për së gjallit me fëmijë se sa me u dorëzue n'dorë t' anmikut. Velleius Paterculus, historian romak, tregon se ilirët banë 200 e sa kryengritje kundër Romës për pavarësi. Ma të përmendunat ato të vitit 153 para Krishtit, e të vitit 49 para Krishtit të cilën e përmendë edhe Jul Çezari, ajo e vitit 35-33 para Krishtit shtypë nga Oktaviani. Krye dhjetë vjetësh një kryengritje. Një tjetër luftë e madhe u ba rreth mureve të kështjellës, kohën e Balshajve kundër invazionit turk ku mori pjesë i tanë populli pa përjashtim. Kur në fillim të verës së vitit 1474 ushtritë turke qarkuen Shkodrën, populli mbarë u çue në kambë dhe ndihma ma e madhe që u dhanë drishtianët bani që qarkimi të hiqej me turp t' anmikut. Kjo provohet fare kjartë sepse, kur me 1477 Sulltani përsëriti qarkimin e Shkodrës për të shfrye idhnimin e e sulmoi dhe e bani rrafsh për dhe, pjesa ma e madhe e mbrojtësve të Drishtit u përshkuen nën shpatë dhe vetëm një pakicë mujti me marrë malet përprjetë tue u strukë si shqype të lehta, të gatshëm me i ra anmikut të pabesë. Në vitin 1602 një tjetër kryengritje u ba kundër feudalëve që xuni fill nder malet e veriut dhe sigurisht në Kelmend. Mbas ramjes së Bushatlijve, një tjetër kryengritje me karakter populluer qe ajo e kryesueme nga fshatari Dasho Shkreli, i cili çoi në kambë mbarë malsinë dhe mbërrijti deri në dyert e qytetit. Në vitin 1910 plasi Kryengritja në Kosovë e cila mori të hapët nëpër viset e veriut dhe malsorët e Hotit, Grudës, Traboinës, luftuen kundër ushtrisë turke dhe sundimit despotik për të shkundë zgjedhën robnuese dhe Turqia, tue drashtë mos të marrin të hapët në të gjithë Shqipninë kjo lëvizje, u detyrue të japi disa të drejta ndër të cilat: "Njohja e



Shqipnisë ndër katër vilajetet; Shkodra, Shkupi, Janina, Monastiri; emnimi i nëpunësve shqiptarë nder zyre qeveritare; kryemja e sherbimit ushtarak në vend; hapja e shkollave shqipe, etj." Grushti ma i madh që iu dha Turqisë që lëvizja e Malsisë së Madhe në vitin 1910-1911 e cila e diskretitoi politikisht edhe në botën e jashtme. Kryengritja e Qershorit e vitit 1924, lëvizja e Shalës e vitit 1926, janë provë e gjallë e mospërfilljes së rregjimit shtypës të Zogut, lëvizje këto që u mbytnë me gjak.

### **Randësia politike dhe ekonomike e Shkodrës**

Gjatë shekujve, Shkodra pati randësi të madhe politike dhe ekonomike, tue qenë kryeqytet i Ilirisë, ushtroi ndikimin e saj nëpër mbarë vendin. Mjafton të përmendim kohën e mbretshës Teuta, e cila nuk duroi fyemjet e delegatit romak. Për vertetim të kësaj le të shikohet : "Tillemont, Histoire des empereurs; "Illyricum Sacrum" të Farlatit; "Origines...", Zeiller; "Acta et diplomata" të Taloczit..., Regestat, e Beeck; Enciklopedinat dhe leksikët e Pauly Wisova, Onomasticon e Perin, Nomenclator i Hurtet, Zedda e Gelcich, Chronologie e Kersopoulos, Perin, tekstet e Ministrisë së Arsimit, etj. Prej Shkodre niseshin udhë që futeshin thellë në mbarë gadishullin ballkanik; një rrugë delte nga Shkodra dhe merrte drejtimin kah Epicaria (Puka). Përshkonte Theranden- (Prizrenin) dhe soste në Naissus- (Nish). Tjetra për te gjatë liqenit kalonte nëpër brigje të Hotit e futej thellë në Mal të Zi. Tjetra drejtohej nga Ulqini e çante fill për Budve (Budua) dhe përshkonte Dalmatinë bregdetare. Një rrugë, tue përshkue Zadrimën, ndalej me atë të Pukës, pjesa tjetër vazhdonte për në Durrës ku prej këtu coptohej në dy drejtime: Njena me anë anijesh nisej për Brundusium (Brindisi) e tjetra për të gjatë udhës Egnatia ndalej në Peqin ku një gem merrte drejtimin kah Vlona, Saranda e soste në Prevezë; tjetra vazhdonte për në Ohër e deri në Bizanc (Stambollë). Në këtë mënyrë Shkodra epte e merrte me krejt gadishullin Ballkanik e me botën e jashtme. Kohën e pushtimit romak, nyjet e udhës kryesore, natën, ndriqoheshin me flakadaj që ndezeshin majë kështjellavet si në Drisht, Bajzë, Medun, Sardë, Gajtan, Vadejë, Shurdhah, Pukë, Lezhë, Shkodër, etj., etj. Kohën e sundimit venedikas, randësi të madhe pati limani i Shirqit që lidhte Shkodrën me det.

Deri para se të hapej hekurudha Shkup-Selanik, Shkodra qe qendra ma e randësishme e krejt Ballkanit; ndërtimi i limanit të Tivarit i dha shkas ramies së Shkodrës tregtare dhe ngushtimi i hinterlandit mbas luftes ballkanike ia këputi krejt uzdajen e një ringjalljeje. Ndër 3000 dyqane që pati Shkodra, puna e dorës dhe artizanati fituen pëlqimin jo vetëm të vendasve, por edhe jashtë shtetit, e calinat, kuburet, e fabrikueme këtu, petkat kombëtare të qendisuna me gajtana e terija mëndafshit dhe florinit, punimet artistike në telish, të argjendarëve dhe të kujxhijve shkodranë kërkoeshin me ngulm nga jashtë, nga Genova, etj.

Karvanet niseshin nga Shkodra e merrshin drejtime të ndryshme tue bartë e çue mall e prodhime vendi. Një karvan nisej nga qyteti, drejtohej në Mal të Zi e futej thellë deri në Bosnje e Hercegovinë tue dergue kostume folkloristike të gatshme dhe tue pru landë për punime bakri; i dyti nisej nga Shkodra, merrte udhën kah Tirana, nëpër Elbasan dhe mbaronte në Selanik tue çue e pru mallna të ndryshme. Një tjetër përshkonte bregun e detit dhe mbërrinte deri në Janinë. Një karvan dores së dytë ishte ai i Qafës së Pejës gjatë stinës së mirë. Karvanet në përgjithësi udhëtoeshin në fillim të vjeshtës, në prendverë e

gjatë verës, ndersa dimnit nuk ishte e mundun për shkak të bornave. Ishte edhe një karvan tjetër zyrtar i quejtun "Karvani i Tartarit", i cili binte krye çdo tre muejsh rrogat e ushtrisë dhe të nëpunësve.

Si kryevend Vilajeti i Shkodrës pat edhe trup konsullor t'akredituem si Austro-Hungaria, Franca, Rusia, Italia, Mali i Zi, Anglia e qe një kohë që pat edhe Greqia e Serbia.

## K R O N O L O G J I A

### **Nga legjendat:**

Pellazgët themelojnë Dodonën.

Kelkët themelojnë Ulqinin.

Pirro Neoptolemi, i biri i Akilit, bahet mbret i Epirit dhe themelues i dinastisë së Paridëve.

Heleni, i biri i Priamit, themelon Butrintin.

Kliniku, i biri i Hyllit, mbret ilirësh, u çon 72 anije grekëve për rrethimin e Trojës.

Enea zbret ndër brigje t'Epirit, në Butrint.

Selët ruejnë orakullin e Dodonës.

Tre vllazen ngrehin kështjellën Rozafat në Shkodër.

### **Nga historia:**

635 para Krishtit - Gorgi, i biri i Çipselit, me korçirasit themelon Artën.

627 para Krishtit - Korçirasit themelojnë Durrësin; ma vonë Korinthisit themelojnë Himarën, Pojanin e Qerfozin.

- Dionizi i Sirakuzës themelon Lezhën

600-550 para Krishtit - Segovezi, prijësi i Galëve, pushton Epirin.

435 para Krishtit - Durrësi dhe Arta, së bashku me korintas e taulantë luftojnë kundër korçirasve.

- Galët përshkojnë dhe grabisin Ilirinë.

- Lekë Mollosi sundon n'Epir.

350 para Krishtit - Disa fise ilire mësyjnë Filipin e Maqedonisë, i cili i then.

356 para Krishtit - Agroni shtron Epirin dhe merr Qerfozin.

356 para Krishtit - Lindë Leka i Madh.

356 para Krishtit - Bardhyli, mbret i ilirëve mësynë Maqedoninë.

355 para Krishtit - Lufta me "Lidhje".

336 para Krishtit - Leka i Madh hypë në fron.

334 para Krishtit - Të bijtë e Bardhylit, Kliti e Glauku çohen kundra Lekës së Madh.

326 para Krishtit - Vdes Lekë Mollosi.

326 para Krishtit - Vdes Leka i Madh.

305 para Krishtit - Pirroja në luftë t'Ipsit kundër Dhimitër Poliorcetit.

287 para Krishtit - Pirroja mund romakët e Kartagjenasit pushtojnë "Magna Greacia", Lybien. Pirroja themelon Berenicen (Prevezen).

280 para Krishtit - Pirroja mund romakët në Herakle.

279 para Krishtit - Pirroja në krye të ushtrisë greko-siçiliane kunder Kartagjenasve e Mamertinëve.

275 para Krishtit - Lufta në Benevent.

272 para Krishtit - Vdekja e Pirros n'Argos. Vijnë mbas tij Leka, Pirroja II e Ptolemeu.

250 para Krishtit - Ilirët fitojnë pavarësinë nën Glaukun, mbas tij vjen i biri Pleurati.  
 - Agroni pushton Epirin, Qerfozin e lufton kundër "Lidhjes etolike".  
 - Shkodra kryeqytet i Ilirisë.

232 para Krishtit - Teuta sundon Ilirinë në emën të Pineut

230 para Krishtit - Teuta shtron ishujt e Dalmacisë e të Liburnies. Teuta pushton Durrësin dhe Qerfozin. Teuta pret krenarisht të derguemit romakë, C. Junius dhe L. Coruncanius; ky i fundit vritet në kthim.

229 para Krishtit - Ilirët luftojnë kundër romakëve që duen me i pushtue.

228 para Krishtit - Roma i shpall luftë Teutës.

221 para Krishtit - Vdes Teuta; Dhimitri pushton krejt Ilirinë e romakët vejnë Pineun.

220 para Krishtit - Ilirët shklasën përsëri Maqedoninë.

219 para krishtit - Etolianët mësyjnë Epirin e rrethojnë tempullin e Dodonës.

216 para Krishtit - Dhimitri pushton Vlonën e tjera qytete të Ilirisë.

205 para Krishtit - Paqja e Durrësit.

200 para Krishtit - Fillojnë luftat kundër Ilirisë.

198 para Krishtit - Genci hypë në sundim.

168 para Krishtit - Genci ndryhet në Shkodër dhe dorëzohet në Medeon (Medun). Iliria dhe Epiri provincë romake.

167 para Krishtit - Vdes Genci n'Iguvium (Spole) Itali.

153 para Krishtit - Kryengritja e madhe ilire nën kryesinë e trimit Bato që zgjati 6 vjet.

83 para Krishtit - Vlona qendër shkencash; këtu kryen mësimet Oktaviani.

48 para Krishtit - Mark Antoni zbarkon në Nymphaeu (Shën Gjini) del në Lezhë në ndihmë të Pompeut.

II. 48 para Krishtit - Mark Antoni pushton Lezhën.

31 para Krishtit - Oktaviani themeloi Nikopolin (Prevezën).  
 - Lindja e Jezu Krishtit.

59 mbas Krishtit - Sh'Pali përshkon Ilirinë dhe Epirin me Maqedoni dhe Sh. Ndreu nga Akaja kalon n'Iliri.

98 mbas Krishtit - Vdiq i martirizuem Sh' Asti, ipeshkëv i Durrësit.

178 -193 mbas Krishtit - Shën Eleuteri epirotas, Papë shqiptar.

267 mbas Krishtit - Gotët shklasën Ilirinë.

Shek. III mbas Krishtit - Martirizimi i Shën Izaurit dhe i Inoçentit athinas në Pojan së bashku me Bardhin e Porozvinin e Herminin pojanas.

287 mbas Krishtit - Vizigotët përshkojnë Ilirinë.

282 mbas Krishtit - Probi, peranduer romak dhe fis iliras, nënshtron Gotët n'Iliri.

283-296 mbas Krishtit - Karli Papë, nga Salona e Ilirisë.

3.II.316 mbas Krishtit - Martirizimi i Shën Vlashit në Sebaste t'Arbënit.

III.320 mbas Krishtit - Martirizimi i 40 martirëve në Sebaste t'Arbënit.

368 mbas Krishtit - Sundon Valentiniani, i fisit Iliras. Valentiniani dekreton ligjin që populli i vogël i krahinës iliriane të ketë nga një "defensor plebis" (Mbrojtës).

370 mbas Krishtit Krishtënimi i përhapun gjithkund nëpër Shqipni dhe i organizuem plotësisht.

374 mb. Kr. Kuadët e Sarmatët shklasën Shqipninë.

376 mb. Kr. Gotët me leje të Arkadit bijnë në Epir.

387 mb. Kr. Shkodra Seli Arqipeshkvnore.

395 mb. Kr. Iliria bahet krahinë romake e thirret Praevalitane.

395 mb. Kr. Shqipëria nën mbretën romakë të Bizantit, sundon Honori.

396 mb. Kr. Durrësi metropol i Ilirisë.

Shek.IV-Shën Donati ipeshkëv i Evrosë n'Epir (kohën e Theodozit të Madh). Shën Prokuli e Shën Martiri (kohen Liçinit) në Ulpianën e Dardanisë-Iliri.

402-417- Rufi, ipeshkëv i Salonikut, sundon dioqezet e Ilirisë dhe t'Epirit.

30.IX. 420-Vdekja e Shën Jeronimit, iliras nga Stridonja.

431- Imzot Senecioni, Arqipeshkëv i Shkodrës merr pjesë në Konçilin e Efezit.

481- Ostrogotët rrethojnë Durrësin. Një pjesë Shqipnie nën Teodorikun.

493- Justiniani, sundon për do kohë në Ballkan. Në Epir ngrehë kështjellën dhe ndërton një akuedukt.

Shek.V- Shën Niçeta, ipeshkëv në Remezianë (kohën e Shën Paulinit nga Nola.

553 - Justiniani, me fis iliras, dëbon Ostrogotët nga Iliria.

600 - 650 - Serbët, mandej Kroatët dynden në Shqipni.

601 - Shkodra seli ipeshkvnore.

640 - 642 - Gjoni IV papë iliras nga Dalmacia.

687 - Kononi papë nga Thrakja.

920 - Simeoni car i Bullgarëve shtrinë sundimin deri në Butrint, Himarë e Vlonë.

990 - Samueli i Bullgarisë pushton Durrësin.

Shek.XI - Normanët, të primë nga Robert Guiskardi e i biri i tij Boemundi, pushtojnë Shqipninë.

1019 - Bizantinët i thërrasin shqiptarët albanoi, fis të cilin e përmend Ptolemeu më 150 mbas Krishtit.

1050 -1080 - Shqipnia e Veriut nën Serbinë.

1081 - Durrësi, Vlona, Janina dhe Shkupi në dorë të Normanëve.

1085 - Venecianët mundin Normanët afër Butrintit ku vdiq Guiskardi. Bizantinët prapë pushtojnë Shqipninë, por Durrësin dhe pak qytete.

1094 - Emni Albanoi përmendet ndër kombe perëndimore.

1110 - Thema Dyrrachion provincë në vedi me kryeqytet.

1180 - Mbreti serb Stefan Nemanji, pushton Durrësin.

1185 - Guljemi II norman, merr Durrësin, Shkodrën, serbët zaptojnë Shqipninë.

1202 - Mëhill Ejlluer Komneni pushton Epirin.

1210 - Venediku pushton Durrësin e brigjet e Detit Adriatik.

1215 - Theodor Ejllori qet venedikasit jashtë Shqipnie.

1218 - Abati Pjeter Dokne asiston në themelimin e Kishës së Shirqit.

1218 - 1241- Jovan Ahseni II Car i Bullgarëve pushton Shqipninë e Eperme.

1240 - Themelimi i Kuvendit Françeskan të Lezhës.

1245 - Mbahet Konçili i Lionit.

1259 - Mëhill Ejllori i jep së bijës, Helenë, si pajë Vlonën, Janinën, Beratin, Durrësin dhe Qerfozin.

1271 - Mëhilli II dhespot n'Epir.

1272 - Karl Andoni merr Durrësin dhe Beratin.

1272 - Themelohet Kisha e Shën Rrokut.

1274 - Durrësi rrenohet prej termetit.

1330 - Stefan Uroshi II pushton Shqipninë e mesme dhe Epirin. Vdiq n'Uri i Lumi Françesk.

1288 - Françeskanët ngrehin së parit Kuvendin e tyne në Shkodër.

1290 Helena e Rashës nderton kishën e Shirqit

9.IV.1302 - Me urdhën të Senatit të Venedikut lirohet Ambasadori i Turqisë i arrestuem në Lezhë nga proveditori i atij qyteti.

1304 - Filipi, princ i Tarantit merr Durrësin.

1312-1318-Shqiptarët lidhen me Filipin e Tarantit kundra Uroshit II e e ngushtojnë në Shkup me i dhanë liri.

1319 - Shqiptarët e veriut hidhen kunder Milutinit dhe me armë në dorë nxjerrin disa të drejta të mohueme deri atëherë.

1336 - Kryengritje kundër Car Dushanit.

22.I.1346 - Kunorëzimi i Car Dushanit.

1346 - Ndër dokumentat e Klementit VI përmendet Katedralja e Shkodres.

1358 - Pjetër Loshë Mazrreku dhespot i Nartës.

1358 - Nisë sundimi i derës së Balshajve.

1361 - Vdes Balsha I

1361 - 1401 - Të bijtë e Balshës I pushtojnë Republikën e Tivarit dhe vejnë selinë në Shkodër.

1363 - Karl Topia pushton Durrësin dhe mbytë Niceforin.

1370 - Balshajt pushtojnë Kaninën dhe Vlonën.

1372 - Balshajt u marrin serbëve Pejën, Prizrenin, Ohrin dhe Kosturin.

1375 - Gjin Bue Shpata pushton Morenë e bahet sundues i saj.

1383 - Balshajt pushtojnë Durrësin.

1385 - Otomanët qesin Balshajt jashta Durrësit ku hyn Karl Topia. Vdes Balsha II i mbytur.

1389 - Gjergji II Balsha ikë në Ulqin e Tivar.

1392 - Turqit duken për herë të parë në afërsinat e Shkodrës. Venedikasit marrin Durrësin prej Gjergj Topisë.

1393 - Niketë Toia në Krujë.

1393 - Dukagjinasit përmendën si derë sunduese.

1394 - Ndertohen të parat saranxha në kështjellën Rozafat.

II.1395 - Gjergj Strazimir Balsha i shfaqë dishirin Venedikut me i lëshue Shkodrën.

IV. 1396 - Gjergji II Balsha then Radiq Cernojeviqin e Malit të Zi. Gjergji II Balsha ia shet Shkodrën e Drishtin Venedikut. Venediku pushton Shkodrën.

21.VI.1399- Meremetime në kështjellë të Lezhës. Vdes Gjin Bue Shpata. Vjen mbas tij Maurik Bue Shpata, dhespot në Nartë. Venediku merr Vlonën, Butrintin dhe Pargën.

1401 - Venediku merr masa mbrojtëse në kështjellë të Shkodrës.

2.II.1403 - Gryka e Bunës forcohet nga Venediku. Maurik Bue Shpata qet grekët jashtë Janine.

6.V.1403 - Nga sundimtari venedikas merrën masa mbrojtëse për Shkodrën.

1408 - Helena Balsha dhe Strazimir Balsha zgjedhin kontin Topia si arbiter për çashtjet e linduna në mes tyre dhe Venedikut.

1409 - Shkodra çohet me armë kundra Venedikut. Venediku çon ushtri për mbrojtje të Shkodres dhe t'Ulqinit nga kercnimi i turqve.

1412 - Lindja e Gjergj Kastriotit në Krujë.

1422 - Mbahet Konçili i Kostancës.

1418 - Karl Toçi mbytë Maurik Bue Shpatën e bashkon dhespotatin e Janinës e t'Artës.

1419 - Gjon Kastrioti, princi i Krujës mundet prej Evrenoz Pashës të cilit i jep peng kater

bijtë.

31.I.1430 - Humanisti shkodran Gjon Gazulli merr doktoratën n'Universitetin e Padovës. Venediku çon fuqi të reja për mbrojtjen e Shkodrës e t'Ulqinit nga turqit.

1431 - Janina bie në duer të turqve.

1434 - Shqipnia Veriore çohet në luftë kundër Turqisë.

1443 - Skanderbegu largon Turqit nga Sfetigradi

1.III.1444 - Lidhja e Lezhës ku marrin pjesë edhe Dukagjinët, Shpatët, Dushmanët, Altisferët e Dejës, Arianitët, etj.

12.VII.1445- Skanderbeu i shpallë luftë Sulltan Muratit II.

1447-Skanderbeu, mbas luftës me Venedikun, xen rob në Mirditë Mustafë Pashën.

22.VI.1449 - Skanderbeu ban paqe me Venedikun. Skanderbeu then Muratin II. Zjarr i madh n'Shkoder që mbërrin deri në dyert e kështjellës.

II.1452 - Pal Dukagjini shpërblehet prej Venedikut me merita patriotike.

1453 - Skanderbeu then Hamza Kastriotin e Mojs Golemin.

4.I.1454-Sundimtarët venedikas mblidhen në Durrës për të bisedue mbi masat mbrojtëse dhe fortifikuese kundër Turqisë dhe shtrohet se si me i ndihmue Skanderbeut.

6.II.1453-Rektori i përgjithshëm venedikas urdhënohet me bashkue forcat me Skanderbeun kunder turqve.

1459- Skanderbeu shkon në ndihmë të Ferdinandit t'Aragonës në Bari.

1460-1461-Skanderbeu kthehet me vrull nga Italia dhe mund katër ushtri turke njena mbas tjetrës.

1461-Bahen fortifikime në kështjellën e Shkodrës.

1462-Formula e Pagëzimit.

VIII.1463 - Skanderbeu then ushtritë turke afër Ohrit.

1464-Afër Gurit të Bardhë Jakup Pashë Arnautin Skanderbeu e then dhe e mbytë.

1466 - Skanderbeu then ushtrinë turke i primë prej Ballaban Badër Pashës që mbet vdekun n'at luftë.

1467-Skanderbeu then sulltan Mehmetin dhe e ngushton me dalë prej Shqipnie i koritun. Mblidhet Kuvendi II i Lezhës.

I.1468-Vdes në Lezhë Gjergj Kastrioti, Skanderbeu. Imzot Pal Ejllori, Arqipeshkëv i Durrësit merr sundimin e Shqipnisë.

17.V. 1474 - Qarkimi i parë i Shkodrës nga turqit, sundimtar Anton Loredani.

20.6.1478-Turqit pushtojnë Krujën dhe mbysin Kontarinin dhe Lekë Dukagjinin. Mbas një lufte të rreptë Lezha bie në dorë të turqve.

1479 - Shkodra në dorë të turqve të cilët bajnë lidhje me Venedikun.

1480 - Pushtimi i plotë i Shqipnisë nga turqit.Sulltan Mehmeti del n' Otranto.

1481 - Gjon Kastrioti II pushton shumë vende të Shqipënisë me ndihmën e himariotëve.

1481 - 1492 - Mergimi i shqiptarëve në Siçili (Itali).

1488 - Gjon Kastrioti mundohet me i dëbue turqit nga Shqipnia.

1493 - Themelimi i ma së parës shtypshkronjë n'Obot afer Rijeke, ma e para në Ballkan.

1499 - Fr. Bernardini, frat shkodran, i shkruen Senatit të Venedikut tue e lutë të formonte një ushtri e tue bashkue me forcat shqiptare nën urdhënat e Skanderbeut të ri, të birit të Gjergjit dhe me pjesëmarrjen e Dukagjinasve, t'u forcojshin në Lezhë e prej andej me mësyte Shkodrën dhe Krujën.

1501 mb. Kr.- Durrësi në dorë të turqve.

1503 - Kanë fillue luftat e papreme të shqiptarëve kundër turqve.

1504 - Gjergji Negro, ambasador i Venedikut në Stambollë, cakton kufijtë e Shqipnisë së Veriut dhe ato t'Ishullit të Lezhës.

1505 - Ishulli i Lezhës bie në duer të Turqve.

1545-47 - Mblidhet Konçili i Trentit.

1555(5.I.) - Del në dritë "Meshari" i Gjon Buzukut.

1566 - Lindë Dom Pjetër Budi nga Guri i Bardhë.

1571 - Turqit marrin Ulqinin e Tivarin.

1572 - Shqiptarët çohen kundër Turqisë. Ibrahim Pasha i Pejës çohet kundër Turqisë.

1577-Kryengritje e madhe dhe lufta kundër Turqisë në Shkodër te Lama e Spahijve. Vendosi si sundimtar vendas e Begollejve të Pejës.

1583 - Françeskanët kanë pesë kuvende; në Rubik, Lezhë, Sebaste, Kep të Rodonit dhe në Memel (Hajmel apo Mënelë).

1592 - Kryengritje e përgjithshme në Shqipëni.

23.7.1602 - Mbledhje e madhe në Sh'Llezhdër të Mirditës ku marrin pjesë 2656 krenë dhe kërkojnë lidhje me Venedikun kundër Turqisë dhe mbrenda tri ditëve mblidhen 100.000 luftëtarë, por Venediku nuk bëzanë.

1606 - Lindë në Sapë Frang Bardhi, shkrimtar dhe autor i një fjalori në gjuhën shqipe.

1607 - Një tjetër kryengritje popullore kundër Turqisë.

1614 - Hoti, Kuçi e Shkreli lidhin besën kundër Turqisë dhe rrokin armët për liri.

1621 - Imzot Pjetër Budi organizon një kryengritje kundër Turqisë ku marrin pjesë 300.000 vetë.

1623 - 38-Fiset e Kelmendit çohen kundër Turqisë dhe thejnë Sulejman Pashën. Me të bashkohet edhe Kuçi.

1624 - Martirizimi i Dom Mark Kishaj, famullitar i Shkodrës.

1630 - Lindë Imzot Pjetër Bogdani, në Gur të Hasit të Thatë të Dukagjinit.

1626 - Imzot Frang Bardhi në Venedik i përgjigjet Imzot Gjon Tomak Maranoviqit, tue mbrojtë shqiptarizmin e Skanderbeut.

1638 - Hoti çohet në luftë kundër Turqisë.

1644 - Françeskanët misionarë P. Pali nga Mantova dhe P. Salvatori nga Affida, qenë mbytë e hjedhë në Cem. Ai vend sot quhet Pellgu i Fratit. Mbytë me thika.

1648 - P. Ferdinandi nga Albisola e P.Jaku nga Sarnane, misionarë françeskanë, ngulun mbi huj për fe në Pazar të Shkodres nga Turqit. P. Ferdinandi ndei gjallë tri ditë tue predikue.

1645 - Kelmendasit qesin jashtë Turqit.

1674 - Dom Nikollë Vladanji thotë meshën e parë në Kishën e Pdhanës. Me 1693 bahet ipeshkëv i Lezhës.

1687 - Kelmendi e Kuçi dhe Himarjotët çohen kundër Turqisë.

1696 - Mbarë krahina e Hotit lufton kundër Venedikut për çështjen e Ulqinit.

1698 - P. Filip Shkodra çelë shkollë nëfamiljen Kamsi, në Shkoder.

1699 - Kelmendi në luftë kundër Turqisë, bashkohet me të Ulqini e Tivari.

1700 - Imzot Anton Zezaj (Negri), ipeshkëvi i Shkodres, vjerrë në konop për fe në pazar - Teqe.

1700 - Klementi XI Albani Papë shqiptar i lindun n'Urbino.

1703 - Konçili i Parë Shqiptar në Mërqi i kryesuem nga Imzot Zmajeviqi, arqipeshkëv i Tivarit.

1718 - P. Antoni nga Sora, françeskan, varë në konop për fe, afër Shkodre.

1739 - Malësorët e Mbishkodres vrasin Mahmut Pashë Begollin prej Peje.

1740 - Zi e madhe buke në të gjithë Shqipërinë. Don Karlo i Napolit dergon grunë.

Çmimi: Një kalë arrinë 16.000 aspra, çeniku i orizit 40 oka e djathë 40 aspra dhe oka e mishit 20 aspra.

1743 - Dom Gjon Nikollë Kazazi boton librin e tij.

1745 - Përmendën nga rregjistri i Imzot. Pal Kamsit këta lagje dhe rrethe të Shkodres, Tophana, Rëmaji, Kazena, Sh'Lavrendi, Qafa, Kishaj, Zarufa, Shiroka dhe Kepi i Madh.

1747 - Kryengritje e madhe kundër Turqisë.

1755 - Çaushollajt qiten jashtë Shkodre.

1764 - Themelohet në Shkodër shoqnia e Shën Andout.

1769 - Mehmet Pashë Plaku i Derës Bushatlijve emnohet sundimtar i Shkodrës.

1775 - Për tre muej rresht shi i madh e dame të panumër sidomos në Pult, Shosh, Nikaj-Mertur, Selcë, Drisht. Shkodra u mbyt n'ujë. Dom Jak Tanushi Zorba, nderton Kishën e Shkrelit. Mehmet Pasha me të birin e me 15.000 ushtarë niset me zhbi Kuçin.

1778 - Mustafë Pasha shkon në More e vdes.

1779 - Prej 6 Kallnorit deri me 29 prill asnjë pikë shi dhe u bâ korrje e ganishme.

1784 - Pazari i Shkodrës mbushet me drithë dhe çmimi që ishte prej 3000-2400 aspra huni, ra në 1500-1200 dhe ky bollëk vazhdoi deri më 1789.

1786 - Kara Mahmuti then ushtrinë turke që kishte ardhë me rrethue Shkodrën.

1787 - Kara Mahmuti pajtohet me Mirditë.

1787 - Imzot Gjergj Radovani shuguron ipeshkëv Imzot Frano Borcin, prift shkodran, në kishën e Shën Mërisë Magdalenë.

1787 - Në qafë Dardhë xehet në befasi dhe i pritët kryet Kara Zeqir Pashës, Vezir i Rumelisë prej anmiqve të tij.

1887 - Mahmut Pasha me sulm del e zbret nga kështjella ku ishte ngujue, then ushtrinë qarkuese, vret Mehmet Pashë Çaushollin dhe ndjek ushtrinë boshnjake deri në Kotorr.

1787 - Mehmet Pashës i pritët kryet.

IV. 1788 - Vritet Tahir Agë Juka dhe i biri i kapidan Pashë Shpuzës, anmiq të Mahmut Pashës.

1788 - Mbërrijnë në Shkodër tre delegatë të Zefit II t'Austrisë dhe ndryhen në kështjellë për bisedime me Mahmut Pashën.

1788 - Të përcjellun prej besnikëve të Mahmut Pashës, tre delegatët austriakë nisen kah Kraja, por afër Muriqit, vriten në befasi, u pritën krenët dhe i vorrosin në Mjet, në një gropë ndër suka të Liqenit; Mahmut Pasha i çon në Stambollë krenat e tyne.

1789 - Kremtime të mëdha në Shkodër, për gëzim që Sulltani kishte falë Shkodrën. Kështjella u ndez flakë nga krismat e topave, që shprazeshin me galdim.

1789 - Mahmut Pasha niset me shtypë levizjen e Bosnjes; popullit të krishtenë i vehen taksa të randa; pasanikëve 150 grosh, të mesemve 70-80 grosh, të vorfenvë 30 grosh, ndersa klerit katolik, ndër të cilët priftentë të Tophanës, ipeshkvijve të Lezhës, famullitarëve të Lezhës, Merqisë, Manatisë, Bulgrit nga 100 grosh. Zadrimes i muer dy herësh pagesat e taksavet. Për t'u shtie tmerrin atyne që s'kishin ndigjue me shkue në luftë, si edhe atyne që dezertojshin, me 7 shtator i qe pre kryet një katolikut nga Shpori dhe me 9 të atij mueji një myslimanit nga Myselimi.

1789 - Bollëk i madh në Shkodër. 6 pare oka e miellit të grunit, 2 pare ajo e misrit. Lagjja Bahçellek thirret Babaik.

1789 - Mahmut Pasha shkon me të nipin në Bosnje, Novi Pazar e Vidin.



1791 - Mahmut Pasha i pret kryet Kolë Mirditorit.  
 1792 - Mahmut Pasha shkon në Prizrend e Prishtinë.  
 1796 - Kara Mahmutit i pritët kryet në luftë.  
 1796 - Mahmut Pasha shkon në Pipër ku mbet i vramë.  
 1796 - Vdes në Piper të Kuçit bashkë me Mahmut Pashën, nipi i tij.  
 1798 - Mehmet Pashë Bushati shkon në Vidin. Në Shkodër bie murtaja.  
 1801 - Dom Simon Kamsi i mbiquejtun Signoreja kah fundi i dhëtorit mbledhë në Shkodër një sasi të madhe të hollash për të pague haraçin e madh që sundimtari u kishte vu fshatarëve laramanë të Jubanit, Ganjollës, Gajtanit, Gurit të Zi e Rrencit.  
 1803 - Bie murtaja në Shkrel.  
 1804 - Brahim Pasha shkon në Anadoll me luftue për Sulltanin.  
 1809 - Vdes Brahim Pashë Bushati.  
 1814 - Shkreli çohet kundër Mustafë Pashë Bushatit.  
 1815 - Sulejman Hoti mundohet me mbytë Mustafë Pashën, por vret kushrinin e tij, Tahir Pashen.  
 1817 - Murtajë e madhe në Shkodër e Shkrel; viktimë e shërbimit fetar e shoqnor, vdes Dom Jak Tanush Zorba në Shkrel.  
 1819 - Ali Pashë Tepelena, si shtron krejt Epirin, merr Pargën.  
 1820 - Mustafë Pashë Bushati, i emnuem vezir, shkon me luftue në More.  
 1821 - Dy ushtri turke mësyjnë Shqipninë.  
 1821 - Nën kryesinë e Mark Boçarit, shqiptarët luftojnë për lirinë e Greqisë.  
 1822 - Hurshit Pasha i Moresë xen e mbytë trathtish Ali Pashën e Janinës.  
 1823 - Prengë Bibë Doda shtron Dibrën, Llezhi i Zi, princ në Mirditë.  
 1829 - Mustafë Pasha shkon në Vidin në luftë.  
 1830- Lindë P. Leonard de Martino, italo-shqiptar, françeskan i cili qe misionar në Zadrimë. Me 1881 botoi veprën "Arpa" e një italo- shqiptari; mësoi edhe në shkollën françeskane në Shkodër.  
 1831 - Mustafë Pasha i shpallë luftë Turqisë, i del para ushtrisë turke në Perlep me 20.000 vetë.  
 1831 - Mustafë Pasha dorëzohet dhe çohet në mërgim në Stambollë.  
 1835 - Kryengritje e madhe në Shqipëni.  
 1834 - Kryengritje fshatare kundër Turqisë kryesue nga Dasho Shkreli, Osman Pasha ndryhet në kështjellë dhe i shtrenguem jep disa lehtësina.  
 1827 - Lindë Pashko Vasa, shkrimtar i Rilindjes.  
 1837 - Termet i fortë në Shkodër.  
 1839 - Malazetzët mësyjnë Hotin dhe Kelmendin, Grudën.  
 1840 - Mblidhet Kongresi i Londrës. Mehmet Ali Pasha, shqiptar.  
 1848 - Kryengritje e madhe kundër Tanzimatit.  
 1849 - Kryengritje fshatare kundër Turqisë.  
 1852 - Tjetër kryengritje malsore kundër Turqisë.  
 1854 - Kryengritje e armatosun në Shkodër. Mirditasit dallohen në luftën turko-ruse në Krime.  
 1855 - Termet i fortë në Shkodër.  
 1856 - Kremtime të mëdha në Shkodër për nënshkrimin e paqes. Për një orë rreth u zbrazen top e pushkë nga kështjella e kodrat e Tepes.  
 1856 - Hamz Agë Kazazi u prinë disa fanatikëve me shkue e me rrethue Seminarin

Papnuer të Jezuitëve.

1856-Arrijnë në Shkodër pesë delegatët e qeverisë austriake dhe u ndryen në kështjellë ku biseduen me sundimtarin për çështjen e damtimit të Kolegjes dhe me 16 dolën nga Shkodra pa u marrë vesh se çka u vendos.

1856-Vjen në Shkodër i derguemi fuqplotë i Stambollës dhe pati bashkëfjalime me Konsullin e Austrisë, Ipeshkëvin e Pashën. Mustafë Pashë Menehmeni dergon në mërgim Hamz Agë Kazazin me disa parësi Shkodre. Mali i Zi pushton Kuçin. Krijohet në Shkodër Komisioni Xhibalit në krye të të cilit vihet Haxhi Agë Lohja.

1857 - Qeverija turke zbret nga Kështjella e zen vend në shtëpi të Dervish Beg Koplikut.

1858 - Hidhet guri i parë i themelit të Katedrales së Shkodres.

1858 - Kushë Micja çelë shkollën për vajza shkodrane.

1859 - Lindë në Shkodër poeti i Rilindjes Filip Shiroka.

1859 - Themelimi i Seminarit Papnuer të Shkodrës me nxanësat: Prengë Doçi, Ndue Bytyçi.

1860 - Lindë në Shkodër artisti piktor Kolë Arsen Idromeno. Vdiq me 12. XII. 1919.

VIII.1861- Françeskanët ngrehin Kuvendin e tyre në Shkodër.

1862 - Lidhja shqiptaro-greke për kryengritjen në Janinë e Durrës. Lufta e Konicës me humbje të Turqisë. Oficerët e kështjellës lejohen me ndejë lirisht në qytet, me urdhen të Ferik Mustafë Pashës. Shugurimi i Imzot Dario Bucciareli në Katedralen e Shkodrës nga Imzot Karl Pooten. Dalin në dritë botimet e Dom Ejëll Radojës.

1864 - Lindë në Shkodër arsimtari e shkrimtari Mati Logoreci.

2.1866 - Lindë në Shkodër poeti e shkrimtari Dom Ndre Mjedja.

5.1866 - Vdes në Kallmet shkrimtari Dom Pjetër Zarishi.

12.1866 - Krijohet i Treti Urdhën në Shkodër.

II.1867 - Shkodra bahet Seli Arqipeshkvnore.

1870 - Dom Pashko Junki boton librat e tij.

1871 - Zef Jubani Ndokillia boton disa rapsodi shqiptare.

1.XI. 1871 Konçili II Shqiptar, kryesuem nga Imzot Karlo Pooten, Metropolit i Tivarit dhe Arqipeshkëv i Shkodrës.

10.1874 - Çelet shkolla e Shirokës nga Dom Zef Ashta.

1869 -1870 - Mbas shinave dhe vershimeve të shumta Drini kthen në shtratin e vjetër kah Shkodra.

12.1874 - Shkrepë moti n'oren 5.15 në depon e municionit të kështjellës që merr flakë dhe mbesin të vdekun 97 vetë.

24.6.1875 - Lindë Imzot Benardin Shllaku.

7.1875 - Themelohet Kuvendi i Françeskanëve në Gjuhadol.

X.1875 - Themelohet Kongregacioni i Zojës Nunciatë në Shkodër.

X.1877 - Jezuitët çelin Kolegjen Saveriane në Shkodër.

2.1878 - Malet e Veriut protestojnë kundër qeverisë së Athinës për çështjen e Epirit.

4.1878 - Themelohet "Lidhja e Prizrendit".

1878 - Fuqitë e armatosuna të "Lidhjes" mësyjnë Malin e Zi që don me pushtue Plavë e Guci.

1878 - Lidhja e Prizrenit proteston me memorandum kundër vendimeve të Kongresit të Berlinit. Shkodra proteston pranë Kongresit të Berlinit për shkëputjen e Podgoricës, Tivarit, Plavës dhe Gucisë.

18.6.1878 - Mirdita, Malsia e Lezhës dhe Lura i luten Kongresit të Berlinit me i dhanë

autonominë.

13.7.1878 - Traktati i Berlinit i lëshon Malit të Zi, Ulqinin e Tivarin, Plavë, Guci e Triepsh dhe Greqisë një pjesë të Epirit.

11.1878 - Nga frika qeveria turke rrethon Shkodrën me 20.000 ushtarë.

2.1879 - Lindë në Shkodër patrioti dhe shkrimtari Luigj Gurakuqi.

1879 - Ushtritë malazeze thehen keqas nga vullnetarët shqiptarë që mbrojnë Plavë e Guci.

1880 - Plavë e Guci i hiqen Malit të Zi.

1880 - Malit të Zi i lëshohen vendet që nga Tivari deri në Breg të Bunës. Vdes në Venedik Imzot Ejëll Radoja, shkrimtar e famullitar i Shkodrës. Tina e Nikës çelë shkollën e punës së dorës për vajza. Botohet libri i Dom Ndre Logoreci "Doktrina e Krishtenë". Ulqini bie në dorë të Malit të Zi. Arta i lëshohet Greqisë. Atë Jak Jungu boton "Kulshedren e Shpirtit" dhe disa poezi të Dom Ndre Mjedës: "Shahiri elierz". Ma vonë në vitin 1895 boton edhe fjalorin "Shqip-Italisht". Dom Pashko Babi (Sheqeri) boton në Shkodër "Vakinat e të shkruemit shejtë". Lidhja Hot-Grudë-Shkrel-Kastrat me shty kufinin e Shqipnisë.

1879 - Krijohet Kuvendi i Murgeshave Stigmatine në Shkodër. Themelimi i shkollës Stigmatine për vajza.

1882 - Çelet Kolegja Serafike Françeskane në Shkodër.

1885 - Lindë në Shkodër shkrimtari Hilë Mosi.

1887 - Shugurohet në Kishë të "Zojës së Shkodrës" Imzot Ndre Logoreci, ipeshkëv e mandej me 24.8. 1887 Arqipeshkëv i Shkupit. Themelohet Kongregacioni i Zojës së Lurdit për gra.

1887 - Krijohet Kuvendi i Françeskanëve te Arra e madhe (Shkodër).

1888 - Krijohet Misioni Shëtitës në Shkodër.

1899 Imzot Prengë Doçi, Abat i Mirditës themelon në Shkodër Shoqinë Letrare "Bashkimi".

1889 - Themelohet Kompania e "Zojës Ruzare" te Arra e Madhe.

1889 - Krijohet shoqnia bamirëse "Rrethi i Shën Jozefit" në Kolegjën Saveriane.

1889 - Vdiq Imzot Pashko Junki, famullitar i Shkodrës e shkrimtar.

1889 - Çelet spitali i Motrave të Mëshirës në Shkodër.

6.1895-Konçili III Shqiptar në kryesinë e Imzot Pashko Guerinit, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodrës.

28.6.1897 - Murgeshat Stigmatine çelin kopshtin për fëmijë të vogjël me drekë, falas.

1899 - Vdes Atë Jak Jungu, shkrimtar, themelues i Kongregacionit të "Zojës Nunciatë", të Kongregacionit të "Zojës së Lurdit" dhe të Uratores së "Zemrës së Krishtit."

1902 - Shkolla françeskane jep mësimet në gjuhën shqipe.

1903 - Me alfabet të Shoqnisë "Agimi" shtypen tekstet e shkollave fillore.

1903 Shtjefen Maçi mësues në Dajç të Bregut të Bunës.

1904 - Lush Kola nga Barbullushi mëson në fshatin e tij. Pse përhapë idena nacionale, pushohet nga puna.

1904 - Hilë Agustini çelë shkollën në Bushat.

13.6.1904 - Imzot Jak Serreqi krijon qelën e re famullitare në Serreq.

6.I.1905 - Termet i madh në Shkodër, në oren 5,30 të mengjesit. Dame të mëdha në Shkodër.

8.12.1905 - Bekimi i Kishës Françeskane të Gjuhadolit.

1907 - Themelohet azili i jetimëve nga motrat Saleziane në Shkodër; ma vonë dhe i

pleqve të vorfën.

1908 - Vëllaznit e shkollave Schulbrüder hapin internatin për fëmijët e vorfën në Shkodër.

31.8.1908 - Shpallja e Konstitucionit nga Sulltan Hamiti. Kremtime të mëdha në Shkodër.

1908 - Shkodra merr pjesë në Kongresin e Monastirit ku dergohen: Fishta, Gurakuqi, Dom Ndre Mjedja, Mati Logoreci, Hilë Mosi.

- Krijohet klubi "Gjuha Shqipe" në Shkodër.

1909 - Zef Ndoc Ndreka, fshatar nga Spaçi i Mirditës mëson aty.

1909 - Del në Shkodër gazeta "Koha" e "Bashkimi". Kërkohet nga Shkodra njohja zyrtare e kombit, e arsimit të detyrueshëm, shërbimi ushtarak në vend, e një sundimtar i përgjithshëm shqiptar...

24.7.1910 - Xhavid Pasha me 20 taborre (batalione) vjen me shtrua Shkodrën.

1910 - Luftë në Kaçanik ndermjet shqiptarëve dhe turqve. Kryengritje e Malsisë së Madhe.

26.7.1910 - Shefqet Turgut Pasha vjen në Shkodër me shtrua Malsinë. Luftime të përgjakshme në Qafë t'Agrit e në Qafë Shtamë të Shalës ndermjet dukagjinasve dhe ushtrisë turke.

1911 - Plasë kryengritja e Malsisë së Madhe, në Kastrat.

6.4.1911 - Dedë Gjo' Luli ngulë në Bratille në majë të Deçiqit flamurin kombëtar dhe Malsia e Madhe lufton për pavarësi e liri.

18.5.1911 - Kryengritësit shqiptarë i përgjigjen Shefqet Turgut Pashës se nuk përuhen e se do të luftojnë tue derdhë gjakun deri në fitimin e plotë të lirisë.

5.7.1911 - Kryengritje e përgjithshme kunder Turqisë për liri.

X.1912 - Plasë lufta Ballkanike. Në Shkodër shprazen tre topat e fundit turq për shpallje lufte.

X. 1912 - Niset rrethimi i Shkodres nga malazezët.

28.11.1912 - Shkodra merr pjesë me Luigj Gurakuqin në Shpalljen e Pavarësisë shqiptare në Vlonë, në Qeverinë e përkohshme nën kryesinë e Ismail Qemalit.

30.1.1913 - Esad Pashë Toptani shtien e vret trathtisht Hasan Riza Pashën, dalëzotës i Shkodrës, i cili donte me ngritë flamurin kombëtar shqiptar në kështjellë e në kumbonare të Katedrales së Shkodrës.

2 3. 4.1913 - Esad Pasha ia shet Shkodrën malazezve për dy milion florinta, të cilët futen në qytet në tri drejtime: nga Taraboshi, nga Fusha e Shtojit e nga Bardhanjorët.

14.4.1913 - Malazezët djegin Pazarin e Shkodrës, mbasi e grabitën, dhe dalin këtej tue i a lëshue vendin në dorë t'ushtrisë nderkombëtare (austriake, italiane, franceze, angleze, gjermane).

13.6.1913-Naltohet në kështjellë të Shkodrës Flamuri Kombëtar Shqiptar atdhetari Karlo Suma mban fjalimin. 7.1913 - Esad Pasha shpallet sundues i Shqipnisë së Mesme.

12.3.1914 - Princ Vilhelm von Wied, vjen në Shqipni si princ i shqiptarëve dhe zbret në Durrës.

14.5.1914 - Padër Marian Prela themelon shoqinë "Të Bijat e Zojës".

15.6.1914 - Ushtria kombëtare me malsorët e Mbishkodrës luftojnë në rrethina të Durrësit kundër trathtarëve, ku vdes koloneli holandez Thomson.

4.7. 1914 - Plasë Lufta I Botnore.

5.9. 1914 - Princ Wiedi len Shqipninë.

X. 1914 - Esad Pasha futet në Durrës.  
 1914 - Vdes Atë Dedë Pasi, themelues i "Misionit Shtetitës shqiptar".  
 1915 - Në Shkodër ngrehet një qeveri e perkohshme, por është ma tepër anarki. Zhvillohen luftime midis lagjeve ndërmjet nacionalistave dhe përkrahësve të Esad Pashë Toptanit.  
 4.1915 - Kryengritje kundër Esadit në Durrës, i cili ikë andej.  
 5.6. 1915 - Krajl Nikolla Petroviq I, krajl i Malit të Zi, së bashku me ushtrinë e tij përshkohet nëpër Shkodër e del në Itali.  
 2.1915 - Vdes në Shkodër Pader Anton Xanoni, shkrimtar i lindun në Durrës me 1863.  
 6.1915 - Ushtritë serbe të thyeme përshkohen nëpër Shkodër.  
 6.1916 - Rusia proteston kundër veprimeve të paligjshme të malazezëve nëpër Shqipni. Imzot Bernardin Shllaku, ipeshkëv i Pultit, shpëton Dukagjinin nga rrethimi kërcënues i ushtrive serbo-malazeze në ikje e sipër.  
 1916 - Pararoja e ushtrisë austriake futet në Shkodër.  
 23.1.1916 - Ushtritë austro-hungareze, si pushtojnë Shqipëninë e Veriut, Serbinë e Malin e Zi, dalin në Durrës.  
 3.1916 - Vizitë zyrtare në Shkodër nga ana e Arqidukës Karl Salvator i Habsburgve.  
 1917 - Krijohet në Shkodër "Komisija Letrare".  
 30.X. 1918 - Ushtritë austro-hungareze lanë Shkodrën e Shqipëninë.  
 11.1918 - Hyjnë në Shkodër ushtritë aleate.  
 11.1918 - Hoti e Gruda, me një Memorandum dergue në Washington, Londër, Paris e Romë, lypin lirinë.  
 1919 - Themelohet Shoqnia "Bogdani".  
 1920 - Kongresi i Lushnjes ku Shkodra dërgon përfaqësuesi e vet.  
 2.1920 - Dalja e ushtrisë franceze nga Shkodra. Shkodra bashkohet me qeverinë qendrore kombëtare. Lufta e Koplikut.  
 3.1920 - Hapet i pari Parlament Shqiptar.  
 4.1920 - Avni Rustemi vret në Paris Esad Toptanin.  
 1920 - Themelohet Orfanotrofi i "Zemrës së Krishtit" nga Atë G. Della Pietra.  
 8.1920 - Lufta e Vlonës.  
 12.1920 - Legata shqiptare në Konferencën e Paqes në Versailles, në të cilën ban pjesë Imzot Luigj Bumçi e Luigj Gurakuqi, Fishta mbrojnë të drejtat e kombit shqiptar. Lidhja e Kombeve pranon Shqipëninë si anëtare të saj.  
 1921 - Kryengritja e Mirditës.  
 5.1921 - Plasë kryengritja e Matit.  
 1.1922 - Arriti në Shkodër i pari delegat apostolik në Shqipni Imzot Ernest Cozzi.  
 21.1.1924 - Hapet Asambleja Konstituente në Tiranë.  
 - Revolucioni borgjez kryesue nga Fan Stilian Noli.  
 12.1924 - Kthimi i Ahmet Zogut në Shqipni. Në Shkodër krijohet gjyqi ushtarako-politik. Fillojnë burgimet, internimet kundër nacionalistave.  
 2.2.1925 - Vritet në Bari, Itali, patrioti Luigj Gurakuqi.  
 11.1926 - Kryengritja e Shalës kundër rregjimit të Zogut. Gjyqi denon me varje disa pjestarë të kryengritjes.  
 8,1937 - Vdes në Shkodër poeti lirik Dom Ndre Mjedja.  
 1929-Vritet në Zymb, Pader Shtjefën Gjeçovi arkeolog dhe përpilues i "Kanunit të Lekë Dukagjinit".  
 4.1939 - Luftime të rrepta te Ura e Drinit kundër ushtrive fashiste që vijnë me pushtue

Shkodrën.

1939 - Vdes Imzot Pjetër Gjura, Arqipeshkëv i Durrësit.

30.7.1952 - Aprovohet Statuti i Kishës Katolike Shqiptare, nën kryesinë e Imzot Bernardin Shllaku.

11.1956 - Vdes Imzot Bernardin Shllaku, ipeshkëv i Pultit.

### **Burimet historike:**

C. Becker; "L'Albanie e les albanais" fq. 14

M. Sufflay: "Serbët e Shqiptarët", fq. 58, 59, 38.

N. Thalloczy: "Acta e diplomata", I nr. 648.

Cordignano - Valentini : " Saggio di un regesto storico" fq. 4.

Tajani: "Le istorie albanesi", II, fq. 50, 51, III, fq. 26.

A. Gegaj: " L'Albania et l'Invasion turque au XV-e siecle fq.30,33, 48.

Pagine della Dante ; XLIV, 1937, fq. 38, 39, 40.

Kersopoulos: Chronologie, etj. 40, 42, 43.

A. Ghika: fq. 42, 60, 61.

Hecquard: "Haute Albanie", fq. 145.

F. Bianconi: "Carte...",etj. fq. 18.

P. Chiara: "L'Epire", fq. 129, 132.

Q. Spellanzon "Vinti", fq. 254.

Mocenigo : "Albania", fq. 52, 53.

E. Durham : "Twenty ye ars", fq. 206, 216, 221.

A. A. Rappaport : " Au pays des martyres",fq. 97.

J. Godard: "L'Albanie", fq. 116.

L. Viezzoli: "Shqipnija", fq. 158, 159, 165.

Revista "L.E.K.A.", " Të drejtat e Shqypnisë etnike, I".

Marin Sirdani: "Shqipnija..." etj.

Justin Rrota: "Leteratyra shqipe", fq. 156.

"Histori e Shqypnisë", Ministria e Arsimit, 1954-1955.

Jorga: "Breve histoire", fq. 1

Römische, etj. Vëll. III, nr. 6

"Kalendari" i V.P. 1914-1927.

G.Berri: "L'assedio di Scutari".

D.K. Kalendari 1933, fq. 120-137.

Gj. Radovani: Dorëshkrime.

Gj: Sheldija: "Shkodra", Pj. I.II.III.

M. Sammutius - Annalis.

Gelchich: "Zedda", fq. 38, fq. 4.

Jorga : "Re de l'Orient", IV, fq. 235-236.

P.G. Golubovich: Bib. Bio. Bibliog. VI.V. fq. 339.

Orb. Seraphicus: Tom. II. fq. 697,4.

Gonzaga: "De orig. Seraphicae...", etj. 1587, fq. 47-548.

Thalloczy etj. Illyrich.Albanische. Forschungen. VI.V. 207, A.D.V. I nr228.

## **PËRSHKRIMI I QYTETIT**

Shtegtarët që para njëqind vjetëve i binte rasti me ardhë në Shkodër, qyteti nuk i paraqitej si sot, me rrugë të drejta e të asfaltueme, por i u donte me kalue nëpër do rrugë, në qoftë se kështu mund t'i thërrasim që s'ishin tjetër veçse do vija uji dhe për të kalue prej një rruge në tjetrën, iu donte me kapërcye gur mbi gur që ishin vendosë kudo; gurët ishin të naltë kund 0,70-80 metër në formë të katrorët të rrumbullakuem sipri dhe pak si në trajtë

kuji nga fundi. Shpesh herë rrugët në njënen anë kishin një pjesë si të çueme, ba me gardh e mbushë me dhe për të mujtë kështu me kalue pa u lagë në rasë vërshimi i ujit të shumtë. Secila rrugicë, në krye, kish një të çueme, në formë shpine peshku si një urë, për të pritë ujët e Kirit kur ky thente penden e derdhej me furi nëpër qytet, tue përmbytë shtëpia dhe lagje dhe tue ba njëmijë dame materiale. Qerret e mëdha mund të kalojshin. Gjithkund shtëpiat ishin të rrethueme me mure avulli të nalta deri në 8 metra, me dyer të mëdha mbërthyer përbrenda me shula, malldana e reze, kjo duhej të kërcitite me një tingull të fortë që me u ndie deri larg. Për nevoja shtëpiake ishte mandej një derëzë e vogël, thirrë arkapi, prej ku hyjshin e delshin shtëpiakët, miq e të njoftun. Secila derë e oborrit ishte e formueme mirë me trenë dhe ndër dy anët e murit që mbante derën ishin çelë dy bira-frangji për mbrojtje, në rasë sulmi nga jashtë. Ndër dy anët e murit të jashtëm të derës, përbrenda, nga një dritare qorre edhe kjo me nga një frengji; përpara murit të derës, një gur aktronësh, i naltë kund 0.70 metra, për të hypë në kalë i zoti i shtëpisë ose miqtë.

Oborret mbushë me gjithfarë pemësh dhe përreth muret veshë me tanda hardhiet ku piqesh gjithfarë rrushi; kopshtie nduer-nduer barishtesh e perimesh. Sipri pusit me grykë gurit një copet, të gëdhendun me lule e lajle gjithfarësh që dora e ustait kishte djitë me trillue, varesh lulevilja e nder parmakë të çardakut e me mure të derës së oborrit, lulja e mustakut që kënaqte me erë të kandshme kedo që kalonte aty pari. Përbri mureve të avullisë, rreth e rreth oborrit, drandofille topçe, lejlaku, elbarozi, karajfili, elbaroza, felxigenit, të gjithë me erë të mirë e të kandshme. Prej derës së oborrit e deri te shtëpia e për të gjatë përmaqëve të kopshtit mastela të mëdha me limoj e portokalla që dimnit shtriheshin në shenashin mos me i çartë ngrica e aty- këtu, ndër saksia, lule vathë, lule mullaga, etj.

Secila shtëpi, sado e vorfen, i kishte lulet nder saksia të cilat i ruente me ma të madhin kujdes dhe, kur ndërroheshin shtëpiat, fëmijët, i barshin para duersh për të mos i damtue. Në ma të shumten e kopshtievet lulëzonte në pranverë shega tivareshë dhe divedishe, fiku patllixhan, e pemë tipike të qytetit tonë.

Shtëpia shkodrane paraqitej madhështore në përgjithësi si dhe në veçori të saj në daç kah trajta e ndërimit, në daç kah sistemi e rendimi i dhomave; kudo dilte në pah dora e ustait, mjeshtrit, si në punim të bamë në gurë, si në thadrim të drunit, ashtu në daltim të rrasës e në gdhendje të drunit. Shtëpia një kati e naltë, me strehë të gjatë rreth e rrotull saj përpara me dy shkallë mbajtë me qemer të mjedisem e dy qemerë të tjerë nën shkallë, njeni ma i madh e tjetri ma i vogël. Shkallët punue me gurë të latuem; ndërmjet dy shkallëve nga një ballkon shtrue me rrasa të lëmueta të nxjerruna në kodra të Tepës, rrethue me parmakë drunit përpara të naltë 1.60 metër; kundruell parmakëve dera e madhe e çardakut dy kapakësh e punue me drue arre, mbajtë për dy shtylla të mëdha e mbështetë për taban që ishte edhe njëheri edhe prag dere.

Dera mbyllej vetëm me kajnacë ditën dhe mbramën me shula hekurit që kishte përbrenda: Sipri derës një dërrasë e gdhendun, drejtëkandëshe e në anën e poshtme një trajtë qemeri e cila mbyllte siprinen e tue i dhanë njëherit edhe një hijeshi e zbukurim. Rreth e rrotull dërrasa paraqitte gjysa rathësh gërshetue njeni mbi tjetrin, mbarë e mbrapshtë e nder dy lule pesë gjethesh sipri ballkonit e për të gjatë shtëpisë zgjatohet streha e pullazit që dimnit prithe shtërngatën dhe veres rrezet e forta të diellit e nder dy anët e shkallëve në të majtë hajati shtrue me rrasa guri; këtu fëmija luejshin ose gratë ndejshin teshat, kur nuk mjaftonte çardaku.

Prej qemerit kryesuer e prej hayatit, nëpër një derë të punueme në trajtë harku, hyhej nder ahre që ishin dy ose tre, simbas madhësisë së shtëpisë: ahri i parë kishte një shkallë druni për t'u ngjitë në dhomë të zjarmit tue përshkue kapanxhen; në të djathtë të shtëpisë ngjitë më hayat e gjindej dhoma apo soba e miqve fshatarë dhe malësorë.

Çardaku i madh i hapët, pa tavan, por i mbuluem në vend të pullazinavet, me dërrasa të ngjituna dhe të përputhuna bashkë, rrethohej me parmakë druni të naltë, si ato të ballkonit; parmakë katërqoshet të thadruem secili me ka tri vija të drejta e të zgavrueme, nguleshin nder bira të tabanit e të binarit përsipri. Çardaku ishte i shtruem me dërrasa të trasha dyshemjet, mbërthye me gozhda hekurit punue në vend; shtyllat e çardakut ishin kater; dy latue me qeser të tanë dhamca, mbi të cilat mbështeteshin dy krenë daltue për bukuri, thue se janë kapitete; sipri këtyne trenëve e hatllave të pullazit.

Çardaku ishte i madh, i gjatë dhe i gjanë, i haptë, plot dritë dhe ajër. Aty ngreheshin shtregullat, shtroheshin sofrat, bahej ahengu, luejshin fëmijët, mbusheshin dyshekët, pushonte e prehej fëmija. Në anën e djathtë të çardakut prej të hymit kundruell në drejtim të derës së madhe të oborrit, vinte qoshku, nalt prej çardakut nja tri kambë shkallë, mbyllë kund një meter prej dyshemeje me perde dërrasash e sipri mbyllë me dritare të mëdha xhamash, që thirret edhe oda e xhamave.

Dhomat daheshin me perde tullash kllyç, të vendosuna ose simbas nevoje e diku edhe me perde. Në të majtë te çardaku vinte oda e miqve, me forum ose goviç, me votër të madhe dhe anash me mindere shtrua me shilde, sipri saxhade; mjedis dhome çilima të mëdhaj anash në naltësinë e dritoreve, Lëpoza (segjijjat) plot me shishe, çinia të ndryshme e ndonjë armë të vogël; në të hymë të dhomës, përballë oxhakut, vendi i arkës së nusës, me musander në njënën anë, për dyshekët e miqve dhe përsipri trapazanit me lloj lloj daltimesh punue në dërrasa arre. Tavani me rozetën në mjedis, gdhendë me lule dhe me shtroje shamatatelit, pafte që shushuritte sa herë çelej dhe mbyllej dera. Në qoshe te musandrës dera tjetër komunikuese me dhomat e tjera.

N'anën përballë dhomës së miqve, dhoma divide ose zyra e të zot të shtëpisë, ku mbante tefterët, dividin, mereqepin, shishe me ranë të imët për të terë shkrimin dhe arkën venedike ku ruente dokumente tregëtie ose të tjera. Edhe kjo me tavan musadre, oxhak të punuem në allçi dhe serxhija e palica. Ndër mure varë armë të gjata krahu ose brezi, vezme, vojanica, harbija: armët ishin; koburet, xheverdaret e ma vonë alltijet e martinat. Midis armëve ndodhej edhe sylahi, tagani, me ndonjë shish hanxharë.

Ngjitë me dhomën divide, oda e të zotit të shtëpisë, me derë komunikuese. Përbri dhomës së miqve, dhoma e beqarëve, në fund dhoma e pleqve; ngjitë me dhomën e të zot të shtëpisë, dhoma e vajzavet dhe në fund, mjedis oda e zjarrit që njiherit ishte dhe dhoma e bukës. Anash qeleri dhe banjot (tualeti).

Të gjitha dhomat e shtrume me qylyma, jastekë mbështetë për mur dhe me nga një ose dy arkë për rroba. Oda e zjarrit kishte mjedis bri murit votren e madhe, me nga dy dritore anash qorre për barakë e vena dhe në fund bri stjollit, çarraniku ku ruheshin gjellët dhe bylmeti.

Kur ndokush bante mendim me ngrehë shtëpi, thërriste ustah- bashin i cili i bante llogari materialin që nevojitej në qerre; kaq qerre gurë, kaq kuaj ose barrë gëlqere, kaq copë trenë, dërrasa, pullazina, mertekë, ditët e punës dhe hakun qesim.

Si çeleshin themelet: Ditën e caktueme me nisë punën, therej dashi në gur të themelit, të cilin e hajshin të pjekun mjeshtrit që do të punojshin së bashku me të zotin e shtëpisë dhe



atë ditë nuk punohej ma; kur shtëpisë i vihej pullazi, kojshitë kishin zakon me i dergue dhurata, si: mësalla, peshqirë, shami, breza, etj., të cilat ustahbashi i varte horizontalisht prej njerës maje në tjetren të kulmit. Sa herë që vinte peshqeshi dhe mjeshtri e merrte në dorëzim, bertitte me za të naltë sa me u ndigjue ku tek N.N. ka çue peshqesh këtë send, Zoti e ruejtë shëndosh me çka ka, dhe i kërsitte çekiçit për trena e dërrasa të pullazit; me krisma të tjera e përcilleshin të gjithë ustallarët të mbledhun tok rreth dhuratës. Kur merrte fund goditja e shtëpisë, peshqeshin e ndajshin me short ndermjet të gjithë punëtorëve. Ustahbashi e kishte për detyrë morale me u sjellë afro dy javë nëpër shtëpi, para se me e dorëzue për të pamë mos kishte gja të paplotësueme. Në dorëzim merrte kistin e mbramë të pagës së hakut dhe çdo ditë shtrohej sofra për nderë të punëtorëve. Shtëpiat e çerekçijve, mesatarëve, zanatçijve, duhanxhinjve, të shumtën ishin krevete d.m.th. një kati, por të çueme mbi siperfaqe të tokës kund 1-1,50 meter, me një çardak të vogël të çelun përpara, por përmbrenda me të njajtin stil, kurse sasia e dhomave ndryshonte simbas mundësive financiare dhe nevojave të shtëpisë. Të vorfnit e kishin përdhese; vetëm odën e mirë e cila njëheri ishte edhe dhomë fjetjeje dhe dhomë pritjeje, tavanin e kishte të thjeshtë, por musandra sargjiat, dhe palicat nuk mungojshin. Reshperët e tuxharët e mëdhaj, në fund të oborrit kanë pasë zakonisht kullën e sanës ku poshtë mbajshin lopën, kalin e shalës dhe përbri kullës, jerevinë, dy dhoma përdhese pa tavan, ku kishin furren për të gatue, votrën për të përvlue teshat në fi, ulishten, etj. dhe ku në vjeshhtë bajshin kazanat e rakisë.

Borgjezia e vogël tregtare në vend të kullës kishin nga dy oda shtëpi që i vendosshin me qira vjetore dhe banuesit kishin për detyrë me dalë e me çelë deren e oborrit sa herë trokiste kush për nevojë ose për qejf. Përveç ditës në shej, dyert e oborrevet rrjedhin mbyllë vazhdimisht: ditën me malldan dhe natën me shula. Kjo mënyrë sistemimi duhet pasë parasysh se jo të gjithë shkodranët patën ikë jashta vendit, kur e pushtoi Turqia, por si u struken malevet, dalëngadalë zbriten në fushë e mandej u rrasen në qytet ku xuen vend dhe nisën me u përtëri.

Ndriçimi i rrugëve. Kah viti 1875 qënë vu në krye të ndonjë rrugice kryesore, te pallati qeveritar dhe bashkiak, para trupit konsulluer, para zyrave të kryefetarëve, disa bërryla hekurit me nga një kuti xhamash dhe përbrenda me nga një kandil nr.11 mjesa, aty-këtu nëpër pjacë këto kafaza me kandila brenda ishin ngulë në disa shtylla drunit, afro tre katër metër të gjatë, të cilat deri në vitin 1900 i ndizte përnatë njëfarë Temo, i veshun me këmishë të gjatë, xhurdi e xhamadan e qylah, porsa avitej muzgu, ky me shkallë në krah vraponte rrugë në rrugë me i qitë vojgurit, me pastrue gypat, me i dliurë stejën dhe i ndezte; mbas këtij e ndoqi këtë zanatë Cin Ashiku. Rrugët e dyta, rrugicat, mbeteshin në terr dhe nuk kishte lëvizje. Kur ndokujt për qejf ose nevojë i takon me dalë natën, ky duhet t'ishite i pajisun me kandil dore xhamash dhe herë mbas here me lëshue za, që të mos merrej nga patrulla për njeri i dyshimtë ase bakeq. Në rasë shtetrrëthimi i dare yrfije, lypej me pasë një teneqe me dorë dhe me shkue tue kërsitë për të dhanë za. Me hymjen e ushtrive malazeze në Shkodër, qënë vu disa shtylla hekurit të naltë 5-6 metër dhe të thyeme në trajtë të numrit 9 ku vareshin disa kandila me voj gurit, por në sa vende si në kohë të Turkut. Këta lloj kandilash ishin të fabrikës Olzo të Vjenës (Austri); ky lloj ndriçimi vazhdoi edhe mbas konsolidimit të shtetit shqiptar, derisa sa u instalue centrali elektrik i Bashkisë së parit me dru më 1922, mandej, kur shoqnia S.E.S.A mori konçesionin e ndriçimit, u përdor drita e shkaktueme me korrent më 1930. Kandilavet,

kohen e Malit të Zi dhe gjatë qëndrimit të Fuqive të Mëdha ndërkombëtare, u bani shërbim Mark Celi. Mjetet e udhëtimit. Mjeti kryesor i udhëtimit ka qënë kali për qytetarë, ndersa për malsorë dhe fshatarë ishte qerrja, ku punonte mushka për male dhe gomari për fushë.

Rrugët ishin si mos ma keq; dimnit baltë, llom, skillop, ndersa verës pluhun e tym. Rruga e parë që u ndertue Shkodër-Tiranë qe punue nga ushtritë austro-hungareze me punëtorë angarie për nevoja ushtarake.

Kur zejtarët apo tregtarët dojshin për nevoja me udhëtue gjatë, rrugën e bajshin me karvane dhe për siguri jete e pasunie merrshin qiraxhinj ku ishin ma trimat, mbasi shpesh ngjante me ndeshë udhës në cuba dhe hajdutë dhe me ba pushkë me ta.

Udhëtari që donte me udhëtue për Tiranë, do të ndiqte këtë orar dhe itinerar; nisja bahej në mëngjes kah ora 6 dhe kah ora 12 mbërrishin në Barbullush, ku ishte hani. Këtu hante drekë me bukë e djathë e vezë të fergueme. Mandej mbas një pushimi të shkurtë, me marrë drejtimin e Lezhës, ku flejshin në han. Si pishin kafet dhe hajshin cillen, merrshin udhën për në Milot për të ngranë drekën dhe me ba pushim. Po t'ishin kuajt e mirë, dita kalohej e te hani i Gurit të Bardhë ose edhe në Burizanë, ndersa darka te hani i Babajt në Fushë të Krujës ditën tjetër: Mandej drejtoheshin për në Tiranë ku arrijshin në të errun të natës.

Edhe për qytet si mjet udhëtimi ishte kali për pasanikët, fëmijët vithe kali dhe për çerekçij me bartë fëmijët kaliboç, hamballicat, ndërsa shtresa e vorfen ecte në kambë.

Të parën karrocë në Shkodër e pruni Shan Nika, tregtar e drejtimin ia besoi Gjokë Dragushës. Të parën biçikletë e pruni Luigj Jakoviçi dhe bani bujë të madhe në atë kohë, sepse njerëzimi habiteshin se si ecte ajo vetë pa qenë ngrehë prej qevet. Kur më 1914 Zef Mani pruni në Shkodër të parin automobil, kjo qe një ngjarje e jashtëzakonshme dhe mbarë qyteti kishte dalë me pa seri. Më 1915, kur dy aeroplana Francezë me nga dy krahë zbritën së parit në Perash, s'mbet kush pa shkue me e pa, mbasi nuk besonte kush se njeriu mundet me fluturue si zog.

Me 1896-1897 pat ardhë në Shkodër një italian i quajton Gjakomo Merigi (Giacomo Merigi) i cili përhapi lajmin nëpër qytet se ai në filan ditë kishte për të fluturue me balonë deri në qiell. Shkodra mbarë rrani në shtëpi të Rrakacojve me pa mrekullitë. Ky kishte pru me vedi një aerostat dhe mbasdite si u mblodhën njerëzit, u kap për të dhe era e çoi nalt tue i dhanë drejtimin kah Zalli i Kirit ku edhe ra. Naltësia që kapi qe afër 150-200 metër.

Për këtë ngjarje udhëtimi ajror, një auktor i panjoftun, nxorri këtë vjershë gaztore, gjetun në dorëshkrimet e Gjon Selës:

Me sende 96  
N'Shkodër bani një vaki  
Gjithë dyrnjaja doli jashtë  
për me pamun mrekulli.

Jakë Merigi ngjitet n'balonë  
Me shum dije e marifet  
Ndej n'hava der mbramje vonë  
Dhe n'zall t'Kirit shtri u gjet.

Mba si bani laradash  
Nepër zallë tue u shkapetë,  
Bereqavers i shpëtoi rrashta  
Dreqi e di ku kishte tretë.

Çelja e rrugëve të reja: Në vjetin 1894 Shaqir Pasha për të mujtë me shkurtue rrugën që do të bajshin banorët e Arrës së Madhe, se një pjese i takonte me u sjell kah Ura e Madhe për të vojtë te shtëpia, në rrugën ku ishte shtëpia e Vaso Pashës, hapi rrugën e Çekejve që u thirr Rruga e Re. Qazim Pasha, në vitin 1897 hapi rrugën e Spitalit. Mustaf Nuri Pasha urdhnoi që Jezuitët të çelin derën e Gaspër Llupit për t' i lanë ditën kalim njerëzisë, ndersa natën ajo derë prap mbyllej dhe po ky Pashë hapi rrugën që kapet me Skanderbeg. Vjetin 1902, kur nisi me u ndertue kisha Françeskane, u çel dera që mbyll rrugën te shtëpia e Gaspër Lufit, ishte ma parë Kuvendi i murgeshave Stigmatine, mandej shkolla françeskane. Kjo derë, si ajo e Gaspër Llupit, mbetën aty deri mbas luftës, nëpër të cilat kalojshin këmbësorët tue u përshkue nëpër një derë parmakësh hekuri. Mullijtë e qytetit. Qytetarët e Shkodrës për të blue drithin shkojshin në Vrakë, Oblikë, Ganjollë e Gomsiqe e kjo ishte një pengesë e madhe dhe humbje kohe.

Sikurse dihet deri në fillim të shekullit XX, Kiri derdhej në lumin Bunë ndërmjet Kirasit prej kah merr edhe emnin vetë lagjja; tokët që merr prej Golemit, Mes Meselim zgjateshin deri në qytet; tokët e pjesës verilindore të qytetit ishin vneshta e ullishta prej Rëmajve, buzë kodrës së Kirit deri ku janë sot vorrezat katolike.

Kah viti 1880 disa bejlerë vendas me influencë kërkuen nga sundimtari me i dhanë lejen me sjellë ujët e Kirit në qytet për të ndertue disa mullij për të blue në qytet, gja të cilën valia ia dha. Filluen punimet e Stomit të Golemit ku u çel Vija e Amanëvet nga e cila shpërndahej ujët në disa drejtime. Punimet për çelje të vijës nuk u bane me kriterë e teknikë dhe kështu, porsa nisën shinat e vjeshtës Kiri u frye shumë dhe, në vend të drejtimit të maparshëm, uji vërshue në drejtim të Rëmajve dhe erdhi e ndeshi te çinari i Zef Zorbës me aq furi, sa çeli një gropë të madhe fort tue nxjerrë prej vorresh deri arkat e të vdekunvet të cilët i barti e i çoi deri në Perash. Tokat, kah filloi me kalue Kiri, i qiti fare. Qyteti mbeti për disa ditë nën ujë dhe damet qenë të panumërueshme. Mustafë Asim Pasha u mundue disi me i kanalizue, por për çdo vërshim, Shkodra ishte nën kërcënimin e Kirit.

Hila i Marinit, një burrë qerraxhi, tue dashtë me ba një vepër të mirë me qytetarët, u vu me ndertue pendën e zezë, sipri vorrezave katolike, dhe deri diku ia doli qëllimit. Nësa po vazhdonte punën, vjen një grumbull ushtarësh turq për manovra dhe e pyesin se ç' po bante: "Po mundohem me ia ndalue hovin Gjeloshit të malevet",-ia ktheu Hila. Qeshen. (Duhet dijtë se Gjelosh, qytetarët thirrshin Kirin). Oficeri turk i grah kalit e fill e te Pasha tue e paditë Hilën se ishte në marrëveshje me malsorët dhe se dojshin me i ra ushtrisë turke. Hila kapet e futet në burg dhe mbas nderhymjeve të autoriteteve kishtare dhe konsullore mbas, tre muejsh dhe dhetë ditë burg qe lirue me porosi mos me ba ma asi fjalësh.

Pendë e ndertueme me shkrepë të zez prej tij, vazhdoi për shumë vjetë me pritë vërshimin e Kirit dhe ende sot aty, tue i krye një shërbim të madh popullsisë qytetare.

Penda e Arrës së Madhe u ndertue fill mbas asaj të Hilë Marinit; mbasandej Mustafë Asim Pasha ndertoi pendën e Stomit të Golemit, te Vija e Anavet, për të pritë vërshimin e

Kirit në qytet; Shaqir Pasha ndertoi pendën e bardhë sipri lagjes Rus.

Kah viti 1922-1923, mbas vërshimit të Kirit që thei pendën, kje meremetue me gabiona telash mbushë me zallë. Ura e Kirit ka pësue disa herë ndryshime, në kohën e Turqisë ka qënë në fillim të pendës së zezë; mandej prej ushtrisë u ndertue paksa nën vorrezat katolike; mandej në vitin 1931-1932 u çue ma poshtë tue u qitë drejtimin me e lidhë me Serreq "hem me u ba qefin katolikëvet që kërkoshin të ndertohej aty ku e kishte pasë goditë Austria, hem myslimanëve që ngulshin kambë me e lidhë me Perash me anën e Qafë- Hardhisë."

Me kryemjen e mullive kohën e bejlerëve, u nda ujët e Kirit nëpër qytet në tri degë; njëna kalonte pranë Ostahanës (Spitali Civil) ku sot janë kazermat e ushtrisë dhe delte te Ura e Maxharrit në Rus të Madh, prej ku uji shërbente për me blue në mullinjtë e Dudasit, Ndocej dhe mullini i Bostanit që u derdhte në Bunë; te Çinari i Lleshit, në fushë të Bunës; u quante kështu, sepse aty grosistat shtijshin lasat me la leshin, me e terë, me e shtie nder thasë për eksportim.

Tjetra vijë kalonte para Spitalit Ushtarak dhe mbasi vinte në lëvizje mullinin e Rusit, delte në fushën e Shkjave (Hadrej) ku ishte mullini, dhe tue kalue para Sahatit t'Inglizit, dredhonte mbas dugajës së Rrojit, vinte në lëvizje mullinin e tyne, kalonte për të gjatë Parrucës dhe binte në Serdarej ku ishte mullini dhe kalonte nën urën e Françeskos prej se Françesk Tagliapjetra e kishte punue mbasi ishte mjeshtër në daltimin e gurit, dhe mandej ujët derdhej në Bunë. Ky për së gjalli pregatit rrasen e vorrit me këtë epitaf:

"Addio patria mia  
Scutari d'Albania  
Fate quel che volete  
Che qui vi aspetto".

që mund të shqiptohet kështu:

Lamtumirë, o Atdhe im  
E ti Shkodër e Shqipnisë.  
Veproni si të dueni,  
Sepse këtu ju pres...

Hila i Files, kangëtari dhe vjershëtari, shkodran e ka përjetësue Françeskon me një kangë që këndohet në heng shkodran.

Vija tjetër përshkohej nëpër tokë buke dhe livadhe të Rusie para Fabrikës Tarabosh tue kalue nëpër kopshtije, binte në Fushë Çelë ku ishte mullini. Prej këtej nëpër vorreza Milet-bahçe (Lulishte Popullore), e mbas pallatit të Qeverisë nëpër Urë Dervish Begut sillte mullinin e Bajës së Vogël e tue e përshkue gjithnjë nëpër kopshtije, kalonte nën Urën e Kerçirejve, që populli e thirrte aty ku bjen uji mbi ujë dhe tue marrë teposhtë vinte në lëvizje mullinin e Hajdar Agës dhe tue kalue nëpër Uren Gjelokej e të Llakortes derdhej në Bunë. Dalëngadalë mullinjtë u banë pronë e bejlerëve të Shkodrës dhe të Vakufit dhe e drejta e kalimit të ujit mjes kopshteve të privatëvevet mbeti "Kadimi" dhe vazhdoi dhe me instalimin e mullinjve të zjarrit. Dalëngadalë mullinjtë e ujit dolën jashtë përdorimit nëpër qytete, ndersa ndër rrethe vazhduen dhe vazhdojnë. Ndër katolikë familja Çeka pati mulli në Vrakë dhe familja Shiroka, te Arra e Madhe, në qytet.

Kushtimi i një mullini ujit deri në 700 napoliona flori si dhe taksë bluemeje merej ujemi (uji i jem). Çinarët. Ka pasë kenë zakon në Shkodër, kur një njeri donte me e ba të pavdekshëm emnin e vet, me mbjellë nëpër disa sheshe nga një çinar, nën hije të cilit populli të prehej ndër orë të lira ase në shtegtim. Në Shkodër kjenë edhe janë disa, si: Çinari i Zef Zorbës te vorrezat katolike, Çinari i Tophanës aty ku qysh më 1600 qe zyra famullitare katolike, Çinari Hoxhës së Dheut dhe Çinari në Ajasëm e në Tepë. Ndër të zhdukun qenë: Fojletat e Punëtorëve aty ku sot është Spitali Infektivëve, Lama e Spahijve, ku sot është ferma Perlat Rexhepi te Ura e Kirit dhe Çinari i Zhdukun. Lama e Spahijve mori emnin, nga se aty mblidheshin dhetarët të quejtun Spahi dhe si paguejshin timaret begut, pjesëtojshin fitimet ndermjet vedit, në dam të fshatarit dhe bujkut.

Ka mbetë në Shkodër fjala: Shkrueje në çinar të Kuçit, për një borxh që nuk merrej ma. Lama e Spahijve mori emnin kështu prej se aty, nën hijen e çinarëve, spahijtë merrshin në natyrë hakun e vet dhe aty mblidhej gruni për t'u fshi dhe dajshin fitimet. Lama i Spahijve është e përmendun edhe për luften e madhe që u ba në vitin 1577 ndërmjet ushtarëve dhe ushtrisë turke.

Sheshet dhe pjacat kryesore. Deri në fillim të shekullit XX, dy ishin qendrat kryesore të qytetit: Parruca dhe Serreqi. Në Parrucë ishte një farë soj hani, me kafe nen te, ku mblidheshin ma të shumtit ustallarët aty kah prendimi për të pasë vend pikpjekjeje për të marrë punime dhe në kafen tjetër ku rrijshin bejlerët e agallarët me kalie kohën me dembeli; me daljen e karrocave, Parruca u ba stacioni i tyne dhe kështu ka mbetë deri më sot. Në Parrucë ishte edhe xhamia kryesore e qytetit dhe në oborr kishte "Musllupin" d.m.th. depon e ujit per të marrë abdes.

Në vjetin 1884 Mustafa Asim Pasha ndertoi kazermat ushtarake tri copë njena për administratë civile (aty ku sot gjindet Liceu i shtetit) tjetrën për administratë ushtarake (e rrenueme nga Musa Juka në vitin 1922-1923) dhe e treta për xhandarmëri (ku tani është shkolla pedagogjike) fill, menjëherë, Beroviqi ndertoi disa dugajë në të cilat instaloi një punishte sheqerash, llokumash dhe marmelate, një tjetër për kafe-pijetore me salon bilardi që ndiqeshin nga oficerat turq dhe një tjetër për gjana ushqimi. Përballë këtyne kazermavet gjindet një ndërtesë pune në xhadën, ku ishin instalue disa zyra. Kjo ndërtesë kishte hymje me një shkallë guri të latuem, të parën kah lindja dhe të dytën kah prendimi. Në katin përdhe rrijshin zaptij e spahij (kalorës civila të paguem prej bejlerëve që kishin timare) të cillët xhandarmaria i përdorte si korriera e postiera. Në katin e sipërm, në krahun e majtë ishte zyra e komisariatit të policisë ku ishin afro 30 vetë. Në krah të djathtë zyra e kadisë për kunorëzime dhe çashtje që i përkisnin Sherjatit.1) Mbas këtyne zyrave e pasaportave dhe gjykatores civile (meqemet).

Shpeshherë ka ngjarë që një njeri për t'u tregue trim dhe me u përmendë, ka qitë pushkë në "Divan-Hane" d.m.th. në saraj të qeverisë, sikurse dokumentojnë kangët e qituna e që gjinden të përmbledhuna në librin e Kasem Taipit fq. 163, 200.

Kjo ndërtesë u shemb në vitin 1910 për t'i lëshue vendin një tjetër ndërtesë madhështore, vepër e Ing. Briot, në shërbim të Turkisë.

Aty kah viti 1900 u ndertue edhe shtëpia e oficeravet turq, ku kishin edhe mensën e që sot është Biblioteka e Shtetit, por që nga viti 1916 deri 1945 përdorë për zyrat e Bashkisë (Beledijes). Bashkia e kishte ndejen në ndërtesën në krye të rrugës së Hotel Turizmit; kah viti 1878, një pashë i quejtun Shallvar Kuçi shtini me goditë Lulishten Popullore që u quejt "Milet Bahçe" dhe populli menjëherë qiti disa bejta ndër të cilat:

Fusha Qelë asht kenë harab  
Kanë luejtë f'mija rrasa e buq,  
Komandanti qytebar  
Na ka veshun shallvarë të kuq...

Dalim e shetisim  
E po bajmë pallavra  
Hallku po gjezdisin  
Prej aty ku bjen daulla...

Shënim: Sherjati - gjyqi fetar

Më vonë ky shesh u ba qendra kryesore e qytetit dhe që nga viti 1913 e tektej është zemra e Shkodres.

### **Randësia dhe ndryshimet historike të Kishës së Shkodrës**

Momzen në vëllimin XV të historisë së Romës, botue në Berlin më 1927, në fq. 186 thotë ndër të tjera se "...buzë Shkodre ndeshën vende që i përkasin sundimit të Çezarit e të Mark Antonit si edhe mbas ndamjes së Perandorisë në shek.IV, ata që shkojnë në provincen latine të Dalmacisë e ata që bajnë pjesë në krahinën greke të Maqedonisë." Sikurse dihet kah fundi i shek.III, krahina e Dalmacisë ishte e ndame në "Dalmatia Salonitane e Prevalitane. Kjo përfshinte Dioklenë (Vuksanlekajt e soçëm), Shkodrën, Lezhin, e përmblihte dhenat që shtriheshin ndërmjet Gjiut të Kotorrit e të Sarajevës së sotme, grykën e Matit e vargun e Shar-Dagut mbi Malin e Zi. Si ipeshkëvijtë e Prevalitanës, si edhe ata t'Epirit Nova, megjithëse politikisht të varun nga Bizanti, vazhduen me qenë me Kishën e Romës, o drejtë për së drejti, ose nëpërmjet të Vikarit Papnor të Selanikut. Mjaft u mundue patriarku i Stambollës me i ba për veti dioqezet e sipërshtënueme, por nuk ia doli.

Në vitin 535, Perandori Justinian, tue ndjekë një kriter politik, nder sa provinca kishtare, shtrini edhe Prevalitanën nën juridiksionin e Justiniana Prima-s, seli kryesore krijue prej tij në Bederianen e soçme, afër Shkupit.

Zeiller, në librin e tij "Orig. Chret. fq. 18 Mars 545 ngastrat që i përkisnin dioqezës të Gracies, ia mbështeti përgjithnjë, ndër të cilat edhe Prevalitanën. Si Primati i Justinianës, si edhe ai i Tesalonikut varej nga Papa i cili konfirmonte zgjedhjen e ratifikueme nga perandori dhe i dergonte "Pallium". Ishte vetëm një vikar i thjeshtë papnor e s'kishte aspak të bante me patriarkën e Bizantit. Me fjalë të tjera, Prevalitana s'bante tjetër veçse me kalue nga juridiksioni i Vikarit të Selanikut në atë të "Justinianës Prima" që nuk pati jetë të gjatë, sepse mbas vitit 602, kjo seli kryesore, treti gjurmë si edhe dioqezet që varehin prej saj. Në këtë datë, Papa Shën Gregori Madh i shkruente Primatit Gjon të Justinianës në lidhje me një ipeshkëv të Dioklesë.

Kisha e Shkodrës, në mbështetje të dokumenteve që kanë mbetë, shpirtnisht dhe juridikisht u var vazhdimisht nga ajo e Romës. Diokleja, qytet i përmendun qysh në kohën e mbretit Genc e që asht e vendosun aty ku bashkohen Zeta e Moraça, bahet

kryeqytet i Prevalitanës, njatëherë kur ajo ngastër bahet autonome, porse që nga fillimi, nuk e pati të drejtën metropolitane. Përkundrazi kjo e drejtë duket, simbas dokumenteve, se i përket selisë së Shkodrës në selinë e ipeshkvijvet që fillojnë në vitin 387 me një farë Bashet (Bassus) dhe mbarojnë me Konstancin më 601; si ipeshkëvij të Dioklesë përmenden vetëm tre: Evadrimbë 451, Fali dhe Nemesi më 602. Mandej vjen një periudhë e errët si për njanën, ashtu edhe për tjetrën dhe duket se i kaloi Dioklesë nga Shkodra atëherë kur ky qytet u ba kryevendi i krahinës omonime.

Karl Pooten me Farlatin përmendin një arqipeshkëvi diokleciane, Gjonin, i cili ia paska lanë emnin e vet historisë kah viti 920, porse duhet vërejtë sa që nga shekulli VII e mbrapa Diokleja e bukur iliriane ishte bamë shkreti dhe kjo punë qet poshtë thaniet se gjoja car Simeoni i Bullgarisë ta këtë shqymë më 927 dhe që në këtë rrethanë arqipeshkvi Gjon të këtë kërkue strehim në Raguzë e kështu bjerrte titullin dhe të drejtën metropolitane.

Dokumentat që ta provojnë këtë nuk ka, sikurse na e dishmon Rovinskij në A.Alb. fq. 10. Një gja duket e sigurtë dhe asht se kah fillimi i shek. XI Tivari varet nga Raguzë (Shih. A. Alb. Nr.60).

Ma vonë, kohën e Komnenajvet, autoriteti i Raguzës erdhi ngadalë tue ra nën shtypjen e mbretenvet sllavë nga njëna anë, të cilët tue synue me krijue një kishë gati kombëtare, përkrahshin Tivarin dhe nga ana tjetër Tivari vetë prirej me ngjallë emnin dhe të drejtën e kishës së Dioklesë. Posë kësaj, kishin fillue kundërshtimet ndërmjet Splitit dhe Raguzës për kah e drejta metropolitane që përfundoi me fitorën e kësaj të fundit. Kështu që Tivari kishte ardhë tue u shkëputë aq, sa Gregori, me ndihmën e klerit Spalatin, kishte mujtë me fitue "Pallium" kah viti 1178 (Shih. A. Alb. I. Nr. 63).

Raguzë nuk e la me aq, por e mori uhanë kundër Tivarit për njëfarë kohe, derisa, kah gjysa e shek.XIII, çashtja e madhe përfundonte njëherë e përgjithmonë në dobi të Tivarit, sikurse del nga një dokument i Klementit III me 1089, që ia mbështet kishës metropolitane të Tivarit, kishët sufragane (të varuna) të Kotorrit, Ulqinit, Shasit, Shkodrës, Drishtit, Pultit, Serbisë, Bosnjes e Tribunjes e të gjithë kuvendet (manastiret) si të dalmatinëve, ashtu edhe të grekëve e të sllavëve.(Shih. A.Alb. I.Nr. 68).

Një gja që bien në sy asht se, ndër të gjithë dokumentat që bajnë fjalë për kundërshtimet mes Raguzës dhe Tivarit, gadi gjithkund pak a shumë të kjartë dalin në pah emnat e njajtë të dioqezevet të sipërpermenduna.

Nga një letër e Inoçentit IV e datës 18 Mars 1232 kuptohet se çashtja asht ende në kambë.

Por me 27 qershuer 1360, Aleksandri IV, i urdhnnon Lorencit, arqipeshkvit të Tivarit, që me shugurue ipeshkëv të Sardës (Shurdhahit) Fr. Pjetrin prej Tibure. E me këtë, mbas kundërshtimesh të vjetëve të kaluem i mbeti e drejta metropolitane Tivarit. Kësaj së drejte iu dha nuk dihet se me ç' datë titulli "Primati i mbretënisë së Serbisë" që i përgjigjet Myrjes së Moçme. Klementi VII, me letren e datës 26 nanduer 1523, drejtue Lorencit, thëret arqipeshkvin e Tivarit primat i krejt Mbretënisë së Serbisë e këte e përforcon nga një tjetër letër e datës 27 maj 1524.

Marin Bici prej krahinës s'Arbënit (1608-1623), pasardhës i tij, Pjetër Mazrreku nga Prizreni (1624-1635) si edhe ma vonë i përmenduni Vinçenc Zmajeviqi nga Perasti (1701-1715) po ashtu para tij edhe Gjergj Bardhi nga Sapa (1635-1644) na e provojnë këtë të drejtë, kur vizituen të gjithë kishat e Shqipnisë dhe të Serbisë, megjithëse Zmajeviqi këtë detyrë e kreu si vizitor apostolik.

Simbas relacionit të Dom Shtjefen Gasparit, vizitatorit apostolik në Shqipni, në vitin 1671, statistika e dioqezat të Shkodrës ishte kjo; kah veriu fillonte te Pëdhana e Kelmendit ase e Hotit dhe arrinte kah Jugu deri në Pulaj. Për ipeshkëv Imzot Pjetër Bogdanin thotë se ndejën e kishte 82 milje larg Shkodre, bri malit t'Agrit.

Dioqeza i malevet përfshinte: Rrjolli me 80 shtëpi e 156 frymë; kisha bante pjesë të pashkëputun me shtëpinë e rindertueme nga ipeshkëvi i Shkodrës.

Fshatrat që vareshin prej kësaj dioqeze ishin: Çamarati me 11 shtëpi e gjashtëdheteekater (64) frymë; Dodçi me 3 shtëpi e 26 frymë; Reçi me 25 shtëpi e 5 frymë; Lohja me 20 shtëpi e 183 frymë; Shkreli me 65 shtëpi e 500 frymë, Zusi me 9 shtëpi e 80 frymë; Lugji (Grykë Lugje) me 13 shtëpi e 80 frymë; Kastrati me 75 shtëpi e 660 frymë; Hoti me 130 shtëpi e 700 frymë; Kelmendi, me kishen e Kelmendit ndertue prej vetë kelmendasve në vitin 1651 përfshinë: Muriqin me 6 shtëpi e 40 frymë; Gjonoviqi me 7 shtëpi e 60 frymë, Lesoviqin me 15 shtëpi e 120 frymë; Milloshin me 7 shtëpi me 40 frymë; Vukli me 32 shtëpi e 200 frymë; Rrvesten afër Komes të Kuçit me 6 shtëpi e 30 frymë; Zeten nën Tuz me 7 shtëpi e 40 frymë; Selcën me Muriq 34 shtëpi me 280 frymë; Rrabjenin e Radotinës me 60 shtëpi e 400 frymë. Të gjithë shkojnë me pa meshë në Spanik, kanë edhe vorret. Rrafshnalta e Kelmendit me rrafshnalten e Nikçit e të Radovicës kanë 112 shtëpi me 560 frymë. Kelmendasit e kishin zaptue këtë fushë tue përzanë banorët. Gruda me Triepshin, Ledima e Kuçit, Koça e Kuçit e Tuzi 306 shtëpi me 2530 frymë; Gradiskija nën Reç, e kthieme nga ortodoksia me vepren e ipeshkvit të Shkodres, kishin 10 shtëpi me 100 frymë, buzë liqenit të Shkodres varet së bashku me tjerë fetarë që banojnë për te gjatë Liqenit të Shkodres me 40 shtëpi e 400 frymë e varen nga Rrjolli.

Ipeshkvia e Shkodrës së poshtme: Trushi i Sipër me kishen e Shirqit e ndertueme për të nxanë 3000 vetë simbas mbishkrimit të mbretneshës Helena në vitin 1290 asht mbajtë shumë keq, si me kenë stallë; Pullazi në rrenim e sipër. Shirqi ka 30 shtëpi me 300 banorë. Ka edhe kishën e Shëna Prendës. Me kishën e Shirqit shkon edhe Trushi i Poshtëm me 30 shtëpi e 300 frymë. Me Trushin e poshtëm shkon edhe lagja e Konit me 60 shtëpi e 400 frymë. Vjen mandej Buzëgjarpni me 55 shtëpi e 279 frymë. Oboti me Serreq me 28 shtëpi e 350 banorë me kishen e Shëna Baftit (Shën Bahtit). Dajçi i Madh me 24 shtëpi e 70 frymë e përfshinë katundet e Mushanit me 8 shtëpi e 30 frymë; Grashi me 9 shtëpi e 40 frymë; Belaj me 5 shtëpi e 30 frymë; Samrishi i Sipërm e i Poshtëm me 26 shtëpi e 120 frymë. Varen prej këtij katundet mbatanë Bunet; Sukubina, Lizna, Kruvetina, Stuçja, (Shtufi) me 800 frymë.

Shasi, dikur qytet i madh, sikurse e dëshmojnë rrenojet e 365 kishavet ka nën vedi disa katunde me afro 2000 frymë. Shën Gjergji me 120 shtëpi e 1300 frymë; Pulaj me 30 shtëpi e 230 frymë.

Sheldija me kishën e Shën Hieronimit me 20 shtëpi e 150 frymë; me të shkojnë katundet Gavoç me 16 shtëpi e 80 frymë; Ganjolla 17 shtëpi e 90 frymë; Jubani me 20 shtëpi e 140 frymë. Nga Sheldija varet edhe Dushmani, Arra, Vilza, Mazrreku e Meshkalla me 40 shtëpi e 300 frymë.

Shiroka e Kishaj me kishën Shën Mërisë Magdalenë, me 270 shtëpi e 200 frymë (banorë).

Kisha Katedrale kushtue Shën Shtjefnit gjindet në Barbullush me 75 shtëpi e 800 banorë; prej kësaj varen Shkreli i Barbullushit me 115 shtëpi e 1600 banorë; Kulli me 42 shtëpi e 400 frymë.

Krejtë dioqeza kishte 7549 shtëpi e 17.283 frymë. (Shih "Hylli i Dritës", viti 6, nr. 11, fq.



7, nr. 3, fq. 154 e vazhdon).

Mbas një boshllekut prej 540 vjetësh fillon seria e barijve të kishës së Shkodrës të cilët nuk janë më arqipeshkvij, deri sa me 15 mars 1867 Piu XI ia kthei dinjitetin metropolitan n'Acque principialiteti si ai i Tivarit; Imzot Karlo Pooten i cili kishte kenë i transferuem nga Tivari, mbajti titullin e juridiksionit mbi të dyja metropolitë, deri sa me Imzot Pashko Guerinin Shkodra pati arqipeshkvin e vet, me 6 fruer 1887. Kishë sufragane të Shkodrës genë dioqezat tashma të zhdukuna të Shasit (Suacium), Drishtit (Drivastin) Ballazit (Balesium) e të Ulqinit (Dulcinium), Sarda (Shurdhahi) e Vau i Dejës (Dagnum).

Prej këtyne dioqezavet kemi rrenojat ose gremadhat e këtyne selinavet ipeshkvnore të Shazit sipri liqenit omonim jo fort larg prej bregut të djathtë të Bunës; gremadhat e kështjellës së Drishtit aty ku prroni i Kirit derdhet në fushë; Balesi sipri një shkambi ku bashkohen dy përrojet që përbajnë dheun e Rrjollit, Ulqini shpëtoi deri nga shkatërrimi. Ippen la të shkrueme se në Shas kjenë një seri prej 27 ipeshkëvij. Një mbishkrim i gjetun ndër rrenojat e qytetit, prej vetë Ippenit tregon se në vitin 1262 kje ipeshkëv Marku, ndër sa të tjerë përmendet një ipeshkëv i kësaj i quajton Vasil në vitin 1530 kurse qyteti dhe kisha u zhduk nën rrënojë. Drishti, ndoshta pse i mbrojtun nga malet, si seli ipeshkvnore pati jetë ma të gjatë dhe, megjithëse jo gjithëmonë e kjartë, tue njohë edhe anonimnat na paraqet 35 ipeshkëvij. Një rrasë varresh me mbishkrime latine të cilën Ippenit e gjet në rrenojat e Drishtit dishmojnë se ky qytet, si edhe Shkodra janë bashkëatdhetarë me Romen e moçme.

Për Ballezin si qytet dhe si seli ipeshkvnore, puna mbetë në errësinë. Hoffer thotë se kisha ipeshkvnore ishte kenë rrenue prej skizmatikëve me 1336 e se në gjysmë të dytë të shek. XV qyteti s'kishte tjetër veçse një grumbull gremadhash. Një mur, avullia e disa rrenoje dishmojnë sot se aty kje dikur kisha e Ballezit. Prej vitit 1347 deri rreth 1487 numërohen 11 ipeshkëvij të kësaj kisha, bile nder dokumente përmendet edhe kapitulli i Katedrales që dishmon se ishte rregullisht e organizueme.

Ulqini, qyteti i vjeter Ulcinium, pati kapitullin e Kanonikëve, arqipresbiterin, diakonat, subdiakoniat, klerikë, kishen katedrale kushtue Shën Mërisë, kishen e Shën Markut të Domenikanëve, pallatin ipeshkvnuer, etj. Selia e ipeshkëvijve të Ulqinit fillon nga 877 e mbaron me 1558 e pati 29 ipeshkëvij. Piu IV e vuni nën administrimin e Imzot Gjon Brunit, arqipeshkëv i Tivarit. Turqit e përshkuen nën shpatë në vitin 1571, në vitin 1745 pati 20 të krishtenë.

Rezidenca Ipezhkvnore e Shkodrës: Shtëpia e ipeshkëvit që përmendet si domus episkopate në 1251 ishte para invazionit turk në qytet afër kishes katedrale kushtue Shën Shtjefnit Protomartir, e cila përmendet në vitin 1403 edhe thuhet se ishte aty deri në vitin 1950 ku pat qënë hani i Ndokës, sikurse e dishmojnë rrenojat e themelet që shifen të mbulueme me dhe e dikur Xhamia e Musllupit qe dikur Kisha e Shën Shtjefnit. Kohën e dy rrethimeve të Shkodrës (1474-77-78) ipeshkvi Françesku II i frenenve të vegjël nuk gjindej. Ndër dhjetë vjetët e parë të pushtimit turk ipeshkëvijtë rrinë larg qendrave të tyne; vetëm Pjetri II me 1518 merr urdhën nga Leoni X me kthye në seli. Gjatë dy shekujve ipeshkvi nuk mujti me qëndrue në qytet, por banoi ndër katundet e Shirqit e të Barbullushit. Në vitin 1656 Imzot Pjetër Bogdani u strehue në shpellën e Rrjollit e të Jubanit. Sa ishte ipeshkëv i dioqezës së Shkodres, Bogdani shkruen se në Shkodër ishin 15.000 katolikë, kurse një shekull më vonë 1745 dioqeza kishte 17 famulli, 2072 shtëpia katolike e 16.271 besimtarë.

Famullia e Shkodrës gjindej në lagjen Tophanë e përbri kishte kishën e Shën Kollit, buzë Urës Kërçirej shndërrue në Xhami, e cila deri vonë ka pasë hajatin përpara, ku me 1917 u pat gjetë një ujëbekore e cila ruhet në Muzeun e Shkodrës. Farlati thotë se ipeshkvi Françesku IV Borci u shugurue në kishën e Shën Mërisë Magdalenë me 8 korrik 1788, nga Imzot Gjergj Radovani, arqipeshkëv i Tivarit tue qenë pranë Imzot Gjon Logoreci ipeshkëv i Pultit, e Imzot Pal Doda, abat i Mirditës.

Deri në kohën e Kongresit të Berlinit, shkojshin me arkidioqezën e Shkodrës famullinat e Shën Kollit në grykë të Bunës, Ulqini, Shën Gjergji dhe Këllezna.

Qela ishte shtëpia e Rapushit.

Kah viti 1737 simbas rregjistrimit të pagëzimit shkruet nga Imzot Pal Kamsi, atëherë meshtar famullitar i Shkodrës, familjet katolike që banojshin në qytet ishin këto:

Abrashi, Ashiku

Babi, Belbaqori, Banda, Bardhi, Bashi, Batuçi, Beltoja, Berdica, Bjanki, Bibashi, Bobozi, Bojaxhija, Boriçi, Bushati, Çapaliku. Çarkaxhija, Çeka, Çoba, Çobani, Çobi, Çurçia, Dajçi, Daka, Dashi, Dedgudha, Dengilaj, Deniva, Demiri, Dika, Dobraçi, Doda, Dodmasej, Drita, Dukagjini, Dushi.

Ejlli, Engjelli.

Galigadi, Gavoci, Gega, Giadri, Gici, Gjota, Gjata, Gura, Gjeçi, Gjeloshi, Gjergji, Gjinaj, Gjika, Gjonlala, Gjini, Gjura, Gjurashi (Gurashi), Gozzi (Gjoci), Grashi, Gruda, Guga, Gurakuqi.

Hoti, Hysenaga.

Junki.

Kabashi, Kakarriqi, Kalamashi, Kamsi, Kasneci, Kazazi, Kazena, Kiçi, Kodheli, Koleci, Komani, Kovaçi, Kosmaçi, Krajli, Kraja, Kranja, Krroqi, Kujxhija, Kukli, Kurti.

Lala, Lazri, Leka, Leniqi, Lezhëi, Lindi, Linëza, Logoreci, Lozani, Luka, Lufi, Luli, Llupi.

Marashi, Marjani, Marini, Markiçi, Marku, Matrishi, Mazi, Mazrreku, Melgushi, Memi, Mesi, Midha, Mjeda, Mida, Misloci, Mosli, Muzhani.

Ndoja, Negri, Nënshati, Nikaj, Nikanji.

Paci, Pali, Parruca, Preçi, Pema, Pepa, Pici, Pjetrushu, Pilota, Pistoli, Plauti, Prendçi, Prendanji, Prifti, Pulti.

Radoja, Radovani, Ramadani, Reçi.

Saçi, Saraçi, Sardari, Serreqi, Shahini, Sheldija, Shestani, Shiroka, Shkreli, Shpori, Shkjezi, Sina, Simiçi, Simini, Simoni, Sinadini, Spathari, Stani, Suma.

Tedeskini, Todri, Topalli, Troshani, Toksi, Tuzi, Vakanji, Valanji, Vala, Vasa, Vasija, Vata, Vala, Vjerdha, Vladanji, Vuçi, Vuka, Vukashini.

Zadeja, Zanji, Zorba, Zojzi, Zuzi.

Disa famulli të maleve në vitin 1864 qënë këta: Kastrati me 1032 besimtarë, Rrapsh, me 1253, Selca me 1899, Traboina me 1187 besimtarë, Gruda me 1022, Kuçi me 255, Triepshi 672, e Vukli me 1621 që administroheshin nga françeskanët. Në vitin 1888 u krijua famullia e Bajzes dhe me 1908 famullia e Vuksanlekajt.

Rreth vitit 1880 arkidioqeza i Shkodrës kishte 22 famulli; Shiroka, Pentari, Berdica, Këllezna, Oboti, Kukli, Barbullushi, Bushati, Trushi, Dajçi, Beltoja, Jubani, Guri i Zi, Sheldija, Rrjollli, Reç e Lohja, Shkreli, famullinat e prefekturës apostolike të fretenvet; Katundi i Kastratit, Rrapsha, Traboina, Gruda, Selca e Vukli.

## THEMELIMI I KATEDRALES

Rreth themelimit të Kishës së Madhe goja e popullit ka ruejtë disa ngjarje e thanie të cilat disa po i rreshtoi këtu:

Kur qe puna me goditë kishën e madhe diftonte Simon Gjini, parsia dhe populli i Shkodres thojshin se e dona të madhe si "Duomi i Milanit". Kolë Mati Tukja tregon se "kur populli bani kërkesen për ndreqjen e kishës, patën thanë se dona një kishë lëkurë lopet, e preme rrypa-rrypa dhe me këtto matën largësinë e saj. Valija u habit e deshi me kundershutue, por i gjegjen "të kena thanë e dona sa një lëkurë lope".

Loro Lufi, kallzon se si u vuene piketat për çeljen e themeleve. Rinia katolike shkodrane, u çuene naten dhe i ndryshuene vendet tue i zgjatun me aq mjeshteri sa vetë inxhinieri të nesërmen kur i pau nuk dijtë me thanë se ishin ata që ishin vue një ditë ma parë prej tij apo ishin luejtë vendit. Kolë Kodheli Marubi, pat thanë se kishte ndigjue prej mjeshtrit të tij, Pjetër Marubit se paria e popull kishin lypë e kërkuë një kishë të madhe tue kundershutue projektin e paraqitun prej arkitekt Pjetër Marubit e të pelqyem prej ordinarit. Mbi caktimin e gjatësisë së ndertesës së Katedrales Gjergj Nikë Sheldija që ndodhej aty pranë, i pat tregue të birit Kolës sa vijon: "Ma së parit e mori lamshin e spagës valia i cili fillin e penit e kishte lidhë vjergë për gisht të vogël të dorës së djathtë dhe i dha krah, mbas tij e mori konsulli i Anglisë, Bonati, i cili e hedh shumë ma poshtë se pasha i cili iu suell tue i thanë se a donte me goditë një kishë për mahallë (lagje) apo per sheher. Mbas tij e morën me radhë Konsulli i Francës, Hiacint Hecquard, që si dihet Franca, deri në vitin 1878 pat pasë protektoratin e kristianizmit në Ballkan; Konsulli i Ruisë, Illiç; Konsulli i Greqisë, Apostollaqi dhe më mbas ai i Austrisë, Ballarini, i cili kapërcej shumë masën e sundimtarit i cili me buzë në gaz u suell: "Dashke me shti mbrendë të tanë kaurrinë e Arnautllekut".

Ditën e shtimjes së themeleve, populli i pafarë kishte ardhë nga të gjitha anët e krahinat e Shqipnisë dhe qyteti mbanë kishte marrë pamjen e një kremtimi të jashtëzakonshëm: burra, gra, pleq e plaka, djem e vajza të vogla, fshatarë e malësorë, pasanikë e të vorfën kishin zanë vend në oborrin e Palok Krandes te ara e Marin Gjonej, i cili e dhuroi tokën ku do të ndërtoihej kisha.

Difton historiani françeskan Atë Marin Sirdani, që kishte ndie prej të vjetrish, se firmani i lejes nga Sulltani për ndertimin e kishës, kishte ardhë qysh në vitin 1851, por duket se për arsye të mbledhjes së të hollavet u shtye deri ditën e 7 prillit 1858. Si u vu kryqi aty ku sot asht lteri i madh, dhe u ngulën piketat, Avdi Pasha, Valiu i Shkodres, lexoi firmanin e Sulltanit (dekretin), u bekue guri i parë i themelit nga Imzot Topich dhe u çelën themelet. Ndodheshin pranë në ceremoni: Dom Ejëll Radoja, famullitar i qytetit me ndihmësat Dom Ejëll Tanushi, Dom Mëhill Maraçi, Dom Zef Paci (Shestani), Dom Simon Berisha, Hafiz Daut Efendi Boriçi, trupi konsullor i akredituem ipeshkvijt e dioqezave sufragane, kleri shekullar e rregulltar, xhakojt e seminarit dioqezan, parsia e popull.

Sendekomini (arkëtari i financës së qarkut) vilajetit, shprazi 700 lira turke florini prej një çinije shkruë në savat e mbulue me shami mëndafshi me topa ari dhuratë e Sulltanit për ndërtimin e katedrales. Papa i Lumi Piu IX me anën e Imzot Topich, dërgoi 1000 skuda, ndihmë për godinë e kishës dhe në vitin 1861 e naltoi Kishën e Madhe Metropoli.

Guri i themelit u shti së pari në skaj të kishës, aty ku sot shifet i murosun një gurë trekandësh me një sy (syni i Zotit) me fjalët të gdhenduna italisht "Dio vede tutto" (Zoti

shëf gjithçka).

Gratë hoqen sendet e arit nga fyti dhe i lëshuene në themele.

Kisha e Madhe asht e gjatë m.73,50 (deri te balastra 50m) e gjanë 40 metra dhe e naltë 23,50m. Tregohet se Dom Ejëll Radoja kishte llogaritë madhësinë për 4.000 vetë sa mund të rrijshin ndejë kambëkryq, por në kambë mund të rrijnë edhe 6.000 vetë, dhe tue mbushë çdo skutë arrijnë 7.000 besimtarë.

Puna nisi me vrull të madh dhe për çdo të dielle, mblihdeshin burra, të rij e fëmijë me bartë gur, tulla, me ba gëlqere, me njitë material nder skela në mënyrë që për një javë të mos mungojnë ustallarët. U pat vendosë që secila shtëpi të dërgonte nga një djalë falas me punue për 6 muej rresht, ndër të cilët qe Gjokë Muzhani që asokohe ishte 15-16-vjeçar.

Gjatë punimeve dy herë rresht u pat shembë gunga e kishës derisa erdhi nga jashtë (me sa duket një konstruktor) një inxhinier i cili e kreu sikurse sot asht.

Z. Kolë Gurashi i cili ka ndigjue prej Ndoc Gurashit punën e rrëzimit të gungës e tregon kështu: "Gunga ka qenë rrëzue nga shkaku se populli i kishte çelë themelet në krye të vet e prej entuziazmit nuk ia vejshin veshin planit të inxhinierit, por e kishin zmadhue në mënyrë që me i tretë pamjen e një kishe as me qenë një stacion hekurudhash. Mjaft qiti e bërtiti inxhinieri tue u thanë se ashtu si e kishin nisë nuk do të qëndrojnë gunga as kupola, por me ké flet? Mandej filluen me iu kercnue tue i thanë se je pendue e s'do me e goditë. Inxhinieri qe shtrengue me e ndertue kupolën tue u mundue me e lidhë me trenë e hekur. Por në vitin 1896-1897 u pa se asht në rrezik me ra mbrenda, mbasi trenat ishin bre prej teje. Qe pru një arkitekt austriak e, si mori masat, pruni nga Austria trenë hekuri dhe me punëtorë të prumë nga jashtë i vendosi; pastaj tavanin e punuen të mberthyem perbrenda me masur dhe i shtijnë gojë më gojë dhe për një kohë të gjatë u duk bukur, mbasi kishin pru me vedi forma të ndryshme që i pagëzuen përsipri. Mirëpo, mbas pak vjetësh, nga kjo pikoi pullazi, nisën me u copëtue e me ra përtokë derisa termeti (është fjala për termeti e 1 qershorit 1905) e prishi gati krejt.

Atëherë inxhinier Kolë Idromeno i hoq dhe goditi tavanin në formë govadash, dërrase, me pikëzime që janë edhe sot.

Gjatë ipeshkëvisë së Imzot Çurçisë, punimet vijuen dhe për të forcue ma së forti muret, qënë lanë me pushue per 4-5 vjet rresht. Por ka asish që thonë se punimet u pezulluen edhe për mungesë të të hollavet.

Diftonte artisti Kolë Idromeno, që leu në vitin 1860, se kur ishte fëmijë, tue luejtë me shokë, kapercente muret e Kishës së Madhe. Arkitekti ishte një austriak, të cilit mjerisht nuk i dihet emni.

Si filluen me u sosë paret, u mblodhën 36 vetë nga populli dhe brenda një ore nënshkruen 1750 napolona flori. Gurash Shënkolli që ndodhej në Vjenë (Austri) ditën që vuni kunorë Frano Jozefi I i Habsburgëve, vojti me miqtë në votër të tij dhe i kërkuen ndihmë për Kishën. Tregon Loro Lufi se i diftonte gjysh i që ka ndejë me shtëpi kundrejt Kishës së Madhe (ku rrijnë edhe sot edhe ky vetë) se shifej vargu i qerrevet prej pazarit e deri te kisha ku katundarët e malësorët bajshin gurë e gëlqere.

Gjatë punimeve qe formue një komision ku merrshin pjesë posë ipeshkëvijve me radhë, Imzot Topich-it, Imzot Çuçija e Imzot Karlo Pooten si dhe famullitari i zellshëm Dom Ejëll Radoja, si dhe shumë nga paria e qytetit dhe nga populli. Në komisionin e formuem kje edhe Atë Tomë Marcozzi O.F.M. themeluesi i Kryeshoqnisë së "Zojës Ruzare" te Arra e Madhe e që çeli të parin kuvend në Shkodër dhe Dom Pashko Junki, ma vonë

famullitar i Shkodrës dhe Perandori aty për aty i fali 150 napolona flori.  
Rreth ndërtimit të Kishës Katedrale zana popullore qiti një vjershë, të cilën po e rreshtojmë pjesërisht:

Kah po vini more qerre  
Me bajtë ranë, me bajtë gëlqere.  
Godis kishën me hyjnera (zbukurime)  
me 320 penxhere.  
Po shkon korculla tue kja:  
Me ty pashë kam nji rixha  
Njiket' kishë mos me ma nga  
se s'ta çoj përmbi kala  
as ta çoj përmbi shtëpia  
treqind pash përmbi xhamia...  
Ka í penxhere per xhakue  
kaurreshat kjoshin mallkue  
I lanë djemtë pa martue.  
Kaurreshat kjoshin të zeza  
që i lanë vajzat virgjinesha... etj.

Kisha u krye, por kumbonarja mbeti, sepse u sosën të hollat. Ordinari, që ishte Imzot Pashko Guerini, mblodh parinë e vendit dhe i parashtrroi nevojën e plotësimit të punës së nisun. Për këtë qëllim që vendosë e i ndanë dhuruesit në tri kategori; klasa I me dhanë 25 napolona flori, klasa II me dhanë 15 napolona flori dhe klasa III, me dhanë nga 10 napolona flori. Krisi potera dhe shamata, dikush donte me u hjekë klasa e parë e me pague ma pakë, atëherë si tregon Gjon Ujka, Nushi çohet dhe i sillet Filip Parrucës faqe të gjithëve tue i thanë: "Kishën po e mbarojmë unë e ti e po vejmë një gur të shkruem se e kena krye na !".

Kjo që një bombë për të pranishmit; paret e shenjueme u derdhën menjëherë. Populli i vogël, porsa e ndjeu këtë ngjarje, doli nëpër shtëpia dugajë dhe mblodh ndihma e u zotue me punue falas për çdo të dielle, derisa të kryhej kumbanorja.

Pjesa e sipërme e kumbonares, ajo e mbulueme me plumb që pru nga Venediku dhe pague nga familja Parruca dhe nga vëllaznit Mark e Pjeter Pema që u kap 750 napolona flori. Sipas projektit të Kolë Idromenos dhe nën drejtimin e t'atit, arkitektit Arsen Idromeno dhe në kujdesin e Imzot Pashko Junkit, atëherë famullitar, mbas gati pesë vjetësh u krye kumbanorja. Në vitin 1890 nën drejtimin e inxhinier Kolë Idromenos, u vendosën edhe tri kumbonët e gëzimi që i papërshkruem, kur filluen me tingëllue së parit. Tavani i kishës pësoi shumë ndryshime; njëherë që goditë me trenë perbrenda të kapun në formë harku të thyeme, mandej që punue me gjeso, por nisi me ra copa-copa; në fund e mori mbi vedi inxhinier Kolë Idromeno dhe e punoi ashtu si asht sot. Dekorimet dhe pikëzimet e para i punuen austriakët, ku ndër shtylla paraqiten 12 apostujt dhe piktura të tjera. Ndermjet harqevet të lterit të madh dhe gungen e tij e pikëzoi artisti Kolë Idromeno me ndihmës Gaspër Saraçin (piktorin) tue paraqitë në gungë; në fillim të Shejtueshmen Trini me apoteozën e Eukaristisë. Ma vonë, t'ikunit e Zojës së Këshillit të Mirë nga Shkodra, ndjekë prej dy shkodranëve, Gjergjit dhe De Sclavis, veshë me kostume kombëtare, shallvarë, dollamë, jelekë, dësllëq, festanuz, këpucë me llapa etj., dhe me

sfond qytetin e vjetër të Shkodrës me Rozafatin sipri. Në tavan të hekurt pikëzoi apoteozen e diakonit Shën Shtjefnit Protomartir, pajtori i arkidioqezat të Shkodrës, ky punim u pat ba mbas meremetimeve të damtimit të shkaktueme nga termeti i 1 qershorit të vjetit 1905, d.m.th. në vitin 1909.

Rrogonat llastre që edhe sot shifën në tavan, i krijoi dhe i drejtoi vetë Kolë Idromeno, ndersa punën materiale e bani Patusha i Kolë Gjonaj e Mark Baba, llasterarë e pikturat i ekzekutoi Gaspër Saraçi (Piktori).

Kisha nisë me u pasunue me lterë; të parin e qiti Gjon Nush Kovaçi, atë të të Shejtnueshmen Trini dhe Ninja e shoqja, la një shtëpi në rrugë të kapidan Pashës, trashigim që me një të katërten e të ardhunave vjetore, të mbahej lteri; por kjo qiti prej vedit truporen e Shën Gjon Pagëzuesit, mjesa Luçia e Zef Gerës (Nikolla) pagoi truporen e Shën Jozefit që ishin të dy anash këtij lteri. Lterin e Konakut Shejt e fali Gaspër Markiçi; të Shën Mërisë Magdalenë e pagoi Kusha e Ejëll Çobës me dy trupore anash; atë të Shën Ejllit dhe të Shën Jakut; lterin e Shën Lorencit e fali Gjokë Muzhani; dy truporet që lidhin anash atë të Shëna Prendës e pat falë Dom Zef Puka, ndersa të Shën Shtjefnit e pagoi Dom Pjetër Gjura. Kolë Çoba dhuroi lterin e Shëna Ndout. Me rastin e misioneve të vitit 1895, me kujdesin e Imzot Jak Serreqit, populli katolik shkodran, sidomos grania me dhurata paje e gjanash të vlefshme, ndertoi lterin e Zemrës së Krishtit. Lterin e Shën Kollit e pagoi Kolë Serreqi, të cilin e punoi me duert e veta Kolë Idromeno. Truporen e Shën Mëhillit e pagoi për 30 napolona flori Hilë Marini të cilin e punoi vetë artisti Kolë Idromeno. Dy ujë bekoret mermeri i dhuroi familja Pema. Tush Muzhani pruni truporen e Zojës së Dhimbshme që pat qenë në kapelë të Qelës famullitare. Në këtë kapele patën qenë edhe këto trupore; Konaku i Shejt, nga e majta e lterit të mjedisit t'atij që shef; n'anë të majtë prep truporja e Shën Sebastianit e cila u pat zhdukë mbas luftës ballkanike. Truporet ma vonë erdhën tue u shtue; Lezja e Ndoc Gurashit pruni truporen e Shën Terezinës së Krishtit Foshnje; Shën Çeçilen e pagoi Çilja e Tish Buflit, Shën Luçinë, familja e Lukë Shestanit, truporen e Shën Luigjit e pagoi Komiteti i Kremtimeve të 200- vjetorit; truporen e Shën Françeskut ish e kishës së Shëna Ndout tej Bunës, të cilën e përmirësoi Kolë Idromeno. Kjo kishë kremtonte festën me 2 gusht. Ndjesa e Shën Françeskut ku rrante populli i Shkodres me shumicë dhe kalojshin aty natën, mbasi deri më 1913 kisha që në kambë si edhe shtëpia dhe hajati përballë. Firmanin e Sulltanit për këtë kishë dhe festë e ka pasë shtëpia e Gjon Curanit trashigim. (Shifni gjatë shtojces). Për truporen e Shëna Rrokut nuk dihet se kush e ka dhurue. Kuadrin e madh pikëzue nga Kolë Idromeno, me rastin e 700- vjetorit të Shën Françeskut, që tashti ndodhet në lterin e madh të Kishës së Fretenvet në Gjuhadol dhuroi Komiteti i Kremtimeve.

Prej termetit të vitit 1905, kisha qe damtue shumë, sidomos në anën e majtë dhe punimet e ripërtrimit qenë ba nga inxhinier Kolë Idromeno. Mbas këtyne meremetimeve pikëzoi gungen dhe qemerin kryesor Kolë Idromeno. Gjatë luftës Ballkanike kisha pësoi shumë nga bombardimet. U prishqë pjesërisht lteri i të Shejtnueshmes Trini e i Shën Mërisë Magdalenë, edhe sot shifën shenjat në kuadrin e së Shejtnueshmes Trini. Gjithashtu përjashta janë të ngulun në mur të kishës tri gjyle të zbrazta në vendin ku ranë gjylet e bombardimit e ku barin datën 19.III.1913, patën si konsekuencë diegien e kumbonares, të sakristisë, shembjen e kumbonëve dhe prishjen e sahatit, të cilin e pat dhurue Kolë vëlla Kakarriqi, ma vonë, kah viti 1924-1925 e pruni prap të ri, së bashku me të bijtë.

Gjatë Luftës Ballkanike, tue qenë se në Katedrale u strehuen disa familje shkodrane me gjetë shpëtim, në kishë nuk u krye asnjë ceremoni fetare, por u banë në kapelë në oborr të

qelës famullitare.

Në vitin 1947 u vu shpella e Zojës Lourd, rregullue nga Tonin Harapi dhe truproja e Zojës së Dhimbshme e motrave Servite, dhe e Zojës Ndhimëtare, e motrave Saleziane, truporet e Shejtënvjet që përmendem ma sipër u vunë mjaft në kishë, ku ishin përpara Stacionet e Udhës së Krygjës, tue çue këta aty, ku dikur ishin pikturat në mur të 12 Apostujvet.

U vunë në Kishë Katedrale edhe shumë fugure artistike të Arqipeshkëvisë, së Qelës dhe të Motravet Servite e Saleziane. Ndër të tjera, Piu X vepër e piktorit Ndoc Martinit, dhe Shën Filip Benici a Shën Juliana falkonjari, vepra të piktorit françeskan Lochuan.

Në vitin 1948 truporen e Shën Palit punue nga Fratel Auturo Sala, sikur shumë të tjera e dhuroi Gjystja e Mark Lekës në kujtim të dajës së vet Pal Çobanit.

Me 31 tetuer 1948, mbas dreke, u ba ceremonia e kremtimit së Rrelikevet nder lterët ku, për të paren herë, pas asaj së Shën Prosperit, dallohen Rreliket e Shën Krygjës e të Veglavet të Mundimevet si dhe 10 rrashtat e shoqeve të Shën Ursulës dhe shumë Rrelikeve të Zojës dhe shumë shëjtënvjet, simbas ditës së tyne, jepen me u puthë.

Në vitin 1948-1949 kisha u stolis vetëm me disa vepra piktore të një motre Servite e quejtun M.Gjyljana nga Trieshte, si p.sh. Krishti i paqes, Zoja e Fatimas, Shën Pjetri tue ecë përmbi ujë, të kthimit të Shën Palit etj.

Me 6.V.1891, rezidenca arqipeshkvnore erdhi e nguli cak në pallatin e ri në oborr të kishës vepër e arkitektit Pjetër Marubbit i cili pikëzoi tavanin sikurse shifen ende sot; nga shtëpia ipeshkvnore që ndodhej në rrugën Çesk Nemce selia ipeshkvnore pat qenë instalue në shtëpinë e Misionit Shëtitës, në rrugën e spitalit ku deri më 1918 pat qenë edhe kapela e cila u dogj.

### **Parathanie e shkurtë e disa ndodhjeve ma me randësi në Katedrale të Shkodrës rreth 100 vjetëve**

Dhetë vjet mbas kryemjes dhe bekimit të Katedrales nga Arqipeshkëvi Metropolit Imzot Karlo Pooten, një ngjarje e kobshme ndodhi brenda saj; një malsuer nga Pulti, një ditë të dielle mëngjes, ndersa ishte ndejë tue pamë meshë, vegon gjaksin e tij kah po kungohej te lteri i të Shejtnuëshmes Trini, i del para te parmakët e lterit të madh dhe shtie më te tue e vra dekun në tokë, tue e përcjellë këtë gjest tragjik me fjalët: "Vend ma të mirë e vakt (kohë) ma të mirë se për ty me marrë gjakun tem nuk ka !" Populli u lëshue me e mbytë, por i zmbropsi tue thanë se kishte marrë gjakun. Nuk dihet mandej se si përfundoi puna e tij, fakti asht se kisha ndej mbyllë për tri vjet e u riçel mbasi erdhi leja prej Selisë Shejtë për një bekim të dytë; për këtë arsye shifen kryqat perjashta mureve të kishës. Mjerisht nuk ka mujtë m'u gjetë emni i vrasësit si dhe ai i të vramit. Atë Marin Sirdani tregon se deri vonë u shifte nder vorreza të Rëmajit, përmbi vorr të të vramit, një kryq i gdhendun në dru ku paraqitej skena e hatashme.

Në vitin 1861 filloi me u lutë Moji i Zojës te lteri i Shën Mërisë Magdalenë, ku vendosej fugurja e pikëzue me nga Michael Vitner, piktor polak, i cili prej 1.II.1859 deri më 14.X.1859 ndej në Genacan për të punue. Fugurja asht punue e ruejtun në një suazë argjendi, stilit gotik; fugurja e Zojës së Shkodrës, pru nga jashtë prej familjes Serreqi, nuk dihet se si ka humbë. Kjo e tashmja që nderohet në lter të madh asht punue e ardhun në kohë të Imzot Jak Serreqit, kur ishte famullitar.

Me 12 korrik 1862, filloi me hy zakoni me përcjellë fëmijët e vdekun nder vorreza. Kah viti 1876 fillon e përmendet kori i Katedrales me mjeshtër Shan Curanin. Kori pësoi ndryshime, por koristat që mbahen mend se kanë këndue vazhdimisht në Katedrale janë këta: Pjetër Hila, Tut Kraja, Kolë Pistulli, Gjon Mikel Ashiku, Kolë (Vogli), Naraçi, Gjon Gjergj Ashiku, Ndoc Pashkja, Gjokë Palokë Deda, Sima i Zef Simonit, Zef e Gjon Mala, Mati Harapi, Shtjefen Jakova, Lulash Ndoja, Ndoc Mëhilli, Kola i Lul Elezit, Patusha i Kolë Gjonej, Cuk Daci, Gjergj Shaperkata, Zef Koçobashi, Cuk Kola, Ndoc Lufi, Lulash Mirdita, Filip Mala, Pashko Simon Galugja, të cilët ishin njëherë të Kongregacionit të Zojës Nunciatë dhe në raste të mëdha e përforcojshin korin e Katedrales i cili ishte i përbamë prej këtyne kangëtarëve: Ton Galigaçi, bariton me famë të madhe. Këtë e patën çue në Romë, ku këndoi në një arqibazilikë të Shën Pjetrit, ditën e festës, tue lanë pa mend ndigjuesit e pranishëm që ishin nga të katër anët e dheut dhe i qe ofrue vendi si bariton në theatrin "Scala" të Milanit, por i madhngjyem nga vendlindja, kthei në Shkodër e vdiq në mjerim të madh nga T.B.C. Kangëtarë të përmendun të Kishës së Madhe qenë Mark Dija, Kolë Kurti, Mati Staka, Gjon Toni, Mark Kushi, Kolë Raboshta, Kolë Ndokë Vasija, Pjetër e Zef Rrok Sheldija, Zef Bazhdari, Tefë Gera, Kelë Martini, Palok e Lec Gjushi, Filip Hilë Nuku, Jak Gurashi, Mati e Pjetër Halili, Pjetër Boriçi, Ndoc Shala, Gjon Bombardoni, Gjon Cepi, Kolë Plani, Ndoci i Kishës, Kolë Çuni e Gjon Martini i cili po për shumë vjet ndihmoi tue i ra muzikës ndër ditë të dielle e festa divocionit.

Drejtues kori për shumë vjet kje Dom Zef Puka deri sa në vitin 1933 ia lëshoi vendin Dom Mikel Koliqit që me sa fëmijë e djelmoça themeloi korin e qujetun "Schola Cantorum".

Gjatë vjetëve të fundit drejtuen kantorinë: Tonin Harapi, Martin Trushi, Sandër Çefa, Gjon Simoni e, që prej vjetit 1953 Ndoc Nogaj, i cili e vazhdon edhe sot.

Banda e Katedrales, themelue nga Palokë Kurti, ndersa qe famullitar i qytetit Imzot Jak Serreqi, drejtohej nga mjeshtri Frano Ndoja që jepte koncert për të gjithë ne e dielle pasdreke n'oborr të kishës, përcjellte procesionin e Korpit të Krishtit e të Zojës së Shkodrës. Udhëheqësi i tyne qe Dom Zef Puka, i cili drejtonte korin e kishës.

Bandistat që vijune për shumë kohë qënë këta: Filip Lorja, Gjon Paci, Pjetër Boriçi, Tefë Prela, Filip Gjadri, Cin Boriçi, me kornetë: Mati Halili, Shuk Boriçi me bombardin, Shtjefen Gaspri, Cuku i Lazer Dinos, Lush Tafrruku, Gaspër Gjeka i Tazes, Marku i Zef Mar Ndout, me buria: Kolë Çuni, Gaspër Rroku, Pjetër Rrok Cepi, Simon Sekuj gjenik (sakso): Simon Sekuj, Zef Sekuj, Cuk Beltoja, Pjetër Ndue Boriçi, me trompon: Ndokë Çuni, Ndoc Shala; me grankasë, Roman Sprager, me eufonia, Zef Guga e Pjetër Halili me bass, Gjon Shllaku me bateri, Shukë Martini e Tomë Fr. Toma, me çapare, Gaspër Begu me trumpetë, Luigji i Palokë Ndojës e Nush Cepi me buria, Jak e Shan Ndoci me bombardino, ky i fundit i binte edhe saksit bashkë me Kolë Mark Preçin, Pjeter Kiri me eufonio, Loro Koja me saks.

Banda kishte ndejën përmbi dugajë të Shan Dedës në Serreq, ku mblidheshin për mësim e prova në mbramje, ma vonë mbi dugajët e Serreqit pësuen përmirësime, banda qe bartë e çue në rrugëzën Berdicaj, kundruell ish- Kuvendit të Stigmatinevet, së cilës i pat mbetë emni Rruga e Daullës; aty qëndroi deri në vitin 1923 kur një pjesë e kësaj bande kaloi në varësinë e Bashkisë së Shkodrës.

Sa qe banda nën drejtimin e Palokë Kurtit epte koncert vetëm një herë në muej e nder festa të mëdha fetare, por nën drejtimin e Frano Ndojës, gjatë stinës së verës, për çdo të



dielle pasdreke, banda gëzonte ndigjuesit me jonet e saj deri në orët e para të mbramjes. Sakristanët e Katedrales e kishin ndejn aty ku mblidheshin bandistat, sipri dugajës së Shan Dedës e cila thirrej shtëpia e sakristanëve.

Sakristanët ma të përmendurit gjatë këtyne 100 vjeteve qenë: Filip Gjonaj, mbas tij erdhi Gjon Viçi, i veshun me fistana, dollamë të kuqe, enteri të ngrime, tanuz të rrasun për kokë, ndër ditë në shej, mjes dimnit vishte brakesha të kuqe cohe ase shallvarë; mbas tij erdhi Leka i Kishës i veshun me brakesha e Toni i Kishës që gjatë shërbimit vishej me veladon, prej këtij doli edhe fjala e popullit që sakristanat i thirrte "Lajka i Kishës", vijuen me sherbye me radhë, Deda i Kishës, civil, Tomë Pistulli, i cili me rastin e bombardimit u vra gishtash, Gjon Barbullushi, të dy civila. Për do kohë shërbyen si të tillë edhe Ndoc Shala e Gjon Bombardoni. Mbrapa erdhën Kolë e Nush Mazi që e mbajtën për 40 vjet rresht. Mbas tyne shërbei nga viti 1944 deri në vitin 1954. Fr. Frano Ljarja i cili u dallue për stolinë e kishës nder kremte të mëdha, edhe Zef Simoni që asht edhe sot. Tash pesë vjet drejton i palodhshëm rregullimin e punimet e kishës kleriku Ndoc Simon Nogaj. Sakristanët kishin për të drejtë me i primë çdo proçesioni tue dhanë shej herë pas here në tingullin e një kumbone doracake.

Kur Arqipeshkvi do të delte në Katedrale për të meshue Pontifikalisht, atij i printe Koçobashi dhe biri i tij Tuk Koçobashi. Ky filloi me u zhdukë mbas vitit 1925.

### **Proçesionet**

Ditën e Shën Pjetrit dhe të Shën Palit, e të Shelbuemit, Shëna Krygjës, ditën e Shën Shtjefnit e të Shën Lorencit, proçesioni bahej mbrenda kishe, ndersa ai i Zojës së Shkodrës, i Korpit të Krishtit rreth oborrit të kishës në mbasdreke, proçesioni i rrezikojve bahej po rreth kishe veç në oret e para të mëngjesit.

Proçesioni i Korpit të Krishtit zhvillohej kështu: prinë me kumbonë sakristani, mbas tij vajzat e shkollës stigmatine veshë shumica me kostume kombëtare mbas kompania e Zojës Rruzare e kishës së Arrës së Madhe. Kongregacioni i Zojës Nunciatë, Terciarët e Françeskanëve, kompania e Shën Filip Jakob, shoqnia e Shëna Rrokut nga Shiroka, Kompania e Eukaristisë, e Zojës së Shkodrës, e Shën Jozefit, e Shëna Ndout abat, e Shën Shtjefnit e Shën Pjetrit dhe Pal, e Korpit të Krishtit, truporja e Zojës, mbushë me dupa, flori e manduhije, bartë nga Pashk Harusha, Shani i Loro Çefës, Karlo Shiroka, nën të cilin rrinte Imzot Arqipeshkëv me të Shenjtnueshmin, rrethue nga kleri, fill mbas baldikinit ecëshin veshë në uniformë të madhe, trupi konsullor i akredituem nder të cilët ai Austro-Hungarisë, i Francës, i Anglisë, i Italisë, i Malit të Zi, i Greqisë, i Serbisë dhe i Rusisë. Mbas tyne vijshin kafazat ose rojet konsullore, të veshun me kostume kombëtare, si çakçirë, xhamadana me ar, jelekë, shallvarë të kuq ose bojë vene, të armatosun e të pashëm sa t'i lypish. Ndiqte vargu i pafund i popullit, shumica gra, pleq e plaka.

Kah viti 1910, morën pjesë edhe nxanësat e shkollës françeskane me flamurin e tyne tipik, ku spikatte ngjyra kombëtare kuq e zi, nxënësit e Kolegjës Saveriane, jetimat e Salezianëve, etj, etj.

Në vitin 1913, në proçesion mori pjesë një detashment austriak që zbrazën, nder tre ndalimet, nga një batare pushkë. Në vitin 1917, proçesioni doli jashtë mureve të oborrit të kishës tue u përshkue nder rrugët: Serreq, Dugajët e Reja, Rruga e Fretenve e Katedrale, lterët për ndalesë qenë: i pari te shtëpia e Periklit, në Serreq, i dyti te qoshja e Dugajëve të Reja, i treti nder oborr të Kishës Françeskane, dhe nder tre pushimet u shprazen nga një batare pushke. Ky zakon u ndoq edhe nga qeveria shqiptare deri në vitin 1926. Më 1923

proçesioni u zgjanue tue pershkue rrugët Serreq, Dugajët e Reja, Fushë Qelë, rruga e Spitalit, Perash. Lterët e ndalimeve u ndertuene: i pari te Dugajët e Reja, i dyti në Fushë Qelë, bri shtëpisë së Gjon Ujkës dhe i treti, kundruell rrugicës së kishës së Jezuitëve. Në Perash e kështu vazhdoi deri më 1943. Për dy vjet tjera, në vend të rrugës së Spitalit, proçesioni u suell kah Bulevardi i Ri. Tashti bahet ne e dielle mbas dite, në ditën e mbrame të katerdhetë orëvet, më frelëtarë rreth oborrit të katedrales.

Dy proçesione të jashtëzakonshme e të madhnueshme u banë në vitin 1901, nga qela e vjetër, dhe më 29.VI.1931 nga qela e re, me rastin e bartjes për në Katedrale të trupit të Shën Prospërit, të cilin e pat veshë e maskue si asht sot Inxh. Kolë Idromeno. Në këtë rast u leçit se kremtja e këtij shejti ishte vendosë me u lutë të dytën të dielle të korrikut, e cila ma vonë qe lanë për disa vjet.

Me rastin 400-vjetorit të festës së Shën Luigjit, më 16.I.1927 qe ba një proçesion që kaloi çdo tjetër, proçesioni, me kler, shoqni fetare, kulture, studentë, nxënës, popull, përshkoi rrugët: Serreq, Ballabane, Rus Katolik, Dugajët e Reja, Fushës Qelë, Rruga 28 Nandori, Perash, Serreq dhe truporja e Shejtit që vu sipri një gajtheri të naltë tërheqë nga 12 kuaj. Më 2.X.1927, me rastin e 700-vjetorit të Shën Françeskut, proçesioni ndoq intinerarin, që bani ai i Korpit të Krishtit në vitin 1917. I madhnueshëm kje edhe proçesioni në kremtimin e 700-vjetorit të Shën Andout me 14.III. 1932.

Tri ishin shoqinat fetare që kishin privilegj me përgatitë lterët nder nda lesa: ajo e Zojës Ruzare e Kongregacionit Nunciatë dhe ai i Terciarëvet.

Një proçesion prej Kishës së Madhe deri te Kisha e Zojës bri kalaje qe bamë në vitin 1896 ku moren pjesë një shumicë dermuese e popullit per protestën kundër ndalimit të frenkuentimit që sundimtari turk kishte dhanë për kishën e Zojës, ata që morën pjesë, vajtën të armatosun e të vendosun me u perleshë me ushtri turke, por per urti të disave, nuk doli gja e keqe dhe sundimtari nuk e çoi ma gjatë. Prap një proçesion tjetër u ba në vitin 1911, sikur e deshmon Atë Shtjefen Zadrima. Edhe në vitin 1931 proçesioni me flamurë fetarë e kombëtarë që xuni fill në Katedrale drejtue për në Shejtnore të Zojës, qe një protestë ndaj qeverisë fashiste e cila kishte vu kusht me e krye kishën per me vendosë një rrasë perkujtimore se gjoja populli s'e kishte goditë, por ajo. Mirë po faktet treguen ndryshe, sepse populli nuk u kursye me dhanë ndihmesat e kisha u mbarue me pjesëmarrjen vullnetare e edhe vetë vëllazenve myslimanë që kontribuen në këtë ndërtesë. Proçesioni ditën e Zojës së Këshillit të Mirë nga Katedralja e te Shejtnorja vazhdoi deri në vitin 1947.

Një proçesion i madh qe bamë natën e 8.XII.1954, me rastin e 100- vjetorit të shpalljes me dogmen të xanunit Pafaj të Virginës Mëri, rreth oborrit të Katedrales dhe çelebrimin e meshës Pontifikale nga Imzot Ernest Maria Çoba.

### **Meshët**

Meshën e famullisë në ditët e dielle ishte zakon me e pague Shoqinat. Rendi i meshëve në përgjithësi ishte ky: Mesha e parë fill mbas kumbonës së mëngjesit, mandej në orën 6<sup>o</sup>, mesha e vajzave me predk, mesha e dytë, në orën 8<sup>o</sup> dhe ajo e famullisë përcjellë me predk e koro, në orën 10<sup>o</sup> për të gjithë të dielle. Ma vonë u shtuen edhe mesha e fëmijëve e ndonjë tjetër. Ditë jave meshët fillojshin në orën 5 ose 5.30 dhe përfundojshin në orën 7<sup>o</sup>, ma vonë u shtye mesha e mbrame në orën 8<sup>o</sup>.

Tashti zakonisht meshët janë me këtë orar. Ditët e dielle e të kremte të urdhnueme dhe ditë jave prej 1.IV. deri me 9.XI. mesha e parë fillon në orën 5 nga 10.XI. deri me 31.III.

në orën 5.30.

Meshët tjera, ditë dielle e të kremte të urdhnueme janë në orën 6, mesha prelatore, në oren 7.30 e 8.30. Në oren 10 Mesha e këndueme. (Ndër të gjitha meshët qysh prej vitit 1954). Në ditët e dielle bahet Katekizmi. Nësa përpara predikohej Homelia në meshët e orës së 6 dhe 10.

Qysh më 10 nanduer 1957 u vu edhe një Meshë në mbasdite me katekizem ase pangjeric. Ditë jave, në orën 6, mesha prelatore me kujtim të divocioneve të ndryshme dhe të shejtit të ditës dhe Bekimi. Fill mbas epej me u puthë Rrelikja.

Meshët tjera në oren 7.30 e 8. Nder festa devocioni edhe në oren 8.30.

Përveç meshës së zakonshme të mesnatës, natën e Këshnellavet, me rastin e shpalljes së vitit shejt, 1900 në kishën Katedrale u dha mesha pontifikale në mesnatë edhe për Motmot të Ri, edhe me 1.X.1927 në rastin e 700-vjetorit të Shën Françeskut.

Mandej me 8.XII. 1954, me rastin e 100-vjetorit të Zojës së Paperlyeme, të shtunden e madhe, 1957, dhe me 29.VI.1957, me rastin e bekimit të gurit të themelit të lterit të ri të Katedrales, mesha pontifikale u tha në mbramje nga Imzot Ernest M. Çoba.

Meshë Pontifikale në mbramje u thanë: me 30 kallnduer 1955, me rastin e vdekjes së Imzot Pjetër Demës dhe me 11.XI. 1956, me rastin e vdekjes së dijetarit të K.K.Sh. Imzot Benardin Shllaku.

### **Kremtimet**

Një zbukurim i madhnueshëm i shtëpiavet, lagjevet, sheshevet qe bamë për 50-vjetorin e shpalljes së Zojës së Paperlyeme dhe në këtë rast u dalluen për tejkalim madhnie për atë kohë Kuvendi i Stigmatineve, Shtëpia e Pjetër Koliqit, Lacës së Zef Simonit, Vëllaznit Prela, Pjetër Darragjati e në Rus, Gjon Mark Shllaku me të vëllanë.

Atë natë, për herë të parë, banda e Katedrales përshkoi rrugët e qytetit, primë me kandila nën udhëheqjen e konsullit të Austrisë, shoqnie prej kafazave të tij.

Oborri i Kishës qe ndriçue me mija-mija dritash dhe truporja e Zojës shumë e madhe, punue nga Kolë Idromeno, qe ndriçue me kandila sa me u pamë larg.

Megjithëse për të çdo kremte të Zojës së Shkodrës, kisha dhe oborri zbukuroheshin e ndriçoheshin ma se miri, por një ndriçim e lëshim fishekzjarresh, sikurse u pa me 1913, rrallëherë asht vërejtë nder ne.

Me rastin e 50-vjetorit të ipeshkëvisë së Leonit XIII, Kisha e Madhe pati një zbukurim të jashtëzakonshëm dhe në meshën Pontifikale asistuen për herë të parë Valiu i Shkodres, Trupi Konsullor dhe Prengë Bibë Doda me kostum fantastik të Bibë Dodës, përveç një morie populli, fshatarë e malësorë nga të gjitha krahinat. Në këtë ceremoni moren pjesë të gjithë ipeshkvijtë dhe arqipeshkvijtë e Shqipënisë.

Edhe në vdekjen e Leonit XIII kisha qe veshë në të zi gjithkah, ndertue një katafalk madhështuer që pothuejse përkiste në tavan, vepër e inxhinier Kolë Idromenos dhe pjesëmarrja e popullit qe e panumërueshme.

Edhe me rastin e vdekjes së Perandorit Frano Zefi I të Austrisë me shpenzime të Komandës Ushtarake pushtuese, kisha që veshë krejtësisht në të zi dhe katafalku qe i njëjtë për nga madhështia, sikurse për vdekjen e Leonit XIII. Herë mbas here, për raste vdekjesh papësh të sa ipeshkëvijve dhe arqipeshkvijve Kisha u vesh në të zeza e katafalk mjedis.

Një zbukurim i jashtëzakonshëm përbrenda kishe qe bamë me rastin e 400-vjetorit të Shën Luigjit dhe për 700-vjetorin e Shën Françeskut.

## **Kumbonët**

Tri kumbonë që pati Kisha para vitit 1912, ajo ma e vogla, gjindet tashti në shejtnoren e Rozafatit, të tjerat me djegien e kompanielit ranë të thyeme. Me 19.III. 1923 për kujdes të Imzot Pjetër Gjurës atë kohë famullitar i qytetit, kje ba pagëzimi i pesë kumbonëve të reja pru nga Italia të shkrime në fonderinë e inxhinier Françesko de Doli në Vittoria Veneto dhe kushtuen 28.609 lireta. E para peshon 608.300kg. me emnin Jezu Maria, e dyta 426.500kg. e quejtun Zef e Shtjefen, e treta ka peshue 307.700 e thirrë Mëri Magdalenë e Kolë, e katërta peshon 246.700kg. me emnin Pjetër e Pal, e pesta peshonte 175.800kg. e thirrë me emnin Eleuter e Vlash. Për të paren Kolë Kakarriqi dha 1400 lireta, për të dyten, Pashko Ashiku e Balto Çoba dhanë 500 lireta, për të tretën Lazër Pistulli e Nush Topalli, për të katërten dr. Gjon Saraçi e Kel Pali, e për të pestën Lin Luka (i vogli) e Rrok Daberdaku të cilët paguen nga pesë napolona flori. Gjina e Ejell Çobes, (e shoqja e Luigj Pistullit) dhuroi 37 napolona flori. Populli qiti në kashë 1200 lireta dhe 750 koronë serm.

Kisha deri në vitin 1922 ishte e shtrume me dërrasa, por në atë vjetë, për kujdes të Imzot Pjetër Gjurës, qe shtrur në pllaka, sikurse i ka sot nën drejtimin e Kolë Idromenos. Bankat e para, fill mbas mbarimit të kumbonares, i goditi Mati Daberdaku dhe disa u vunë edhe më 1923. Në vitin 1942 kisha qe lye perbrenda.

Në pranverë të vitit 1956, në përgatitje të kremtimit të 100-vjetorit të themelimit, për kujdes të Imzot Ernest M. Çoba, nisi pikëzimi i mbarë kishës, me dekorime shumëngjyrëshe punue nga Injac Dema, Pjetër Deda dhe Tish Staka dhe të shtyllavet ku u paraqiten episodet e ndryshme të Testamentit të Vjeter e të Ri.

Testamenti i Ri u pikëzue nga Injac Dema, klerik i arkidioqezës së Durrësit, ndersa Testamenti i Vjetër u pikëzue prej Aleks Baqlit, Pjerin Sheldija, Benardin e Ferdinand Paci, Cin Lezhja, Tish Staka dhe pjesë më të madhe Gjovalin Saraçi. Gungën ku paraqiten të ikunit e Zojës së Këshillit të Mirë, me qemer e pikëzoi Atë Leon Kabashi me ndihmës Injac Demën. Përballë lterit të madh janë pikëzue katër Profetët e Mëdhaj, Izaija nga Pjerin Sheldija, nësa tre të tjerët profetë nga Dom Ndrejë Krroqi. Në fund të kishës janë tue u pikëzue nga Zef Vata pjesët kryesore të katekizmit.

Qysh me dt.29.VI.1958 u bekue guri i themelimit të lterit të madh të ri, ekzekutue simbas projektit të artistit Kolë Idromeno, punue para 60 vjetësh në miniaturë drunit, por mjerisht ka humbë, por vetëm se asht gjetë nder xhama fotografikë të të ndjerit Kolë. Punimet e lterit, vepër e punueme prej Kolë Idromenos, i drejtoi me një përpikmëri të përsosun Dom Nikollë Mazrreku, ndersa muratorët ma të mirët e qytetit Mark Mirashi (i vogël), Kolë Pali e Ndoc Zefi punojnë në mbramje me shumë shije artistike, tue i vu patinaturen me gjeso. Punuen për disa kohë edhe Mark Mirashi (i madhi) e Filip Ndoja. Në ndërtimin e mureve punoi me ndergjegje edhe Ndue Çeta, etj. Krejt kujdesin e materialeve e të llogarinave e ka Ndoc Nogaj, i cili asht tue e stolisë lterin me ngjyrë ari (sikurse e kanë lypë edhe lterët e tjerë).

Kryqin e ka thadrue në dru Tonin Daija, nësa 2 ejllit e mesit i ka punue artisti i ri Rudolf Daka, 4 Ungjilltarët janë tue i punue skulptorët Mark Mirashi e Simon Harapi të cilët janë tue punue edhe një pjesë të dekorevet, ndersa pjesën tjetër e ka punue Stefan Mara. Tabernakullin e lterit të madh mermerit e ka punue Fr. Zef Pllumi O.F.M. Lteri asht i stilit gotik, nësa kisha asht e stilit romanik. Lteri vërtetë madhështor arrin në 11.50m dhe i gjithë populli i entuziazmuem nga bukuria e tij, vazhdoi tue dhanë kontributin e vet.

Gjithashtu për kujtimin e qindvjetorit të bekimit të gurit të parë, prof. Simon Rrota punoi pikturën e cila gjindet e varun në anën e djathtë të lterit të madh.

### **Kompanitë e Katedrales**

Në vitin 1764 filloi themelimi i kompanive të Katedrales së Shkodrës. Në vitin 1851 numri i tyre arriti në 18, ku secila kompani përmblihte një tubë anëtarësh, në mbrojtje të një shejti, ditën e të cilit mblidheshin të tanë bashkë me e kremtue.

Kompanitë patën lidhje të ngushta shpirtnore dhe përveç fryteve fetare patën edhe anën ekonomike sepse në të dhanunat e pjestarvet u formue një kapital me gjalleshdren (fajden) e të cilit me muejtë me u thanë një meshë për të dekun ose për të gjallë sikur të ishte dishiri ose njeti i dhanësit.

Secila kompani pati kryetarët thirrë pleq që njiherit ishin administratorët e pasunisë dhe kryejshin të gjitha detyrët, si p.sh. vendimin e të hollave të nxjerrunit e përvitshëm, dhanien e meshave, kujdesin për pasuni të leujtshme dhe të paluejtshme etj.

Por ndër kohët e vona, shumica e pleqve patën nisë me shpërdorue besimin dhe kështu kapitalet filluene me marrë teposhtë. Këtij administrimi iu shtuene edhe ngatresat që ndodhen në vendin tonë kështu që anëtarët qenë gati krejt të shpërndarë.

Kah viti 1926, Arqipeshkëvi i Shkodres pati formue një komision për shqyrtimin e tyre, dhe komisioni gjet gjallë vetëm dy-tre kompani administrue fare mirë kurse të tjerat të ligshueme e krejt të vdekuna.

Kur u themeluene kompanitë secili që shfaqte dëshirën me u ba anëtar, ishte i detyruem me derdhë një kapital të caktuem aq sa gjysma e fajdes të mjaftonte me thanë një meshë të përvitshme e gjysa tjetër do të përdorej për shtesë kapitali dhe lulëzim të kishave.

Në vitin 1891 pranë Katedrales, nën kryesinë e Arqipeshkëvit, e tamam me datën 14 tetuer, u mblodh një grup shkodranësh të për bamë prej Z.Z. Loro Gasper Çoba, Luigj Shiroka, Gjon Muzhani, Nushi i Kolë Gjokë Serreqit, Pashkë Kakarriqi, Kolë Çuçija, Pjetër Nika, Zef Bumçi, Ton Muzhani, si dhe përtrine shoqinë e themeluene. Me 3 dhetuer 1867, vendosen që të derdhej prej anëtarëve nga një kapital, me fajden të cilit, t'i vihej në ndihmë grave të reja, bijave të vorfëna, pleqve dhe plakave të mbetun mbrendë, dhe nevojtarëve invalidë për punë.

Si llogaritar qe konfirmue Pjeter Çoba, i cili deri asokohe kishte administrue më së miri kapitalin e shoqnisë.

### **Rendi i kompanive të Katedrales**

Shoqnia e Korpit të Krishtit themelue, me 20.V.1780

Shoqnia e Zojës së Shkodrës, themelue me 25.II.1779

Shoqnia e Shën Ndout themelue, me 13.VIII.1764

Shoqnia e Shën Mërisë Magdalenë, themelue me 15.IX.1769

Shoqnia e Shën Kollit, themelue me 26.III.1775

Shoqnia e Shën Jozefit themelue, me 9.XII.1792

Shoqnia e Shën Pjetrit e Sh'Palit, themelue 27. III. 1791

Shoqnia e Shën Markut, themelue me 10.IX.1795

Shoqnia e Shejtes Trini

Shoqnia e Shejtit Sh'Jozef

Shoqnia e të Shelbuemit

Shoqnia e Shën Krygjës

Shoqnia e Sh'Filipit e Jakobit  
Shoqnia e Shën Lorencit  
Shoqnia e Shën Mëhillit  
Shoqnia e Shnjonit

### **Vargu i ipeshkvijve dhe i arqipeshkvijve të Arkidioqezës së Shkodrës**

#### *Viti Arqipeshkvijtë*

Rreth vitit 387 mbas Krishtit, Bassus (Basha)  
431 Senecioni, mori pjesë në Konçilin e Efesit.  
519 Andrea (Codrarum)  
590 Shtjefni  
598 Gjoni Skoritan nga Kreta.  
601 Konstanti.  
Prej vitit 601 deri në vitin 1141 nuk kemi kurrfarë dokumentesh; prandej për 541 vjet kemi një boshllëk në vargun e arqipeshkvijve të Shkodrës.

#### *Viti Ipeshkëvij*

1141 mbas Krishtit, Gjergji i Provincës së Tivarit  
1199 mb. Kr. Pjetri Suarinensis  
1251 mb. Kr. N.N.  
1303 mb. Kr. Shtjefen Marini, i provincës së Tivarit  
1325 (rreth) Pjetri II  
1346 Marku, prift katolik i Tivarit  
s'dihet viti, Marini  
1367 Antini de Seluciis  
1388 Françesku  
1390 (rreth) Henriku  
1396 Andruini  
1401 Kristofori  
1401 Meliorini  
1402 Progani  
1407 Gjoni  
1451 Emanueli de Kandja, domenikan  
1459 Emanueli II  
1465 Tade Paskalika, patric Venedikas  
1467 Bartolome Barbadiku (Barbarigo) venedikas  
1471 Françesk de Sanctis nga Padova, françeskan.  
1492 Nikolla Lupus (Llupi)  
1495 Nikolla Gravina. Nuk mujti me ardhë në seli, sepse Shkodra ra nën Turqit.  
1511 Jakobi nga Netti, provincial i Sirakuzës.  
1518 Pjetri de Gardona. Qëndroi në Monastirin e Shirqit.  
1522 Hjeronimi de Carpo, françeskan.  
1524 Anton Bakaria, domenikan, nga Ferrara. U shenjtue, por nuk erdhi në Shkodër.  
Vdij me 1543 dhe për 32 vjet selia mbeti bosh.

1575 Theodor Kalompsi, kanonik nga Ulqini.

1582 Pali nga Ladri, domenikan, prof. teologjie.

1590 Duka Armani, shkodran; xuni vend në Shirq, mbasi Katedralja e Shkodres u shndërrue në xhami. S'dihet viti, Andrea.

1622 Deda Andriasius, prej Popovit, françeskan.

1626 Benedikti Ursini, françeskan nga Popovi dalmatin. Qe edhe zevendes ipeshkëv i Lezhës.

1640 Françesku Kruta nga Budua, më 645 vdiq e u vorrue në Budve.

1646 Gregori Frassina de Novara, françeskan. Para se të shejtnohet ipeshkëv pat ardhë si misionar në Krasniqe së bashku me A.Kerubini nga Valona.

1656 Pjetër Bogdani nga Prizreni. Prej persekutimevet iu desh me u strukë në Juban e në Rrjoll. Ende sot Shpella e Jubanit dhe ajo e Rrjollit thirren nga populli "Shpella e Bogdanit". Prej vitit 1656 deri në 1671 mbajti zevendësimin e Arqipeshkëvit të Tivarit. Më 1671 u zgjodh ipeshkëv i Shkupit. Vdiq më 1688.

1677 Deda Bobiç nga Budva. Më 1678-1679 mblodhi Sinoden Dioqezane. Në këtë kohë, simbas përshkrimit që ban, Kisha e Zojës qe shndërrue në Teqe Bektashish dhe me 1677 Shkodra kishte 15.000 katolikë.

1686 Andrea Galata nga arkidioqeza e Durrësit.

1690 Marin Grago, ipeshkëv i Kotorrit.

13.VIII. 1691, Ndoci Vladanji famullitar i Shkodrës; nësa ishte tue u zgjedhë për ipeshkëv, me urdhën të Sulejman Pashës, sundimtar i Shkodres qe mbyttë.

1693 Anton Nigri (Zezaj) (Negri) nga Dajçi i Zadrimës, Vikar i përgjithshëm në Sapë. Qendrën e pati në Juban. Bani shumë Sinoda ku u morën shumë vendime. Më 1702, veshë me petka meshe si ipeshkëv që varë në pazar të Shkodrës, te Mandi i Tepes, për shpifje të një grueje të mallkueme prej tij. Ndej sa ditë i varun në lak, tue lëshue dritë trupi i tij. Qe vorrue në Shirq. Imzot Zmajeviqi, disa vjet mbrapa, nuk e gjet trupin e tij. Asokohe flitej se e kanë marrë e çue në Venedik.

1702 Anton Vladanji shkodran, selinë e pati në Barbullush dhe kishën e fshatit e bani katedrale. Vdiq e u vorrue në Barbullush më 1740.

1742 Pal Kampsii shkodran. U përpoq me duresë të pashoqe, për nderën e lirinë e kishës. Ma të shumten banoi në Shkodër. Për do kohë administroi kishën e Tivarit. Ndej 29 vjet në seli. Vdiq në Kastrat dhe u vorrue në kishën e katundit të Kastratit, ku ka vorrin që mban datën e vitin 1771. Të ejten e Madhe të vitit 1745, Imzot Pal Kampsii lëshoi mallkimet, të përmbajtuna me 19 pika kundra shpërdorimeve të martesës, kishës dhe klerit dhe njiherit ia ndalon meshtarëvet thanien e meshës natën e Këshnellavet në mjesnatë deri në të zbardhmen drite edhe rrëfimet mbas perëndimit të diellit.

Mallkimet: Mallkimet që lëshon të Enjten e Madhe Ipeskvi Imzot Pal Kampsii në vitin 1745;

Kjofshin mallkue ata që djegin shtëpinë e tjetër gja të huej edhe ata që të thejnë për inat shtëpinë e huej.

Kjofshin mallkue ata që vrasin xhakojt e hymë nder urdhnime.

Kjofhtë mallkue kush ta zaptojë gjanë e kishës.

Kjofhtë mallkue kush të marrin bijat, motrat, mbesat, sherbtoret e tjera gra jashtë fesë sonë.

Kjofhtë mallkue kush grabitë vajzat, të vejat e tjera gra dhe kush të bahet shkak e ndihmë.

Kjofhtë mallkue ai që mban dy gra.

Kjoftë mallkue ai që të marrin për grue të kumatën e të emtën e tjetër grue që s'e nep ligja.  
Kjoftë mallkue ai që s'ven kunorë me prift të famullisë në atë natë që të martohet.

Kjoftë mallkue ai që shet të krishtenët e të krishtenat për robina.

Kjoftë mallkue ai që then testamentet e çartë fjalën e tyne.

Kjoftë mallkue ai që t'i shkaktojë idhnime priftenvet.

Kjofshin mallkue ata priftën që çohen në ndihmë të shekullarëvet a të turqvet dhe hyjnë me zaptue famullitë, edhe ata që më forcë të tyne o të tjetërkuj duen me mbajtë o me perzanë ata priftën që të kenë vendue ipeshkëvi.

Kjofshin mallkue ata gra e vajza që qesin barrën edhe ata që këshillojnë ose ndihmojnë për këtë punë.

Kjofshin mallkue ata o ato që bajnë mëni a lidhin njerëzit me kunorë për mos me ba fëmijë e për me i nda edhe ata e ato që qesin short.

Kjofshin mallkue ata që tue pasë të fejueme të bijën, të motrën e të mbesën për një të vdekun, ia japin përsëri të vëllait të këtij o dekë vajza e fejueme, ata i japin përsëri të motrën.

Kjofshin mallkue ata që ndajnë gratë me kunorë e marrin të tjera. Kjofshin mallkue ata që e mbajnë o e ruejnë djalin e vajzën të fejueme në një shtëpi bashkë.

Kjoftë mallkue kush vaftë ndër darsma me ngranë e me pie.

Kjoftë mallkue kush e shet gjanë e kishës.

Kjoftë mallkue kush baftë motra në Tenzonë. Ashtu kjoftë.

Kujtim: Këshnellash kurrnji prift mos të thonë meshë natën pa zbardhë drita mirë e mos të rrëfejë natën as mbasi të prenojë dielli.

Ky mallkim i kje lexue popullit t'Ejten e Madhe prej vetë Ipeshkvit dhe mandej me radhë ndër të gjitha famullitë e dioqezës të Shkodres.

1771, Gregori Radovani (Ejllori), lindun në Shirokë më 1734. Me 20.II.1772 mbajti Sinodën dioqezane në Beltojë edhe ndër vjetët tjera. Ndej 16 vjet në Shkoder. Më 1787, si mori "Pallium", nësa ishte në Rrjoll në Kishën e të Shelbuemit, vojt në Tivar si Arqipeshkëv. Me 8.VII.1787 shuguroi në kishën e Shën Mërisë Magdalenë në Zarufë, Imzot Frano Poro tue pasë si ndihmës Imzot Ndre Logorecin, Ndue Logorecin, Ipeshkëv i Pultit dhe Pal Doden Abat i Mirditës. Në Tivar ndej tri vjet. Vdiq në Ankonë (Itali) me 1790, në moshën 56-vjeçare e qe vorrue në Katedrale. La dorëshkrime, shënime kronologjike.

1787 Françesk Borci lindun në Shkodër me 16.XI.1758. Në vitin 1791, me 11 korrik qe emnue arqipeshkëv i Tivarit dhe mori "Palium" në kishë të Shën Mërisë Magdalenë prej Ipeshkëvit Imzot Mark Kryeziut. Me 27.IX.1791 iu mbështet edhe Budva. Vdiq në Shkodër më 1823 dhe u vorrue në Rëmaj. Sundoi dioqezën me shumë zell e urtësi. 1791 Mark Kryeziu, shkodran. Vdiq me 24.I.1808.

1808 (28.X.) Anton Ejllori-Radovani, nga Shiroka. Nuk dihet a qe vëlla apo kushëri i Gregorit. Më 1796 figuron ipeshkëv i Sapës. Vdiq me 4.V.1814.

1814 Anton Dodmasej, shkodran. Kah viti 1808 figuron si ipeshkëv i Pultit. Vdiq me 22.VII. 1816 dhe u vorrue në Rëmaj.

1818-(rreth) Nikolla Muriqi nga Kallmeti. Qe Vikar i përgjithshëm i dioqezës së Lezhës. Me 26.V. 1818 qe shugurue Ipeshkëv. Vdiq me 15.II.1824 dhe u vorrue në Zarufë.

1824 Anton Bruçi nga Durrësi. Me 22.VI. 1831 vdiq dhe u vorrue në kishën e Barbullushit.

1832 (13.IV.) Benigno Albertini, raguzian, françeskan. Para se të zgjidhet ipeshkëv pat



qenë provincial i Françeskanëve. Me rastin e vdekjes papritun të Imzot Pjetër Gjinaj (Xhuxha) ipeshkëv i Pultit i cili qe mbytë me sëpatë mbas kreje nga një xhakue i tij, nësa ishte tue ndejë në stol, bri votre, administroi dioqezan e Pultit. Më 1838 qe emnue ipeshkëv i Spalatos (Dalmaci), por vdiq me 24.VIII.1828 dhe u vorrue në Kishën e Shën Mërisë Magdalenë tej Bunës, ku ende sot shifet rrasa.

Epitafi mbi vorrin e Benignos (Alberti, ipeshkëv i Shkodres).

Vorri i Nderusciem  
Benignos Albertinit Ypeshev Scodre  
Decun me 24 ditne Gust 1828  
Papa scejt ner Fretnij  
Zgodh Ypeshev per sqyptarij  
Albertinin Dobravichlij.  
Chetu vorrue korbi i tij  
Duell zani muer dheen  
Në Arbenj schendriti feen  
Dije te maze me urtij  
Cherchoi scehre e malzij  
Me se sya marifet  
Ner nevoi te maze na u get  
Nei ner nee giasct viet  
E zzirri Roma me scue n'Splet  
Me ymer caterzete nan vjet  
Na braschtisi ne dech te vet  
Corbin e tij me e nerue  
Te gizz Scodra nne cam u ciue  
Myll pasar per chet sebet  
Gizz Vilajeti bani medet  
Piter Bacchich ciracu i tij  
Mee levdue sa duhet tij.

1839 Luigji Guglielmi nga Lissa, dalmatin. Pat qenë profesor në Jader (Zara). Në vitin 1843 qeveria turke nuk e la me kthye në Shkoder, sepse Kolegja e Seminarit Papnuer qe shembë me themel nga disa fanatikë. Në gusht 1843 erdhi tinzash e xuni vend në Kastrat, por iu desh me ikë. Xuni vend në Dalmaci e prej andej drejtonte punët e dioqezës. Me 27.V.1852 u emnue ipeshkëv i Veronës, por vdiq në Jader me 29.I.1853, pa mujtë me shkue në dioqezë.

1852 Gjoni Topich, nga Spalato, i lindun atje më 1790, françeskan, në Perugia e ma vonë në kuvendin e Shën Bartolomeut qe profesor. Me 19.I.1842, Gregori XIV e zgjodh ipeshkëv të Lezhës dhe administrator i Shkupit. Më 1847 u emnue administrator apostolik i Shkodrës dhe këtu xuni vend. Me 27.IX.1853 iu hoq Lezha dhe qe zgjedhë ipeshkëv i Shkodres. Me 7.IV.1858 bekoj gurin e Katedrales së Shkodres. Në tetor të vitit 1858 vojti në Romë.

Me 6. II. 1859 dha dorëheqjen e cila iu pranua. Ndej në kuvendin e Shën Bartolomeut në Romë e vdiq me 11.II. 1868. U kujdesue shumë për çashtjen e Seminarit Papnuer

Shqiptar dhe mbledh ndihma për ndertimin e katedrales së Shkodrës; ndër të cilët Piu IX që dha 1000 (njëmijë)skuda. Në Shkoder ndertoi edhe vorret e Reja, që në atë kohë populli i quejti "Vorret e Topiçit".

4.II.1859 Luigi Çurçija nga Raguzë, lindë me 8.XII.1818, françeskan, sekretar i ipeshkëvit të Raguzës. Qe profesor fizike dhe matematikan në Insitutin Filozofik. Në korrik 1853 qe provincial i françeskanëve. Papa Piu IX e zgjodh me 27.IX.1853 si ipeshkëv të Lezhës. Me 4.VI.1858 zgjidhet si ndihmës ipeshkëv i Shkodrës me të drejtë pasardhshmënie. Gjatë qëndrimit të tij vijuen punimet për ndertimin e Katedrales. Me 1865 u emnue Vikar Apostolik i Egjiptit, por ndej në Shkodër deri më 1866. Tue udhëtue për detë me shkue në selin e caktueme vdiq në anije dhe që hjedhë në detë trupi i tij. Pat pasë titullin e zgjedhun si arqipeshkëv Metropolitan i Shkodrës.

### **Arqipeshkëvij**

26.II.1867 Karli Pooten, lindun në Teveren, afër Aquisgranë, dioqezë e Kolonjës-Gjermani me 17.I.1807. Studimet i kreu në Romë më 1832 qe çue monsinjor apostolik në Bullgari e Vllahi (Valski). Me 14.IV. 1844 qe shugurue ipeshkëv në Katedralën e Raguzës, si titullar i Marionës. Me 30.IV.1844 vjen si administrator i Tivarit. Sa qe atje, ndertoi shumë kishë e qela famullitare. Piu IX me 31.VIII. 1855 e emnoi arqipeshkëv i Tivarit dhe në tretën të dielle t'Ardhunit mori Pallium nga Imzot Saverini, në Tivar, në Kishën e Shënandout. Më 1857 ndërtoi kishën e madhe të Tivarit.

Me 26.IV.1867 erdhi në Shkodër, mbasi qyshë me 15.III. 1867 kishte nxjerrë lejen që Shkodra të kthehej si seli arqipeshkëvnore metropolitane. Më 1870 mori pjesë në Konçilin Ekumenik të mbajtur në Vatikan. Me 1.XI.1871 qe delegat papnuer dhe kryetar i Konçilit II Apostolik Kombëtar Shqiptar. Imzot Karl Pooten përfundoi Kishën e Madhe, shtoi numrin e xhakojve vetëndreqi shumë kishë e përfundoi shumë qela famullitare. Mbas 43 vjet ipeshkëv, vdiq në Shkodër me 14.I.1886 dhe u vorrue në Katedrale në atë vorr që qysh më 1884 pati ndertue për vedi dhe për pasardhësit.

Në funeralin e tij mori pjesë një shumicë dermuese e popullit nga të gjitha besimet, autoritetet e vendit dhe mbarë trupi konsullor i akredituem. Tue qenë se që nga viti 1879 nisi me vujtë e me tregue shenja dobësie mendore, qe ndihmue nga Imzot Pashko Guerini. Shuguroi këto ipeshkëvij:

Në Shkodër: Imzot Pal Dodmasej me 30.XI. 1857, tue pasë dy meshtarë asistenta; Imzot Dario Bucciarelli-n O.F.M. me 10.III. 1861, i pari që u shugurue në kishën Katedrale; Imzot Pal Berishën me 14.VI.1864; Imzot Gabriel Capaccio në kishën Katedrale me 8.IX.1867; Imzot Jul Marsilin në kishën Katedrale me 6.I.1874. 23.II.1886 Pashko Guerini, i lindun në Perocanio, dioqezë e Kotorrit. Këndimet i kreu në Kolegjen Ilirike; në vitin 1848 u shugurue meshtar dhe vojt në Romë ku mori doktoratin në teologi në Kolegjen Urbane. Mbas ndej për pak kohë profesor etike në Kolegjen e Loretit, Për 29 vjet qe famullitar ndër katër famulli të Kotorrit. Me 6.V.1879 u zgjodh ipeshkëv i Pultit, shenjue si ndihmës arqipeshkëvit të Tivarit e të Shkodrës, nësa qe Karlo Pooten. Si erdhi në Shqipni qe zgjedhë vizitor apostolik për dioqezën e Lezhës. Si u sëmue Imzot Karlo Pooten, në vitin 1880 iu desh me drejtue krejt punët e arkidioqezat, deri sa më 23.XI. 1886 u zgjodh arqipeshkëv metropolit i Shkodrës. Me 15.V.1887 shuguroi Imzot Ndre Logorecin të cilin e pati ndihmës për afër një vit e që ma vonë u emnue arqipeshkëv i Shkupit. Mbas vdekjes së Imzot Ndre Logorecit, më 1892, në mars 1893 në Kishën e

Seminarit Papnuer shuguroi Imzot Pashko Trokshin, si arqipeshkëv i Shkupit. Me 20.I.1901, në Kishën Katedrale të Shkodrës, shuguroi Imzot Lazër Mjedën të cilin ma vonë e mbajti si ndihmës që nga 1905-1909.

Me 30.IV.1905, shuguroi Imzot Leonard Dedën, ipeshkëv i Lezhës e së mbramt me 29.X.1905 shuguroi Imzot Serreqin, atëherë Ipeshkëv i Sapës.

Mbajti Sinoda trivjeçare. Si arqipeshkëv mbajti Sinoden me 1899. Në vitin 1895 qe Deleat në Konçilin III Kombëtar Shqiptar ku morën pjesë Arqipeshkëvi i Shkupit, Arqipeshkëvi i Durrësit, Ipeshkëvi i Sapës e Pultit si dhe Abati i Mirditës.

Gjatë shërbimit të tij si arqipeshkëv, krijoi famulli të reja. Më 1887 famullia e Pentarit, më 1897 famullia e Bajzes, më 1899 famullia e Pulaj, më 1897 famullia e Malit të Kolaj, më 1896 famullia Reç-Lohe, më 1908 famullia Vuksan-Lekaj, ndërtoi e ndreqi shumë kishë e qela famullitare si dhe kapela. Më 1889 u shtrinë themelet e pallatit arqipeshkëv të Shkodrës.

Më 1901 u përshtat qela e re famullitare e qytetit, më 1887 ndërtoi një shtëpi të re në krye të rrugës së familjes Zojzi që pat pasë me e shenjue për shtëpi pushimi për meshtarë invalid dhe pleq. Më 1898 u krye kumbanorja e Katedrales dhe u pajis me tri kumbonë, në këtë vit kisha e madhe qe dekorue dhe zbukurue; mbasi prej termetit të vitit 1905 kisha u damtue shumë, bani meremetime dhe stolisi tavanin. Seminari Papnuer, themelue me 1859, kah viti 1886 e zmadhoi dhe prep më 1909 e zgjanoi.

Në vitin 1898 kremtoi 50-vjetorin e meshtarisë dhe më 1904, 25-vjetorin e ipeshkëvit. Në nandor të vitit 1909 lodhë prej pleqnie e nga mungesa e të të pamit, dha dorëheqje e cila iu pranue e mori titullin Arqipeshkëv i Melitenës.

Si kaloi një vit pushimi në Shtëpinë e Misionit Shëtites, mbas një sëmundjeje 5 ditësh, me 8.II.1911, vdiq në Shkodër dhe u vorrue në Katedrale. Trupi i tij qe sjellë në funeral nëpër qytet me pjesëmarrjen e një shumice dermuese të popullit të Shkodrës.

1910 Jak Serreqi, lindun në Shkodër me 1.XI.1861. Meshën e parë e çoi më 1885; shërbeu në famulli të Këlleznës, Pentarit e të Rrencit dhe që prej vitit 1892 qendihmësfamullitar i qytetit, që e mbajti deri me 29.X.1905 datë me të cilën qe shugurue ipeshkëv i Sapës. Më 1910 u zgjodh arqipeshkëv metropolit i Shkodrës që e mbajti deri më 1921. Mbas pak muejsh pushimi vdiq në prill 1922 dhe qe vorrue në Kishën e Zojës bri kalaje (e la amanet ai vetë) themelet e të cilit i bekoi vetë, kur u vu guri i rindertimit me 26.IV.1917. Si famullitar në Shkodër, posë sa stolinash në katedrale, bleu edhe fuguren e bukur që nderohet në lter të madh; bleu dhe pershtati qelen e re të qytetit, në rrugën Hilej, formoi banden e Katedrales. Si ipeshkëv i Sapës ndërtoi dy herësh selinë ipeshkëv të Nënshatit; si arqipeshkëv i Shkodrës goditi e shtoi pjesën e re të pallatit arqipeshkëv si dhe qyrgun.

Shuguroi ipeshkëvij me 21.IX.1911: Imzot Luigj Bumçin, ipeshkëvin e Lezhës, Imzot Gjergj Kolecin, ipeshkëv i Sapës. Gjatë luftës Ballkanike ndihmoi të vorfnit dhe meremtoi Katedralen që qe damtue nga bombardimet. 1922 Lazer Mjeda, lindi në Shkodër në një familje shumë të vorfen, me 6.III.1869. Me 6.VIII.1891 u shugurue meshtar në kapelen e Seminarit Papnuer; shërbeu si famullitar në Plan, Pog e Mëgullë në Pult. Qiti vjersha që këndohen ende sot nga fshtararët vendas. Me 20.I.1901 u shugurue ipeshkëv i Sapës dhe qe nder ma të rinjë nga mosha. Si ipeshkëv goditi qela famullitare e krijoi shkolla, si: në Dajç, ku mësoi për do kohë vëllai i tij Dom Ndre Mjeda, i cili administroi atë famulli; shkollën e Hajmelit të Iballës. Së bashku me të vëllanë krijoi Shoqinë Letrare "Agimi" e cila botoi tesktet shkollore t'asaj kohe. Më 1905 që pru si

ndihmës i Imzot Guerinit dhe si i tillë rrethoi me mure e parmakë hekurit oborrit e Katedrales dhe ndertoi rreshtin e dugajëve në pjesën jugperendimore të oborrit, si dhe plotësoi kullën e kishës.

Gjatë kësaj periudhe shoqnitë letrare janë në lulëzim të plotë. Më 1909 qe emnue Arqipeshkëv i Shkupit ku çeli shumë shkolla nëpër katunde dhe punoi për lulëzimin e fesë dhe të kulturës në atë krahinë; ngriti qelën e i pasuroi, si dhe zbukuroi Kishën Katedrale të Prizrendit. Në Shkup ndertoi selinë arqipeshkvnore dhe qelën famullitare. Më 1922 erdhi arqipeshkëv i Shkodrës ku u vu menjëherë me permirësue dhe pasunue kishën e qelën famullitare dhe nisi ndertimin e kishës së Rusit. Stolisi kapelen e arqipeshkvisë, në formë artistike, nën drejtimin e artistit Kolë Idromeno, i cili me duart e veta goditi lterin.

Themeloi Fletoren e Klerit Katolik dhe Fletoren e së diellës, botoi librin "Rruga e Shelbimit" e me 19.III.1923 bekoj kumbonët e reja të Katedralës. me 4.VIII.1929 shuguroi ipeshkëv Imzot Pjetër Gjurën arqipeshkëv të Durrësit dhe Imzot Frano Gjinin ipeshkëv Abat të Mirditës në shtator të vitit 1930. Vdiq me 8 korrik 1935 e funerali qe nder ma të madhnueshmit që iu banë arqipeshkvijve. Me 1926 pat kremtue 25- vjetorin e ipeshkvisë.

19.III. 1936 Gaspër Thaçi, lindi në Shkodër me 23.I.1889. Me 21.IX.1911 çoi meshën e parë. Shërbei si famullitar në dioqezën e Sapës në Nënshat Dajç e për dy herë në Qelëz; qe këshilltar dioqezan dhe delegat ipeshkvnuer. Në vitin 1930 erdhi në Shkodër si famullitar. Me rastin e sëmundjes së Imzot Lazër Mjedës qe emnue Vikar i Pergjithshëm i Arkidioqezat të Shkodres.

Me 19.III.1936 së bashku me Imzot Vinçenc Prensushin O.F.M. u shugurue arqipeshkëv metropolit i Shkodrës nga Delegati Apostolik Imzot Gjon Della Pjetra, në Katedrale.

Si famullitar, posë sa e sa konferencash e predkesh, organizoi dhe drejtoi Komitetin për kremtinin e Shëna Ndout e të Shën Luigjit dhe të 700-vjetorit të Shën Françeskut.

Si arqipeshkëv, posë sa e sa ndihmash që dha, si p.sh. për kishën e Berdicës, kreu dhe kishën e Rusit, Kapelën e Vorrezavet, shuguroi lterin e ri të Shëna Ndout në kishën Françeskane dhe përkrahi fletoren "Kumbona e së Diellës" dhe të tjera të përkohshme fetare e kulturore.

Mbas një vujtjeje të gjatë prej sëmundjes së diabetit (sëmundja e sheqerit), të cilën e barti me duresë, me 26 maj 1946 mbylli sytë dhe qe vorrosë në Katedrale me 29 të atij muaji.

### **Vargu i ipeshkvijve të Ballesit**

*Viti Ipeshkëvij*

13.. Guljelmi

1347 Gjerviku, françeskan

1351 Andrea, françeskan

1420 Alfonsi, françeskan

1424 Mikeli, Paulluz ase de Paolis nga Villa, i dioqezës së Trevizit, françeskan

1426 Bernardi de Ivanis ase de Vivanis prej Drishtit, françeskan

1459 Leonardi, napoletan, domenikan

1478 Danieli, Zahender, françeskan.

### **Vargu i ipeshkvijve të Drishtit**

887 N.N

1062 N.N  
 1122 N.N.  
 1141 Pjetri  
 1166 Martini  
 1199 Pjetri II  
 1220 N.N.  
 1250 N.N.  
 vit i pasigurtë, vdiq rreth 1322  
 1323 Nikolla, agostinian  
 1351 B...  
 1360 Gjoni i arkidioqezës së Tivarit.  
 1373 Bernardini  
 1374 Athanasinas Anastasi, prift i kishës së Shëna Ndout në Padovë.  
 ... Nikolla II nga Vilja, françeskan  
 1396 Andrea de Montanea ase Montaniana, fshat i Padovës, françeskan.  
 1400 Bartolomeo Poenbiolus nga Venediku, françeskan. Me origjinë shkodrane.  
 1424 Nikolla Vuallibasta.  
 1425 Dionizi de Knim. boem. françeskan.  
 1488 Mikeli de Paullia.  
 1445 Pal Dushi ase Pal Dussius nga Trevizi.  
 1455 Pal Ejllori; qe emnue arqipeshkëv i Krujës. La "Formulen e Pagëzimit" me 8 nanduer 1462 me anën e një qarkoreje që ia drejtonte të gjithë meshtarëve të Malësisë së Shqipnisë, me të cilën ai porositi varësit e tij që të këshillojnë popullin, në rasë se nuk mundën të dërgojnë foshnjat në kishë për të pagëzue me ujin e pagëzimit, t'i pagëzojnë ata vetë në shtëpi, duke përdorë formulën e liturgjisë, që asht: "Un te pagëzont premni Atit et Birit et Spirtit Senit". (Unë të pagëzoj për emnit t'Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjtë). Letër qarkorja asht nënshkrue në kishën e Trinisë së Shejtë të Matit, me 6 nëndor 1462. Fjalët e kësaj formule janë dokumenti i parë i shkruem i gjuhës shqipe. Ky dokument u zbulue më 1915 në Bibliotekën Lauretiane në Firence dhe asht shkruë, në alfabetin latin. (shif. letersia e vjeter shqipe dhe arbereshe, Bot. Ministrisë së Arsimit. Tiranë 1954). Kalisti III interesohet për krahinën e Shqipnisë e të Dalmacisë.  
 1457 Nikolla de Suma, kanonik i Drishtit e famullitar i kishës së Shën Mërisë së qytetit të Drishtit. Më 1474 vojt në Durrës.  
 1485 Françesku Ab. Ecclesia, nga Milani.  
 1509 Antoni, kanonik i kishës së Hispalisë  
 1512 Benedikti Kornis, hungarez, i arqipeshkvisë së Strigonies. Eprur i Urdhnit Premonstratez.  
 1516 Theofil Kamaldaleu.  
 1518 Françesku, françeskan.  
 1520 Gjoni de Lagnis.  
 1521 Gundisalvi de Ubeda, spaniol.  
 1525 Pjetër Ferdinandi, de Jaen, domenikan. s'dihet vjeti, Françesku de Selis.  
 1541 Alfonsi de Sanobrio ase de Sanobrie, kanonik i kishës së Hispalisë.  
 Mbas vdekjes së këtij, deri më 1636 nuk figuron asnjë ipeshkëv i Drishtit.  
 1636 Hieronimi Çuçich nga Varen i Bosnjes. Ky vdiq me 2.I.1648 dhe me këtë merr fund vargu i ipeshkëvijve të Drishtit.

### **Vargu i ipeshkëvijve të Ulqinit**

#### *Viti Ipeshkëvij*

- 377 N.N.  
1023 N.N.  
1030 N.N.  
1131 N.N.  
1141 Gjoni.  
1166 Gjoni II.  
1199 Natali.  
1257 Marku, domenikan.  
1260 C.....  
1300 Miroslavi.  
1331 Toma, domenikan, arkidiakon i Tivarit.  
1334 Gracia, nga Akuileja, Abruhez, françeskan.  
1343 Antoni, Salernitan, benediktin.  
1350 Pjetri, domenikan.  
1354 Gjoni nga Virenti.  
1360 Nikolla.  
1406 Mateu.  
1410 Tadeu de Tadeis, venedikas.  
1411 Gjoni nga Breshia, françeskan.  
1414 Nikolla Vallibasta, kanonik i kishës së Ulqinit.  
1424 Françesku, françeskan.  
1435 Pjetri që qe më parë ipeshkëv i Shasit.  
1441 Paganini nga Bergamo.  
s' dihet viti, Martini Segona nga Novomontan ase Nevopirgu, në Serbi të Re.  
1486 Marini Gamba.  
1515 Lorenci Bosketus ase de Bosketis.  
1528 Pjetri III, françeskan, famullitar i Mulgarecias de Urrea, zviceran.  
1536 Jaku de Medio, françeskan. Duket i njajti me Jak Dalmasius, përpara ipeshkvi i Budves.  
1558 Andrea Jubica, arqidiakon i kishës së Ulqinit. Mbas vdekjes së tij, më 1565 administrimin e kishës së Ulqinit e merr Gjon Bruno, Arqipehkëv i Tivarit.  
1571 Gjon Bruno, administrator. Këtu merr fund vargu i ipeshkëvijve të Ulqinit.

### **Vargu i ipeshkëvijve të Shasit**

- 877 N.N.  
1030 N.N.  
1062 N.N.  
1141 Vasili.  
1166 Pjetri.  
1199 Deda.  
1200 G...  
1250 N.N.

1303 Gregori, françeskan.  
 1308 Benedikti, kanonik i Tivarit.  
 1318 Katari ase Zakaria, domenikan.  
 vit i pasigurtë Sergji ase Shirqi.  
 1345 Pali, karmelitan.  
 1363 Pjetri II. Ky pranoi në gji të kishës katolike, në vitin 1368 Strazimirin, Gjergjin e Balshën, princa të Zetës.  
 1402 Pjetri Kirten.  
 1418 Antoni, fiorentin, domenikan.  
 1420 Pjetri IV.  
 1439 Sergji II.  
 1440 Pal Dushi.  
 1446 Antoni de Fabriano françeskan.  
 1510 Shtjefni.  
 1517 Nikolla.  
 1720 Gjoni Baza, kanonik i Shasit.  
 1530 Toma kanonik rregulltar.

Këtu merr fund vargu i ipeshkvijve të Shasit, sepse tashti bashkohet me Shkoder. Simbas Regestit të Imzot Pal Kamsit, në vitin 1745, Shkodra kishte këto lagje: Tophana, ku ishte qendra famullitare, me 150 shtëpi, me 680 frymë. Shtëpitë ishin të krishtena të fsheht, quejtë laramanë me 33 frymë. Kisha e Tophanës ishte kushtue Shën Dodës. Kazena kishte 140 shtëpi me 459 frymë. Kjo përfshinte Shën Lavrendin me 2 shtëpi, 10 frymë; Qafën me 1 shtëpi 10 frymë, Kishaj me 9 shtëpi 25 frymë: kjo lagje kishte dy kishë: njënen të Shën Mërisë Magdalenë dhe një tjetër të Shëna Prendes. Vorret ishin në Zarufë afër Shirokës, ku tani janë varrezat e fshatit: Shiroka kishte 63 shtëpi me 384 frymë e përfshinte lagjen Kepi i Madh 1 orë larg Shirokës kah Zogajt, me 11 shtëpi 49 frymë.

Dokumentat tregojnë se vorre ipeshkëvijsh kishte edhe në kishë të Shëna Prendes. Regesti i Venedikut shkruen se, në vitin 1610, kur meshtari kërkonte me thanë meshë në Rëmaj, përshkohej nëpër fushën pjellore të Gjuhadolit (Passava per la fertile compagna di Glucadoli), sot pothuejse zemra e qytetit. Simon Gjini i cili ka vdekë në moshë të shtyeme, afër 90 vjetëve, tregonte se Rëmajt ishte mbas shtëpisë së Mark Naraçit. Kel Muzhani la shenim se në Shkodër, para 131 vjetëve, nuk pati kishë. Vetëm në Rëmaj një kishëz me hajat mbështetës ndër shtylla, ku mblidhej burrnimi me pa meshë dhe kur meshtari shuguronte, xhakoni tundte një shishe gatarjet me guraleca mbrenda në vend të kumbonës ase zilit.

Aty janë krezmimet ku, ndersa tjerë, asht krezmue Leci i Kolë Ndrekes, krushku i Kel Muzhanit. Kur burrnimi shifej tue dalë prej kishë, gratë prej shtëpiave, te Ura Dervish Begut, qitshin orizin me zie pilaf d.m.th. zgjaste plot 25 minuta prej aty deri në konak. Nuk asht për t'u çuditë, sepse 140-160 vjet ma parë, te shtëpia e Loro Pistullit, te Dugajët e Reja, Hila Hysë Metës, rrogëtari i Hysos, gjyshi i Ndreke Shllakut, ka ngamë qetë aty dhe Gjergj Ndokë Sheldija, gjyshi i Gjushit, ka gjuejtë rosa te vendi ku tani asht sahati i Inglizit, se ma në oborr të Kishës së madhe, thonte plaku i Boksit (që vdiq në vitin 1930, 120 vjeç) kam mbjellë sa vjet bastan.

Zyra famullitare që ishte në Tophanë, te shtëpia e Rapushit, simbas shkrimeve të konsullit francez Pouqueville, dhe të regjistrave të pagëzimeve të kishës famullitare të

qytetit, u bart aty kah viti 1800 dhe xuni vend në shtëpinë e Gaspër Muzhanit, në rrugën e Rrakacojve, aty ku tani, përbri saj, u ndertua kinema "Republika".

Në vitin 1857, Ferit Mustafë Pasha, zbriti me familje nga kështjella e xuni vend në shtëpinë e Dervish Begut ku tani asht lagjja 28 nanduer. Lagje që ishin rreth kalaje: Tabakët, Qafa, Ajasma, dhe rreth kodrave të Tepës, Tepja, Domnorët, Draçini, Kërçirejt, Serdarejt, Kara-Hasan, Lugu-Çesme dhe u krijuen lagje të reja, si: Perashi, Parruca, Zdralej, Garuci, Ndocej, Kirasi, Derguti, Rus-Maxharr, Rusi Katolik, Gjuhadoli, Serreqi, Ballabanja, Badra, Rusi Madh, ndersa si lagje ma të hershme përmendën, përveç Tophanës, Rëmajit, Kazenet e Kishajt, edhe Ura e Dervish Begut, që u quejtë edhe Sokak Nemce, ngase aty së parit pat qenë konsullata austriake, Arra e Madhe, Perashi e Ndocaj. Në toponomastiken (prej ndonjë karakteristike të veçantë) u thirrën: Fojletat e Punëtorëvet, në krye të Rusit Katolik, aty ku asht fidanishtja pyjore prej se mblidheshin punëtorët për të xanë punë me mëditje; Xhamia Plakë në lagjen Rus i Madh, Hani i Salo Kalit, Vorri i Fratit e Ura e Maxharrit, në Rus të Naltë; Pusi i Marë Jubanës në Badra, e cila pat ra viktimë për të mbrojtë nderen e së bijës nga ushtarët turq që e theren mizorisht; Rruga e Palinë Canës prej se aty banonte ajo që ishte teknike për lamjen e Leshit. Aty mblidheshin grosistat për eksportin; Ura e Madhe ase Ura e Jacit dhe Lama e Spahijvet andej kah ura e sotme e Kirit; Çinari i Tophanës në lagjen omonime, Çinari i Hoxhës së Dheut, në rrugën e Gjylbegaj, Çinari i Zef Zorbës sipri vorrezave katolike, Fusha e Qelës, në sheshin kryesor prej se aty afër ishte qela famullitare, xhamia e Kuqe, në krye të Perashit, xhamia e Bardhë, në fund të Perashit, xhamia e Shaban Efendisë, në fund të Ndocaj. Këto qënë shpesh si pikë orientimi për qytetarët e fshatarët.

Në vitin 1923 lagjet e qytetit ishin këto: Draçini, Lugu, Arra e Madhe, Serreqi, Ballabanja, Badra, Gjuhadoli, Rusi Naltë, Skanderbeg, Tophanë, Shaban Efendi, Has-Hot, Maxharr, Kiras, Derguti, Dudasi, Ndocej, Rus i Vogël, Hasan Riza, thirrë edhe Fusha e Druvet, prej se aty shiteshin drutë me ngarkica, Rus i Madh, 28 Nanduer, Lekaj: pra, plot 30 lagje.

Pouqueville bie se rreth vitit 1800 Shkodra kishte 18.000 banorë. Në vitin 1819 pati ra një murtajë e madhe e cila bani kerdi në Shkodër dhe Shirokë: në dimën 1869-1870, lumi Drin ktheu shtratin e vjetër tue përtrimë kënetat dhe tue përhapë malarjen e cila në vitin 1874 pat ba kërdi në ushtrinë otomane.

Konsulli francez Hecquard ven këtë popullsi në vitin 1857: 4500 shtëpia të pjestueme si vijon: 3000 shtëpi myslimane, 1400 shtëpi katolike dhe 100 shtëpi orthodoxe me një siprinë cirkonfencionale prej 4 mil, ndersa, 24 vjet ma vonë Gopçeviç, shkruen se shtëpiat ishin 3500 me 24400 banorë të pjestuem: 16.000 myslimanë, 7500 katolikë dhe 900 ortodoksë.

Me 25.II. 1854, Imzot Topich, pati nga selia shejte 29 fakultete të vlefshme për 75 vjet dhe po këtë vjet arriti fermi i Sulltanit për ndertimin e kishës në Shkodrën e re, të cilën populli, mbas rrënimt të së vjetrës, kishte lypë e kërkue me të dhanun.

Me 12.III. 1855, Kongregacioni i Propagandes dha dekretin për krijimin e një seminari provincial në Shkodër, i cili u quejt Seminari Papnuer. Duhet shenue se edhe ma përpara këtij në qytet ekzistonte një seminar dioqezan, sikurse e dëshmon K.Pooten, në dorëshkrimet e tij fq.162, ku nder sa të tjera shkruen se si rektor i këtij seminari, rreth vitit 1845, ishte Imzot Pal Dodmasej, i lauruem dy herash në kolegjin Urbane, mbas tij Dom Ejëll Radoja.

Themelet e seminarit të ri u shtinë me 12.IV.1856 kur një pjesë fanatikësh të shtyem nga



propaganda e huej shkuen me rrenue muret e për ketë pat ba një demonstratë navale në Grykë të Buenës nga ana e flotës austriake nën kryesinë e arqidukës Maksimilan. Me 18.II.1857, Dera e Lartë lëshoi fermanin me të cilin njihte "Emancipimin" e krishtenëve të perandorisë.

### **Shënime historike rreth dioqezës së Lezhës**

Lezha (Lissus-Lyssos) thuhet se u themelue nga Dionizi Plak i Sirakuzës aty kah viti 385 para Krishtit. Ka Akrolisson ase Malin e të Shelbuemit, nalt 410m dhe Akrolisson e Lezhës nalt 186 m. Maja e Akrolisson-it gjindet në tyrbe, thirrë Xhymert Kasap.

Diodor Siculi la të shkrueme se themeluesi kishte pajisë qytetin me gjimnaze të mëdha e me tempuj të bukur. Hani gjet nën dhé mbi ndertesat bizantine e veneciane, tepricat e fundit të vepres dioniciane. Plini e quen vend i banuem prej qytetarëve romakë. Qiriako i Ankonës në vitin 436 pau muret e mëdha me mbishkrime Latine.

Në vitin 1393 familja e Dukagjinasvet ia lëshoi Venedikut. Në vitin 1440 kështjellën e rrënoi një zjarr i madh. Në 1 mars 1444, Gjergj Kastrioti Skënderbeu mbajti Kuvendin e Lezhës ku u lidh Besa Shqiptare dhe po aty, me 17 kallnuer 1467, vdiq e u vorrue në Katedralen e Shën Kollit e cila, si hynë turqit, qe shndërrue në xhami. Në vitin 1478 ra për të parën herë në dorë të Turkut. në vitin 1501 banorët e Lezhës kërkuen ndihmën e Venedikut që mbas një marrëveshjeje me Turqinë, e mbajti deri me 1506, kur e pushtoi Sulltan Bajaziti, por që kështjellën e kishin shembë më parë venedikasit.

Në vitin 1614 në kështjellë banojshin 80 shtëpi turke. Po në këtë vit, pazari i Lezhës kishte 500 shtëpi. Kisha e Shën Kollit u shndërrue në xhami në vitin 1580. Qysh që Lezha ra në dorë të Turkut, ipeshkëvijtë, më të shumtën, ndejën në Merqi deri në vitin 1798. Imzot Malci zuni vend në Vel. Në vitin 1847 ngulën në Kallmet. Kah viti 1592 Shën Gregori emnoi ipeshkëv Gjonin dhe për 768 vjet nuk permendet asnjë ipeshkëv. Acta et Diplomata përmendin një seri prej 14 ipeshkëvijsh tue nisë nga viti 1357 deri 1397. Eubel i shtoi në 28 ipeshkëvij tue i pru deri në vitin 1496, mjesa Pooten ven 40 ipeshkëvij tue e pru vargun deri te Imzot Dodmasej, i cili vdiq në Kallmet me 27 shtatuer 1868 (Mbas tij erdh Imzot Françesk Malczynski, polak, prej 1870 deri më 1908).

Në vitin 1405 përmendet kisha e Shën Mrijës.

Prej 40 ipeshkëvijvet të Lezhës, simbas dokumentave, vetëm 15 qenë shqiptarë. Jerokli Sinekdemi i shek. X beson se Lezha ka ba pjesë për do kohë nën Durrës, por kjo bie poshtë simbas dokumentit të Imzot Pooten të vitit 1863 bazue në Farlatin. Lezha pati shumë kishë e manastire të përmenduna si ai i Shën Llezhdrit në Mal të Shejtë të Oroshit, i Benediktinëvet dhe i Françeskanëvet në Lezhë me kishën e të Shelbuemit, të Shën Llezhdrit të Bokianit (përmbi Spiten, Zejmen) dhe Kuvendi që dikur ishte i Benediktinëvet simbas një shenjimi të Cohen, vit II.1166.

Mark Skura arqipeshkëv i Durrësit la të shkrueme se dioqeza e Lezhës kishte 14.000 katolikë, mjesa në vitin 1649-1653 Mark Kryezezi thotë se Lezha kishte 23 prifterinj, 19 xhakoj, 8.000 katolikë. Ipeshkëvi Gjergji II, në vitin 1656 katolikët i cakton në 7.000 vetë. Imzot Pooten në vitin 1866 ven në dioqezë 22 famullina me 20.000 katolikë dhe provon se kjo dioqezë kje gjithmonë sufragane e metropolisë së Tivarit.

Në vitin 1887 Lezha si edhe Sapa e Pulti që përpara ishin sufragane të metropolisë së Tivarit , u banë sufragane të metropolisë së Shkodrës.

Tashti vetëm Lezha ka vetëm famullinat e krahinës së vet.  
Në vitin 1888 në krahinën e Lezhës figurojnë 24 famullina (simbas Missiones Catholicae, 1888); Lezha, Kallmeti, Kakarriqi, Balldreni, Merqia, Vela, Bulgri, Kryezezi, Manastiri, Gryka, Pëllana, Zejmeni (Sojmeni). Në krahinën e Mirditës: Oroshi, Spaçi, Kashnjeti, Korthpula, Shën Gjergji, Kaçinari, Frenga, Kalivaqja, Qafa e Malit, Fandi, Nderfana e Blinishti.

### **Ipeshkëviztë e Lezhës**

#### *Viti Ipeshkëviztë*

592 mbas Krishtit, - Gjoni.

Këtu mbetet një boshllëk prej 768 vjetësh dhe deri tash dokumenta arsyetues nuk ka.  
1360 (rreth) - Dionizi.

1370 - Deda.

1385- Gregori nga Venediku, domenikan.

vit i pasigurtë - Andrea nga Trevizi, domenikan.

1426 - Andrea II, lindur në Epir.

1426 - Pjetri nga Pirani.

1456 - Andrea III. Papa i dha lejen me zgjidhë prej mallkimit Pal Dukagjinit, i cili kishte ba lidhje me Turqit. Papa Kalisti III me 18.VIII.1457 i jep Princit të fuqishëm, Gjergj Kastriotit, fakultetin me i shpallë popullit se të gjithë ata që do të vizitojshin e do të ndihmojshin për rindertimin e kishës së Shën Nikollës në Lezhë, fitojshin ndjesen për disa ditë të mëdha.

1457 - Vlashi de Albania (nga Arbëni ?), domenikan.

1489 - Pjetri II Maloncius nga Venediku.

1498 - Françesk Gaspere, françeskan.

1509 Pjetri III.

vit i pasigurtë - Gjergji.

1513 - Mikeli de Natars nga Natars, provincë e Kabaliceses, domenikan.

1517 - Nikolla.

1518 - Gjoni II, françeskan.

1519 - Ferdinandi de Rosa, me gjasë spanjoll i Urdhnit të Shperblimit.

1525 - Nikolla II de Nante vdes.

1525 - Gjoni III de Stymaj, lindë në Shqipni.

1535 - Guljemi Alebrox de Turbi, karmelitan, profesor teologjie.

1558 - Nikolla III Guerini, i Urdhnit Çertozinëvet.

Vit i pasigurtë. Gjoni IV. Në vitin 1570 qe burgosë e si duket edhe merge nga turqit, sepse si i dyshimtë se kishte pasë gisht me venedikas, kur këta deshën me ripushtue Lezhën në atë vit.

1575 - Theodori Kalompsi, kanonik i Ulqinit edhe në Shkodër.

1578 - Marini Marjan Braiano, françeskan. Për dy vjet qe edhe zevendës në Shkodër.

Vit i pasigurtë. Inoçenci Stoiçina nga Raguzi, benediktin.

1561 - Benedikti Ursini, nga Poçovi, dalmatin. Në vitin 1626 qe administrator i Shkodrës, detyrë të cilën e mbajti deri më 1637 që ia lëshoi priftit të Tivarit e Komisarit Apostolik të Epirit Gjergj Vulskoviçit.

1649 - Mark Skura. Ky në vizitë që i ban dioqezës, arqipeshkëvi i Durrësit, ve 14.000

katolikë me 10 meshtarë, ndersa Marku Kryeziu jep 18.000 katolikë me 19 klerikë.  
 1656 - Gjergji II Vladanji, shkodran. Ky shenon se Lezha ka 7.000 banorë katolikë. Vdiq më 1692.  
 1692 - Nikolla IV, Vladanji, shkodran. Mori pjesë në Konçilin I shqiptar. Qe porositë me pasë kujdes për klerikët e Seminarit të Veljes.  
 1728 - Gjoni IV Gallata, lindë në Kurbi, Durrës.  
 1738 - Simoni Zezaj (Negri) nga Zadrima.  
 1748 - Pali, gjak me Imzot Pal Kamsin, Ipeshkëv i Shkodrës.  
 1750 - Antoni Kryezezi nga Lezha, françeskan.  
 1765 - Gjergji III Junki, lindun në Tivar, më 1786, qe emnue arqipeshkëv i Tivarit. Vdiq më 26.I.1787.  
 1786 - Mikeli II Kryezezi, prift i Lezhës. Qe njëherit dhe Abat i Shën LLezhdrit të Mirditës.  
 1798 - Nikolla Malçi. Vdiq më 1825. Në vitin 1802 ndërtoi qelën në Vel, ku pat rezidencën.  
 1826 -Gabrieli Barishti nga Bosnja. Qe vizitator Apostolik i Shqipënisë. Si vojt i në Raguzë për disa kohë për arsye shëndetësore, erdhi në Kuvend të Françeskanëve, në Kep të Rodonit, ku vdiq më 1841 dhe aty u vorru. Qe françeskan.  
 1842 - Gjoni Topich. Lindi në Spaletto më 1790. Qe françeskan.  
 1853 - Luigji Çurçija lindun në Raguzë.  
 1858 - Pali II Dodmasej, shkodran.  
 1870 - Françesku Malczynski, polak. Deri në vitin 1905. Pati si ndihmës Imzot Fr. Leonard Deda. Mbas vdekjes së Imzot Leonard Dedës që vdiq më 1907 e mbajti edhe për një vit ipeshkëvinë e Lezhës, megjithëse ishte në pushim.  
 1905 (30.IV.)-Leonard Deda, shkodran. Vdiq më 1907.  
 1911(21.IX)-Imzot Luigj Bumçi, shkodran. Vdiq më 1945. Nderto i Kishën e Kallmetit.  
 1949-1951(fund) - Dom Ndre Lufi, Vikar Kapituluar.  
 1951 (Janar)-Dom Ndoc Sahatçija. Vikar Kapituluar, me ndejë në Merqi.

### **Shënime historike rreth dioqezës së Sapës**

Dioqeza e Sapës që populli tashti e quen e Zadrimë, ishte e ndamë në dy dioqeze të vogla, si ajo e Sardës dhe ajo e Dejës. Dokumentat e shek.XIV dishmojnë se Car Dushani ia fali kuvendit ortodoks të Prizrenit kishën e vogël buzë kalasë së Dejës, kushtue Shën Mërisë. Mandej kaloi nder duer të Ballshajvet të cilët në Dejë patën një doganë të randësishme. Gjergji Strazimiri Balsha ua lëshoi venedikasvet në vitin 1396, por para se ta shtinte në dorë Venediku e zaptoi Kojë Zakarija "Zotnija i Sapës dhe i Dejës", i cili u kthye në fe katolike së bashku me familjen e vet. Sikurse shifet nga një letër që i dergon me 14 korrik 1414 Papa Gregori XII. Kah viti 1431 del aty një sundimtarë turk. Në vitin 1444 Boza, e bija e Kojës, nana e Lekë Zakarisë ia ktheu Venedikut Dejen së bashku me kështjellën e Shatit (kalaja e Sapës). Në vitin 1447 e merr Skanderbeu e me 1456 kalon ndër duer të Dukagjinasvet, por Lekë Dukagjini në marrëveshje me vëllaznit ia lëshuen Venedikut, në vitin 1458.

Vargu i ipeshkëvijve të Dejës kapet deri në 11. Nisë nga 1361 deri në vitin 1520. Papa Eugeni IV, mjesa ishte ipeshkëv titullar Pjetër Metija (27 korrik 1428), kishte bashkue në një dioqezet e Sardës, Sapës e të Dejës. Si dioqezë qe fare i vogël e duket se përfshinte

edhe Sheldijen, Ganjollën, Gomsiqen, e Gryken e Gjadrit. Deja pati kishen katedrale mbrenda ledhevet të kalasë kushtue Shën Markut, ndertue në rrenojat e një kishë së vogël që asht rindertue mbi mbeturinat e germadhat e së vjetrës. Në derën e anës lindore, ne e djabathtë, asht një rrasë me një datë përkujtimore 1455. Poshtë në breg të Drinit qendron në kambë kisha e vogël e stilit gotik, me afreske permbranda kushtue të Lemit të Zojës. Permendet që më 1198, e i ka qëndrue rrymës së motevet dhe asht i vetmi monument meskohuer në kambë që shofin sot. Bri kësaj, në vitin 1930 Dom Nikollë Sheldija, asokohe famullitar aty, ndertoi një kishë të re të të njajtit stil, veper e Inxh. Kolë Idromenos.

Sikurse del nga Dokumentet, Sarda (Shurdhahi) asht ma e vjetër, ende sot shifen rrenojat sipri krepavet të Leja e Dushit përmbi Dri, përkundruell kishës famullitare të Mazrrekut si edhe germadhat e kuvendit të vjetër të benediktinëve në Shat që i kje kushtue Shën Sofijës.

Si seli ipeshkvnore përmendet përpara gjysmës së parë të shek. V, simbas një letre të Papës Celestin I që ia dergon ipeshkvijve të Ilirisë me nënshkrimet e tyne në Konçilin e Efezit në vitin 131.

Vargu i ipeshkvijve të Sardës fillon me 1190 e mbaron me 1660. Me 1490 Sarda u aneksue me dioqezan e Sapës. Sigurisht se kah fundi i shek.XII dioqeza i Sardës kapej me kufi me dioqezan e Pultit tue përfshi edhe 7 bajrakët e Pukës. Papa Marini V (1428) bashkoi kishën e Dejës me të Sardës. Kur nuk zgjodhën ma ipeshkëvij të Sardës, administrimi i Dejës iu mbështet ipeshkvisë së Sapës qysh më 1490, Sarda Deja e Sapa, u bashkuen në një.

### **Vargu i ipeshkvijve të Sardës**

*Viti Ipeshkvij*

1190- N.N.

1192 - Theodori.

1266 - N.N.

1266 - Pjetri Tibertini, françeskan, italian.

1278 - Prometeu i Absburgëve, jeremi i Shën Ausanit.

1291 (mars) Tanushi, por nuk dihet se si u shugurue ipeshkëv.

1370 (deri) Nuk përmendet ndonjë ipeshkëv.

1370 ( 25.8) Ebymundi (Raimundi) arqipresbiter i kishës së Dioklesë.

1381 - Jaku, agostinian, abat i kishës Shën Sofisë në Zento.

1386 - Peregrini, benediktin.

1386 (i pasigurtë) Antoni I.

1392 - Antoni II.

1392 - Antoni III.

1395 - Marian Genci, reatin.

1402 - Andrea i kishës Shën Sofisë në Zenta.

1412 - Gjon Pëllumbi (Pllumbi) prift i kishës së Sardës.

1428 - Pjetër Matia, kanonik i kishës së Sardës.

1444 - Shtjefën Dukagjini, arkidiakon i kishës së Shkodrës.

1460 - Jaku II.

### **Vargu i ipeshkvijve të Sapës**

*Viti I peshkvij*

1291 - Pjetri I.

Vit i pasigurtë, Pali.

1376 - Benevenuli, françeskan.

1396 - Pjetër Zakaria.

1414 - Nikolla.

1422 (mars) Mëhilli, kanonik i kishës së Sapës.

1425 - Pjetri II, abat i Shirqit, benediktin.

1431 - Pjetri III.

1433 - Mateo, prift i Arbënit me mbiemën de Hernolais, prej së cilës familje dolën 6 ipeshkëvij.

1440 - Gjergji, arqipresbiterian i kishës së Shën Mëhillit në Padovë.

1460 - Emanueli.

1470 - 1472 (rreth) N.N.

1473 - Marin Suma.

1479 - Gabrieli, françeskan.

1489 - Vlashi.

1490 - Prodokimi, për Sapën e Sardën.

1501 - 1507 Pjetri Stebinja.

1508 - Deda Garcia, domenikan.

1512 - Ambrozi Montemini.

1513 - Gjergji III.

1514 - Didaku Fernandez, ase Fernates, domenikan.

1516 - N.N.Thuhet se ka mujtë me qenë Pjetri Tallorsi.

1518 - Gjoni Bonaventura de Valderama, françeskan.

1521 - Alfonsi Kavaçiri, françeskan.

Për 50 vjet këputet vargu i ipeshkvijve dhe nuk dihet arsyeja.

1582 - Tossoli (Theobaldi) Blankus (Bardhi) nga Sapa diku thirret edhe Tosolus.

1583 - Gjergj Palma, kanonik i kishës së Tivarit.

1594 - Nikolla Bardhi nga Sapa.

1620 - Simoni Gjeçi, Jeçi ose Greçi nga Arbëni.

1621-(20.VII.) Pjetri Budi, matian, prift i Arbënit, lindë në Gurë të Bardhë të Matit me 1566, qe nxënës i Kolegjit Ilirik të Loretit. Në korrik 1621 u emnue ipeshkëv i Sapës. Në vjeshtën 1621 përgatiti planet për kryengritjen të përgjithshme kundër Turqisë. Botoi "Doktrina e Krishtenë", "Pasqyra e të Rrëfyemit", "Ritualin Roman". U mbyt në Dri me 1623, tue i shërbye zyres së tij.

1623 - Gjergj Grili Bardhi nga Sapa. Më 1635 u emnue arqipeshkëv i Tivarit.

1635 - Frang Bardhi nga Sapa, gjak me Nikollë Bardhin. Qe nga Sapa, sikur e deshmon vetë në shkrimet e tij; qe nga familja e Bardhajve. Nxanës i Kolegjes së Loretit. Pa krye këndimet u zgjodh ipeshkëv i Sapës. I doli zot shqiptasisë së Skënderbeut me vepren e tij të botueme në Venedik si përgjigje ipeshkvit të Bosnjes Gjon Tomak Maranoviqit, i cili donte me e qitë Skënderbeun me origjinë boshniake. Aktivist i madh, la shumë materiale historike e gjeografike për Shqipninë. Botoi fjalorin "Shqip-italisht".

1644 - Gjergj Grili Bardhi, ardhë me kërkesen e tij, nga arqipeshkvi i Tivarit.

1647 - Simeoni Suma, françeskan. Qëndroi 30 vjet si ipeshkëv.

1675 - Shtjefen Gaspari, famullitar i Durrësit. Vizitator Apostolik në Shqipni. La shenime

rreth famullinavet të vendit.

1682 - Martini Jeliq, nga Spica e Tivarit.

1685-1705 - Gjergji Teodori nga Sapa.

1707 (prill) - Egjidi Quinctius de Armento nga Lukania, françeskan.

1719 - Marin Gjini, shkodran.

1720 - Gjoni Gallata, kurbinas.

1738-1744 - Vasili, lindi në Lisna. Qe prift i dioqezat të Pultit.

1746 - Lazri Vladanji, shkodran.

1750 - Gjergj Vladanji, shkodran, vëllai i Lazrit.

25.VIII.1765-1791 - Nikolla, ndoshta i vëllai i Vasilit.

2.IV.1791-21.XII. 1794 - Gjoni Logoreci, shkodran.

1796 - Antoni Radovani, shkodran, mbiquejtë Ejell vëlla apo axhë i Gjergjit, Arqipeshkëv i Tivarit.

1808 - Marku Negri, zadrimer.

24.XII 1825 - Lekë Suma, ish Vikar Kapitullar i Sapës.

1827-15.II.1830 - Lazri Vladanji shkodran.

13.II.1836 - Pjetri Borci, shkodran, vëlla apor i aferm me gjak me Frano Borcin, arqipeshkëv i Tivarit.

1844 - Gjergj Labella, nga Arnio Umbria, françeskan. Mbas tre vjetësh dha dorëheqjen e vdiq në Romë me 27.X.1860.

1.II.1845-7.XI.1873 - Pjetri Saverini nga Barba Senegalje. U vorrue në Nenshat Zadrime.

1890 - Luli Marsili, françeskan, u shugurue në Shkodër me 6.II.1874 në Katedrale nga imzot Karlo Pooten. Ma parë qe prefekt i Misionit apostolik të Kastratit. Më 1875 mori pjesë në Konçilin III.

1890 - Lorenci de Petris Dollamare.

1893-2.II.1900 - Gabriel Nevriani, françeskan, mori pjesë në Konçilin III.

1900 - Joakin Serreqi shkodran, françeskan. U zgjodh, por nuk e pranoi.

1901-1905 - Lazer Mjeda, shkodran.

29.X.1905- 22.IV.1910 - Jak Serreqi.

21.IX. 1911- 2.I. 1928 - Gjergj Koleci, mirditas, shugurue në Shkodër.

25.VII.1928 - 9.X.1935 - Zefi Gjonali, mirditas dha dorëheqje dhe vojt në Torino Itali ku vdiq me 1956.

6.II.1936-15.VIII.1940 - Vinçenci Prennushi, shkodran, françeskan. Qe shugurue në Shkodër me 19.III.1936.

25.V.1940-3.II.1948-Gjergj Volaj nga Shiroka, prift, shugurue në Katedrale të Shkodrës nga delegati Apostolik Leon Nigris.

1950 (qershor) - Gjon Kovaçi, Vikar Kapitullar i Sapës, famullitar në Grash, drejton dioqezën.

\* \* \*

Weigandi në veprën e tij Alb. Deutscher St. thotë se në toponomastikën e tanishme nuk ka mbetë gjurmë për emnin Sapë, me përjashtim të kalasë së Capës që naltohej ku tani asht kisha famullitare e Nenshatit. Emni i Sapës del për herë të parë me 11 qershuer 1291 simbas një letre që i dergojnë Papës Nikolla IV, Mëhilli, arqipeshkëv i Tivarit dhe Helena, mbretnesha e Serbisë me të cilën i luten me i dhanë një ipeshkëv popullsisë katolike të një qyteti të rrenuem kaherë thirrë Sapa (Shif. A. Alb. I. 515). Dhe ky ipeshkëv, që u shenue për aty, kje Presbiteri Pjeter. Në vitin 1490 dioqeza i Dejës e

Sardës iu mbështetën një herë e përgjithmonë dioqezat të Sapës.

Kohën e Imzot Zmajeviqit, Zadrime kishte 910 shtëpi katolike e 9 myslimane. Fshatrat, simbas tij, ishin: Blinishti, Gjadri, Kodheli, Dajçi, Gramshi, Maba, Shkjezi, Mjeti, Hajmeli, Nenshati, Troshani e Kallmeti. Don Shtjefen Gaspri, shqiptar i lindun në Krujë, nxanës i Kolegjës Ilirike të Loretos e i Kolegjës Urbane, kreu një vizitë të imët e të kujdesshme nëpër Shqipni dhe kje zgjedhë për ipeshkëv i Sapës nga Papa Klementi X. Ky la të shkrueme, me 6 nanduer 1671 për dioqezan e Sapës sa vijon: (Shif. Makushev, Istor. Raznik. Varshavë, 1871, H.Dr. Vj. 223 e vazhdim): "Kufijtë e dioqezës shtriheshin kah veri deri në Iballe e kah jugu deri në Bushat, nga lindja, me malet e Benit e nga perëndimi me lumin Drin. Ky e ndan dioqezën e Sapës dysh; ipeshkëvia e sipërme ase e malit dhe ipeshkëvia e ultë ose e fushës".

E sipërmeja përfshinë popujt e Iballës; Apripa me 24 shtëpi e 120 frymë; Arsti me 40 shtëpi e 220 frymë; Alsicja me 24 shtëpi e 200 frymë; Mataj me 15 shtëpi e 150 frymë; Trueni me kishën e Shën Martinit me 7 shtëpi e 60 frymë; Dardha me 12 shtëpi e 130 frymë.

Famullitari i të gjithë këtyne fshatravet ka ndejë në Gralishtë e cila kje djegë, kur turqit mësyene Iballën dhe e plaçkiten. Ai thotë se të gjithë janë të vorfën.

Puka, dikur qytet bujar e i permendun, asht shndërrue në një fshat; ka kishën kushtue Shën Palit e cila dikur qe Abaci e përmbledhë 19 katunde me 250 shtëpi e 2.000 frymë dhe gjinden 3 kishë; një në Qerret, një në Koman, e një në Dush, por pa asnjë famullitar. Vjerdha në qytetin e Sardës e me fshatin e Mëdhojes ka 25 shtëpi me 200 frymë.

Fusha: Zadeja, dikur qytet, tani fshat me dy kishë, njenën e ka në Mjet të sipërme dhe përmbledhë 5 katunde me 35 shtëpi dhe 400 frymë: Hajmeli me 20 shtëpi me 330 frymë; Mjeda e poshtme me kishën e Shën Kollit ka 10 shtëpi me 60 frymë; e merr me vedi Pistullin 12 shtëpi me 70 frymë, Stajka me 13 shtëpi e 80 frymë, Kosmaçi me 4 shtëpi e 32 frymë, Shkjezi me kishën e Gjon Kryepremit 45 shtëpi e 500 frymë, Baba me kishën e Shën Panteleonit që përfshinë Dragushën, Paçramin, Gradecin e Zojzin 150 shtëpi me 900 frymë, Krythë me kishën e Shën Dhimitrit që së bashku me Dajçin, Kotrrin e Kodhelin 72 shtëpi me 750 frymë, Sapa, ndeja e ipeshkëvit, 30 shtëpi me 350 frymë, Blinishti me kishën e madhe të Shën Shtjefnit 80 shtëpi me 750 frymë, Gjadri 70 shtëpi me 510 frymë, Troshani me 30 shtëpi dhe 224 frymë, Fishta me 15 shtëpi e 150 frymë. Dioqeza ka 1.075 shtëpi me 9.226 frymë. Si kishë katedrale ka atë kushtue Shën Mëhillit (Shën Ejlli që populli e thurret Shna Ejlli) mbi malin e Capës.

\* \* \*

Vijmë tashti te Konçili I Kombëtar shqiptar mbajtë nën kryesinë e Imzot Vinçenc Zmajeviqit Arqipeshkëv Metropolit i Tivarit në të cilin u caktuen kufijtë ndermjet dioqezeve të Lezhës, Durrësit e Sapës, në prani të të derguemit të propagandes Françesk de Leonardis, Arqipeshkëv i Tru-t. Sapa mori sundim më të drejtë mbi Blinishtin deri te vendi i quejtun Nën Urë, Troshanin me kishën e Shën Kollit të lumit Kallun si dhe katundet e kishët e Vaut të Sapës. Dokumenti qe nënshkrue në selinë ipeshkëvnore të Sapës, prej Imzot Benedikt Ursinit ipeshkëv i Lezhës dhe prej Frang Bardhit, ipeshkëv i Sapës, më 20 dhetuer 1638. Në këtë dokument vertetohet se i përkitshin Zadrimes d.m.th. ipeshkëvisë së Sapës, kishët që dalloheshin ndermjet lumit Gosta e të lumit në Va Spas. Përveç ndonjë shënimi statistikor të Konçilit të Parë Shqiptar, mungojnë dokumentat deri

më 20.VIII. 1832, nësa ishte ipeshkëv Imzot Pjetër Borci, shkodran, i cili la këtë statistikë:

Katundi Shtëpi Frymë  
Nenshati 85 785  
Blinishti 67 563  
Dajçi 72 512  
Hajmeli 73 470  
Pistulli 54 526  
Maba 48 519  
Shkjezi 75 419  
Troshani 53 596  
Kodheli 34 264  
Gramshi 50 387  
Gjadri 57 315  
Naraçi 34 118  
Gryka e Gjadrit 30 252  
Vigu 42 370  
Mënela 61 582  
Zadeja 40 309  
Shllaku 108 724  
Mazrreku 36 237  
Sarda ase Shurdhashi 34 320  
Komani 40 242  
Karma 55 385

Me 16.X.1834 statistika e famullinave të zonës së malit ishte kjo:

Katundi Shtëpi Frymë  
Dushi 60 486  
Këçira 63 503  
Qelëza 218 1227  
Fierza 298 1785  
Alsiçja 146 1672  
Komani e Karma 93 627

Më 1.II.1845 merrte sundimin e dioqezës Imzot Severini, gati 24 famulli të kryesueme nga kleri shekullar nder të cilin ishin Troshani, Gryka e Gjadrit, Zadeja, Mënela, Vigu, Alsiçja, Fierza, Mazrreku, Shllaku, mjesa Shkjezi ishte bosh. Më 12.II. 1856 Troshani iu dha françeskanëve. Në këtë kohë selia ipeshkvnore zbriti nga Kalaja e Capës ma poshtë, në vendin e quejtun Bardhaj, mbasi ate e kishte rrenue termeti i dt.12.XII. 1853. Me dekretin e dt. 30.IX.1890 famullinat e Mënelës, Vigut dhe Gomsiqes iu mbështeten Abacisë së Mirditës. Kështu shkoi me Mirditë edhe Gryka e Gjadrit. Kohën e Imzot Gabriel Nevianit, tue qenë se brenda 12 vjetëve kishin vdekë 14 meshtarë dhe kishin mbetë 9 famulli pa prift, Berisha, Fira e Iballja iu lëshuen françeskanëve. Në vitin 1932 iu mbështeten Shkodrës: Shllaku e Mazrreku dhe iu hoq famullia e Stajkës që shkoi me Shkodër.



## Vargu i ipeshkvijve të Dejës

Viti I peshkvij

1361 - Donati, Paracha (Brraka).

1397-1401- Gjoni, domenikan.

1401- Vlasi nga Zagrebi, domenikan.

1410 - Andrea, ma përpara ipeshkëvi i Sardës.

1414 - Prebislau, agostinian, epruer i kuvendit Gnesman, Poloni.

1426 (rreth) - Pjetri, kanonik i kishës së Sardës.

1456 - Godefridi, karmelitan, ipeshkëv titullar i Dejës.

1520 - Guljemi, domenikan, ipeshkëv titullar i Dejës. Greveraius nga Geldria Belgjikë me ndihmen e Argicer Vikar i ipeshkëvit të Vintonies në Angli.

## Shënime historike rreth dioqezës së Pultit

Krahina e Pultit gjeografikisht sot përmbledhet: Qafë Thanë, Qafa e Bishkasit, Qafa e Malit të Shoshit e Qafa e Boshit.

I pari dokument historik që përmend Pultin asht një letër e Stefan Nemanjes, zhupan i madh i Serbisë, i cili ma vonë u ba murg në malin Athos e u quejt Shën Simeoni, sikurse e verteton në shkrimet e tij Shën Sava rreth vitit 1184. Një përshkrim ma të hollësishëm të Pultit t'Epërm e të Pultit të Vogël na e jep Perandori Stefan Dushani në vitin 1348, prej të cilit del se Pulti i Epërm përfshinte krahinën e Drinit, nga Ura e Vezirit deri në Valbonë, mjesa Pultin e Poshtëm e çon deri në breg të Liqenit të Shkodrës, tue përmendë Kalldrunin, Koplikun e Lohen.

Rohrbacher, në "Historinë e kishës", vëll. IV, fq.932 çekë se në vitin 516, kohën e Perandorit Anastas, shkojshin në Konstandinopull ipeshkvijtë e Illyrisë, nder të cilët Laurenti (Lorenci), ipeshkëv i Lychnidos (Ohrit), Alcison-i ipeshkëvi i Nikopojës, Cojni, ipeshkëv i Naison-it (Nishit) dhe Evangjeli ipeshkëv i Paulitonunsis. Dhe auktori pyetë, nëse Paulitensis asht i njajtë, me Pulatensis, Polatensis e Politensisis (Pulti).

Kah mbarimi i shek.IX, Polati (Pulti) ishte qytet ipeshkvnuer, sikurse vertetohet prej aktesh të Konçilit Dolmitan në vitin 877 ku dioqeza i mbështetet Metropolitisë të Diokletisë e të Tivarit, Aleksandri II, ia lëshon këtij Kishën e Pultit, deri që ma vonë me ramjen e Diokletisë xunë fill kundershimitet e vazhdueshme në mes të arqipeshkvijve të Tivarit e të Raguzës e cila donte me e mbajtë Pultin për vedi, por iu la prap sikurse Ulqini, metropolitë së Tivarit.

Deri në shek. XIV, nuk figuron asnjë dallim në mes të Pultit të Madh e të Pultit të Vogël. Në vjetin 1345 na dalin dy ipeshkvij: i Pultit të Madh e i Pultit të Vogël. Sepse ipeshkvi i Pultit që ekzistonte në të njejtin vit sikur ndër Regjistrat e Klementit VI qe zgjedhë Gjoni, që u quajt Episcopus Scodriensis d.m.th., i Pultit të Vogël. Por në të vërtetë Ipeshkëvia e Pultit të Vogël do të ketë fillue meshë përpara mbasi në regjistrat thuhet se u zgjodh Gjoni për Abatun Episcopi praedocenscoris (me rastin e vdekjes së ipeshkëvit paraardhës). Megjithëse sikur shkruen K. Pooten i mbështetun në Farlatin, nuk mund të caktohen me saktësi kufijt e dy dioqezave, prap se prapë i afrohen së vërtetës ata që vejnë Mejen e Ndërmajnës si vend ku përputhen të dy dioqezet d.m.th. në anë të malit Kishën e Pultit të Madh e këtij Malit, kah Shkodra Kishën e Pultit të Vogël. Në shek.XVI, nuk u

zgjodh ma ipeshkëvij të Pultit të Vogël. E që atëherë këto dy dioqezet u shkrinë në një mbas zgjedhjes së Vinçncit më 1520.

Duhet shenue se ipeshkëvijtë e Pultit të Vogël u thiren, herë Scodienzes, Scodonunsus, Scordinenaes, dhe si pamë ma naltë, Scodrianses.

Shenim: Duhet dijtë se për t'u formue një dioqezë, lypet të ketë qytetin nga i cili të marrin emnin (titullin). Provë e gjallë e kësaj asht Abati i Mirditës thirret Abbas Nullius (civitatis) pse në atë rreth nuk ka pasë qytet.

Simbas vertetimeve që na lanë Praschniker fq. 89, L.Ecy. Th. Ippen, Degrand, Kalendar i V.P. etj., del se në krahinën e Pultit si të Madh e të Vogël, që sot thirret Dukagjin, kanë mbetë disa monumenta të një së kaluemeje të ndritun sikurse janë Kisha e Shën Gjergjit në Toplan, me rrasë përkujtimore e afreske përmbranda, Kumbonarja e Kodër Shën Gjergjit bashkëkohëtare me atë të Kakarriqit dhe si toponimin i përmendun Kalaja e Bobit, Qyteti Dakaj në Shalë, Kalaja e Mavriqit, Celulet e Baziljanëvet në Breg të Lumit, etj. etj.

Vargu i ipeshkvijve të dioqezës së Pultit

Viti Ipeshkvij

877 - N.N.

1062 - N.N.

1121 - N.N.

1141 - Teodori.

1199 - Gjoni, mori pjesë në Konçilin e Dioklesë.

1227 - N.N

1251 - Andrea.

1308 - N.N. Në këtë vit dioqeza thirret Polacensis.

1351 - N.N.

vit i pasigurtë. Pjetri.

1367 - Nikolla prej kishës së Filadelfisë.

1370 - Nikolla. Kohën e këtij u fut me pahir Dhimitri Komneni në vitin 1372.

1376 - Mateu Nursia, agostinian.

1421 - Menelau Zakaria, jetoj shumë.

1450 (rreth) - Nikolla. Kohën e këtij, në vitin 1454 Biemi shkruen se, mbasi vdiq Pjeter Spani, dinast i Pultit, tue pasë hy grindja mes bijëve të tij, Skanderbeu, lutë prej Pal Ejllorit, ipeshkëv i Drishtit, vojt në Pult dhe i pajtoi, por prejse Marku ma i vogli s'pranoi e mori dhe e futi në burg.

1470 - Shtjefni, ish rektor i kishës famullitare të Shën Gjergjit de Asanis së Dejës.

1475 - Gjoni II.

1509 - Pjetri Gjoni, klerik i Pultit.

1518 - Izidori Almopoveri nga Brindisi Itali.

1519 (rreth) - Martini.

1520 - Vinçenci Stalone, abat, benediktin.

1529 - Lorenci Santarello.

1574 - Mateu II, Polonez, domenikan.

Për 80-vjet vendi mbeti vakant e nuk dihet arsyeja.

1656 - Vinçenvi Joanella i lindun në Kotorr. Nuk erdhi nga frika e turqve.

1698 - Pjetri Karagjiç, Vikar Apostolik i Pultit, Presbiter i kishës së Shkupit. Mori pjesë në Konçilin I të Arbënit. Mbas 4 vjetëve u emnue metropolit i Shkupit.

1703 - Marini Gjini, shkodran, famullitar i Shasit që shkonte me Shkodër. Mori pjesë në Konçilin I të Shqipnisë.

1719 - Pjetri Skura nga dioqeza e Durrësit. Vdiq më 1737.

1731 - Marku de Luki. Lindë më 1689 në katundin Lukiç afër Shestanit. Qe Vikar i arqipeshkvit të Tivarit. Më 1745 u emnue arqipeshkëv i Tivarit. Vdiq me 24.II.1748.

1745 - Serafin Durrjana nga Alzani-Bergamo, françeskan. Për 12 vjet qe misionar Apostolik në Shqipni. Mësoi gjuhën shqipe në Kolegjin e Shën Pjetrit de Montano. Ndej katër vjet mandej vojt në Romë e në Bergamo tue vijue me mbajtë titullin. Vdiq më 1762.

1756 - Gjergji Junki nga Livari i Tivarit. Mbasi ndej do vjet në Romë, ktheu famullitar i Zupçit të Tivarit. Pa i mbushë 30 vjet, në janar 1756 u zgjodh ipeshkëv i Pultit me 10.XII.1765. Me 8.X.1786 u emnue arqipeshkëv i Tivarit. Mori Palio-n në kishën françeskane në Lezhë. Vdiq në Livar (Ljare) ku u vorros prej Imzot Gjergj Radovanit.

1766 - Leka Bardhi. Vdiq më 1780 i rrëzue nga mushku.

1781 - Gjoni Logoreci prej katundit Brija-s së Shkodrës. Qe vikar i përgjithshëm i arqipeshkëvisë së Tivarit. Vdiq më 1796.

1791 - Marka Zezaj nga Sapa.

1808 - Antoni Dodmasej, shkodran.

1815 - Ejlli Kallmeti.

1818 - Pjetri Gjinaj, shkodran. Më 1.IV.1833 qe mbyttë mizorisht me sëpatë mbas kreje, prej xhakonit të tij, nësa ishte tue u nxe para votrës. Mbas vdekjes së tij deri me 1840 selia mbeti bosh. Në vitin 1840-1847 e mbajti me zavendësim Guljemi.

1847 - Pali Dodmasej, shkodran.

1858 - Pashko Imeski i familjes Vujçiq, dalmatin, françeskan. Qe epruer i kuvendit françeskan në Venedik. Më 1860 u emnue vikar apostolik në Egjipt. Më 1866 erdhi vikar apostolik në Bosnje.

1860 (18.X.)- Dariu Bucciarelli nga Castelpiano Romë. Qe françeskan. Ndej 9-vjet misionar apostolik në Shqipni. Me 10.III. 1861 u shugurue ipeshkëv në Katedralën e Shkodrës. Mbas tre vjetësh, më 1864 u zgjodh arqipeshkëv i Shkupit. Shkroi librin "Udha e Krygjës" dhe të tjera me përmbajtje fetare.

1864 - Pali Berisha nga Tupeci afër Prizrenit. Ndej shumë vjet famullitar i Shkupit. U shugurue në Katedralën e Shkodrës me 14.IV.1864. Vdiq papritmas në Brashtë të Shoshit, më 21.VIII.1869 dhe u vorros në Xhaj-Pult. 1870 - Alberti Gracchi, françeskan. U shugurue në Katedralen e Shkodrës nga Imzot Karlo Pooten. Mori pjesë më 1871 në Konçilin II të Shqipnisë. Vdiq më 1890.

1891 - Nikolla Markoni, lindun në Trento me 18.V.1842. Qe françeskan. Mori pjesë në Konçilin III të Shqipnisë më 1895. Shuguroi në kishën e Gjuhadolit me 3.IV.1910 ndihmësin e vet Imzot Benardin Shllakun. Në vitin 1911 doli në pushim dhe vojt pranë familjes së vet në Trento ku ndihmoi në krezmime etj.

1911 - Benardin Shllaku, i lindun në Shkodër me 23.VI.1875. Me 24.VIII.1890 hyni në Urdhnin Françeskan. Si kreu këndimet e nalta teologjike në Shvarz, Kaltern dhe Graz në Austri, me 26.XII.1898 u shugurue meshtar. Shërbei si mësues në Kolegjin Serafik në Shkodër e në vitin 1899 vojt famullitar në katund të Kastratit ku ndertoit qelën. Në vitin 1906 kthei mësues në Kolegjin Françeskane ku mbajti detyren e Definitorit të Provincës dhe Drejtor i të Tretit Urdhën. Në shtator 1909 qe çue famullitar në Vuksan-Lekaj e me 3.IV.1910 u shugurue ipeshkëv ndihmës i Pultit. Një vit mbas u ba ipeshkëv rezidenciar i Pultit që e mbajti deri në vdekje. Ndërtoi rezidencën e Xhanit e në vitin 1935 atë të Kodër

Shëngjergjit. Ndej 46 vjet ipeshkëv. Në gusht të vitit 1951 u zgjodh Kryetar i Kishës Katolike të Shqipënisë e ordinar i Arqipeshkvisë Metropolitane të Shkodrës. Vdiq mbas një sëmundjeje të gjatë, me 9.XI.1956 dhe mbas tre ditësh qe vorrue në Kishën Françeskane të Gjuhadorit simbas dëshirit të tij.

Bani shumë vepra të mira shoqërore. Meriton të përmendet pajtimi i Kastratit me Krajë dhe shpëtimi për tri herë i Dukagjinit nga rrënimi. Bani falje gjaqesh e nxori sa e sa lidhje bese si mes familjeve, ashtu ndermjet krahinës me krahinë.

1957-Antonin Fishta. Lindë në Shkodër. Si ndej sa vjet profesor në gjimnazin françeskan të Shkodrës qe dergue famullitar në Abat të Shalës, Dukagjin. Që nga viti 1948 mbajti vendin si i deleguem ipeshkvnuer për Pult. Me 25.IV.1957 u shugurue ipeshkëv ordinar i Pultit në Katedralën e Shkodres nga Imzot Ernest M.Çoba. Rezidencën ipeshkvnore e pati përkohësisht në Abat ku vazhdon të kryej edhe detyren e famullitarit.

### **Shënime historike rreth Abacisë së Mirditës**

Përveç legjendës së tre vllazenvet që u ndanë, njeri, i madhi tue marrë Shalën (prej kah Shala mori emnin si krahinë), tjetri shoshën, tue ngulë në Shosh dhe të tretit ma të vogliti s'i mbet tjetër me thanë veç " E mirë dita qoftë për mue", nga ku del emni Mirditë. Etnografikisht emni Mirditë del rreth 1416, në Katedralën e Ljubiçit, bot. në Atarine fq. 46, lib. 14. Kah viti 1436 kaloi nëpër Raguzë i biri i princit Prengë, në vitin 1470 popullsia e Mirditës asht e zoja të qesin 12.000 luftëtarë. Gjon Muzaka, kur shkruen historinë e shtëpisë së vet, në vitin 1510 nuk përmend aspak mirditasit, por vetëm thotë se shtëpia e Dukagjinasvet sundon Zadrimën, dy Fandet, Malin e Zi të Pukës, Pultin, Flatin, Qafen e Malit dhe bregun e majtë të Drinit. As Barleti nuk i përmend Mirditasit. Shtjefen Gaspari, në vitin 1671, shkruen se "popujt e Mirditës ishin futë në krahinën e Oroshit, ma parë Marin Borci shkruen se në vitin 1610 nuk e dojshin me e pranue reformën e Kalendarit Gregorian". Ami Boué, balkanolog i përmendun, thotë se "Muhameti II mori Krudjen, dhe rrethoi Shkodrën, Mirditasit qendruen vetëm me i ba ballë sundimit turk." Tue qenë se mbreti i Napolit nuk i strehoi ata që nuk kishin mujtë me emigrue, ia afruen vendin Dukës Karl Emanuelit të Savojës, por Europa nuk e çau kokën për ta e atëherë ranë në marrëveshje me Turkinë me qyshk që mos me u përzie në mes tyne" dhe nga ana tjetër Turku i lente të lirë me mbajtë armët, mos me pague taksat dhe mos me i luejtë zotnimet. Kah gjysma e shek. XVI, zgjodhën një princ prej familjes së Skanderbegut me emnin Zakari, i cili xuni vend në Orosh. Hecquardi, shkruen se, "Mirditasit, bile Prengë Lleshi prej fisit Skanderbeg Llesh, qe në shërbim të Ali Pashë Tepelenës, i cili nuk iu përzie në besim. Prenga, neveritë prej gjaksie të bame nga Mustafë Pasha, me mbyjtjen e të birëvet të Brahim Pashës, vojt e hyni në shërbim të Ali Pashës, mjesa Prengë Doda luftoi në Moré bashkë me Mustafë Pashën."

Mbas tij erdhi Lleshi i Zi i cili luftoi në Epir e në Greqi, shtini në dorë Tiranën, ku me dorë të vet vrau 9 (nandë) bejlerë. Mbas vdekjes së Mustafë Pashës ky qe mergue në Janinë. Në vitin 1844 del në shesh Bibë Doda i cili me Reshit Pashën luftoi në Epir dhe dekorohet me "Nishanin e Iftharit e të Mixhidijes"; po në këte kohë edhe Papa i ep dekoraten e Shën Gregorit; ky luftoi edhe kundra Malit të Zi, dhe tue qenë se Ymer Pasha filloi me u përzie në punët e brendshme të Mirditës, populli u çue peshë, rrethoi shtëpinë e Bibë Dodës dhe qenë tue e djegë për së gjallit mos të hyjshin ndermjet Ipeshkvi i

Lezhës, Konsulli i Anglisë dhe i Francës.1) Shenim: Dom Jak Bushati dhe Dom Prend Suli tregojnë se mirditasit mbas kungimit kishin zakon me pie venë, të cilën ia nepte prifti. Kjo venë në masen 8 okë, paguhej si e dheta e famullitarit.

Shumë mirditas sidomos fandasit kanë emigrue në Kosovë.

Dokumenti i parë i mungades së Shën Llezhdrit (Aleksandrit) mban datën e vitit 1319. Mirditasit kanë një nderim të veçantë për këtë Shejt, sikurse e verteton betimi, kur duen me dishrue të vertetën që përmbahen "për Arkë të Shejtit".

Abacia e Mirditës që nën varësinë e dioqezës së Arbënit, sikurse e vërteton Imzot Karl Pooten në fq. 107, i mbështetun në Farlatin, ku thuhet se në vitin 1367, Aleksi prej Arbënit, mungar benediktin i kuvendit të Shën Llezhdrit të Malit d.m.th. të Mirditës, prej Urbainit V me 20 prill të atij viti, e krijoi Abat i kuvendit të Shën Mërisë së Rotes së dioqezës së Tivarit.

Edhe përpara 1319, prej letrës së Gjonit XXII del në dritë se Abacia e Mirditës d.m.th. Kuvendi i Shën Llezhdrit që nën dioqezës e Arbënit. Gjithashtu gjejmë se me 1638 Mark Skura që ipeshkëv i Arbënit, pat pasë Abacinë e Shën Llezhdrit dhe kuvende të Shën Mërisë së Nderfandisë, e cila përmendet që më 1457. Kur me 1640 u ba arqipeshkëv i Durrësit, aneksoi edhe Ipeshkvinë e Arbënit, tue mbajtë klerin shekullar titullin e Abatit të Mirditës nën vartësinë e ipeshkëvit të Lezhës.

Ipeshkvi i Arbënit që sufragani i arqipeshkëvit të Tivarit.

Del se mbas Konçilit të Parë të Shqipnisë, famullitarët e Oroshit mbajtën titullin tradicional të kuvendit shejt të Oroshit që dikur që i benediktinëvet a por, sikurse e vejnë disa, i bazilianëvet. Abati i Mirditës kishte nën juridiksion, posë Oroshit, edhe Spaçin, por dyja këto, nën varësinë e Abacisë së Mirditës. Betimi që shpesh ndëgjohej nga goja e popullit, sidomos i atyne me të motnuemvet kur përbehen "për atë Shën Venedikt", dishmon se duhet të ketë qenë i Benediktinvet."

Pjeter Bjanku përmendet në Konçilin I shqiptar në vitin 1703; mandej vjen Abat Junku, e në vitin 1720 Abat Gazullori. Në vitin 1745 shkoi në Romë Abat Gasper Curri bashkë me Nikollë Kamsin shkodran. Abat Gjeçi, ardhë mbas tyne, që mbytë natën në gjumë nga një lypës të cilin e kishte ndihmue abati tue nxjerrë para nga arka e Shejtit.

Më 1787, përmendet Abat Pal Doda e mbas tij Abat Merqija.

Në vitin 1820 përmendet Abat Krosi, mbas tij, si Vikar i Abatit vjen Dom Pjeter Zarishti, i cili la shumë poezi shqipe, mandej, në vitin 1863, vjen Abat Gasper Krasniqi. Me këtë heshtë seria e abatëve deri me ardhjen në atë seli të Abat Prend Doçit, me 25 tetuer 1888. Me dekret të Kongregacionit Shejt të Propagandës dt. 23.X.1888, duel në vedi Abacia Nullius e Mirditës nën varësinë direkte të Selisë Shejte, me Abat mitrat Imzot Prend Doçin e i qenë shtue, posë famullisë së Oroshi e të Spaçit dhe Nderfandina, Kalivarja, Qafa e Malit, Blinishti, Fandi. Ma vonë me dekret dt. 30.IX.1890, nga dioqeza e Sapës u shkëputen Vigu, Mënela, Gomsiqja e Gojani, mandej me dekret dt.31.III.1894 iu shkëputen dioqezës së Lezhës e iu dhanë Mirditës, Kashnjeti, Korthpula, Shën Gjergji, Kaçinari, Frenga e Vigu. Në vitin 1905 iu dha edhe famullia e Grykës së Gjadrit që përpara shkonte me Sapë.

Në vitin 1894 famullia e Gomsiqes i qe dhanë për sherbim fetar etenvet françeskanë.

Në vitin 1898, simbas Re. Missiones Chatolicas, Albacia e Mirditës numëronte 1.000 besimtarë, mjesa në vitin 1874-1879, konsulli i Rusisë në Shkodër, Z. Jastrebov la shenimet si vijojnë:

Krahina Shtëpi Banorë  
Dibri 430 3.480  
Orosi 185 1.080  
Fandi 300 2.500  
Spaçi 415 3.450  
Kushneni 205 1.808  
Shuma 12.318

Por Abat Pal Doçi, e çon statistikën deri në 16.000 frymë.  
Mbas vdekjes së Imzot Pal Doçit, Papa Benedikti XV emnoi Imzot Zef Gjonalin nga Kashnjeti, Abat të Mirditës, në vitin 1921 e emnoi ipeshkëv dhe qe shugurue në Romë.  
Mbas tij e mori sundimin, tue qenë zgjedhë ipeshkëv i Mirditës, Imzot Frano Gjini, e pushkatuen në Shkodër me 14 mars 1948.  
Nga gushti i vitit 1951 Vikar i Përgjithshëm emnohet Imzot Lec Sahatçija me ndeje në Gëziq.

### **Vargu i ipeshkvijve të Arbënit**

#### *Viti Ipeshkvij*

1166 - Lazri, i cili mori pjesë në shugurimin e kishës së Kotorrit po në këtë vit.  
1199 - N.N.  
1255 - N.N.  
1295 - Mikeli.  
1304 - Martini, françeskan.  
1316 - Mikeli II.  
1350 - Lauri, rregulltar, shuguroi Iterin e Shën Gjergjit në Perast.  
1354 - Nikolla.  
1364 - N.N.  
1367 - Deda.  
1368 (rreth) - Andrea.  
1370 - Gjoni Lourlis, domenikan.  
1392 - Gjoni II.  
1392 - Gjoni III.  
1411 - Andrea II ipeshkëv i Dejës dhe i Sardës.  
1423 - Andrea III epirotas, ish-ipeshkëv i Lezhës.  
vit i pasigurtë-N.N. Vdiq më 1495.  
1494 - Ejlli Maçerata nga Italia.  
1506 - Gjoni de Corona nga Jadri, domenikan, shuguroi kishën e Shëna Ndout në Jader në vitin 1512. Vdiq më 1515.  
1518 - Jakobi spanjol nga Mali Albo i Katalonjes.  
1519 - Ludoviku de Vivaldis, nga Monteregeios Itali, domenikan.  
vit i pasigurtë Martini Lalusa.  
1554 - Deda Bigarrei i Urdhnit të Fretenvet të Spalati të Jeruzalemit.  
1578 - N.N.  
1610 - N.N.

1615 - Gjoni Klesi, françeskan.  
 Për sqarime, sa u rreshtue gjer tani, po çekim emnat e autorëvet që vlejné si shenime historike:  
 Estina Guil. Comment in Pauli, Epist.VIII, fq. 2, Tit.12.  
 Acta Apost. XX, 1-2, Rom. XV.19.  
 Cornely, Introdu Compend. fq.543.  
 M. Hagen.  
 Thalloszy, Illir. Alb.Forsch, I. 218, 70, 71, 121, 111, 122, 216, 116, 115, 263, 219, 220.  
 Elçija, vjeti 1908, fq. 178-179.  
 Cordignano, Albania, etj. fq. 239, 398, 237, 94, 95, 242, 244, 248, 336, 245, 223.  
 Mommsen VI.  
 Guarnerio: Le orig. fq. 87, 255, 72.  
 Pouqueville 1837.  
 "Hylli i Dritës", Viti 1914, fq. 218, 313, Viti 1943, fq. 193, viti 1932, fq. 410, 518, viti 1935, fq. 227, 69.  
 F.Noli, fq. 259.  
 M.Barleti, fq. 72.  
 Dr. Nd. Nikaj "Historia...", fq. 62, bot. 1917.  
 Karlo Pooten, dorëshkrimet.  
 "Dituria", viti 1939, fq. 85.  
 Flet. Klerit Katolik, viti 1931, fq. 8.  
 Konçili Shqiptar, Litt. Inst.  
 Miscellanea dioq. Sapës.  
 "Lajmëtari i Zemres Krishtit",viti 1935, fq. 227.  
 L. Hagues, 1897.  
 Dom Gasper Gurakuqi, "Dioqeza i Sapës".  
 "Missiones Cattolicae", viti 1888.  
 Weigand, Alb. Deutscher.

### **Shtojca I: Pjesëtarët që formuen të tre Konçilet e Shqipnisë**

- a. Pjesëtarët që firmuen në Konçilin e Parë të Shqipnisë mbajtun në Merqi në vjetin 1703 nën kryesinë e Shkelqesisë së Tij Imzot Vincenz Zmajeviq, arqipeshkëv i Tivarit. Imzot Vincenz Zmajeviq, arqipeshkëv i Tivarit, Primat i Serbisë, Vizitator Apostolik në Shqipni.  
 Imzot Pjeter Karagjiku, arqipeshkëv i emnuem i Shkupit.  
 Imzot Gjergj (Gjergj ...), Ipeshkëv i Zadrimës.  
 Imzot Nikollë Vladanji, ipeshkëv i Lezhës.  
 Imzot Ndue Babi, ipeshkëv i emnuem i Shkodrës.  
 Imzot Marin Gjini, ipeshkëv i zgjedhun i Pultit.  
 Atë Fra Egjidi de Arsentia, Prefekt Apostolik i Misioneve t'Arbënisë.  
 Atë Fra Frano Maria a Lycio, Prefekt Apostolik i Misioneve të Maqedonisë.  
 Atë Fra Martini nga Gjonima (Gjonmi), i pari i Provincës së Fretenvet de Observantia.
- b. Pjesëtarët që formuen me 1.XII.1871 në Konçilin II Shqiptar mbajtun në Kishen

Katedrale Metropolitane të Shkodrës nën kryesinë e Imzot Karlo Pooten.  
 Imzot Karlo Pooten, arqipeshkëv i Tivarit e i Shkodrës, Primat i Serbisë, Delegat Apostolik, Kryetar i Konçilit.  
 Imzot Fra Rafael D'Ambrosio, arqipeshkëv i Durrësit.  
 Imzot Fra Dario Bucciarelli, arqipeshkëv i Shkupit.  
 Imzot Fra Pjeter Saverini, ipeshkëv i Sapës.  
 Imzot Frano Malcinski, ipeshkëv i Lezhës.  
 Imzot Fra Albert Cracci, ipeshkëv i Pultit.  
 Imzot Gasper Krasniqi, Abat i Shën Llezhdrit.  
 Atë Fra Bonaventura nga Palma, Prefekt Apostolik i Misioneve të Maqedonisë.  
 Atë Fra Gjon Pjetri nga Bergamo, Prefekt Apostolik i Misioneve të Epirit.  
 Imzot Ejëll Radoja, famullitar i Shkodres, Sekretar i Konçilit.

c. Pjesëtarët që firmuen me 29.VI. 1895 në Konçilin III Shqiptar në Kishën Katedrale Metropolitane të Shkodrës, nën kryesinë e Imzot Pashko Guerinit.  
 Imzot Pashko Guerini, arqipeshkëv i Shkodres, Delegat Apostolik, Kryetar i Konçilit.  
 Imzot Pashko Trokshi, arqipeshkëv i Shkupit.  
 Imzot Prend Bjanki, arqipeshkëv i Durrësit.  
 Imzot Fra Nikollë Marsili, ipeshkëv titullar i Antigonjës.  
 Imzot Fra Nikollë Marceni, ipeshkëv i Pultit.  
 Imzot Fra Gabriel Nevrian, ipeshkëv i Sapës.  
 Imzot Prengë Doçi, abat i Shen Llezhdrit të Mirditës.  
 Imzot Nikollë Shtufi, komisar nderi i Shkelqësisë së Tij Papa Luani XIII, famullitar i Kallmetit, Prokurator i Ipeshkëvit të Lezhës.  
 Atë Fra Pjetri nga Senegali, Prefekt Apostolik i Misioneve të Pultit.  
 Atë Fra Luigji, Prefekt Apostolik i Misioneve të Kastratit.  
 Atë Fra Pjetri nga Virdeventri, Eproer i Misioneve të Serbisë.  
 Atë Fra Doda nga Bari, Epror i Misioneve të Maqedonisë.  
 Atë Fra Toma nga Rapino, komisar i përgjithshëm i Misioneve të Epirit.  
 Imzot Pashko Babi, Kapelan Nderi i Shkelqësisë së Tij Papa Luani XIII e famullitar i Jubanit.  
 Imzot Shtjefen Krasniqi, komision nderi i Shkelqësisë së Tij Papa Luani XIII.  
 Dom Nikollë Kaçorri, famullitar i Durrësit.  
 Dom Lazër Mjeda, famullitar i Planit.  
 Dom Jak Bushati, famullitar i Hajmelit.  
 Dom Dodë Koleci, famullitar i Mnelës.  
 Dom Nikollë Cijani, ndihmësfamullitar i Shkodrës, Sekretar i Konçilit.  
 Dom Ndue Mjeda, meshtar i arkidioqezat të Shkodrës Noter i Konçilit.  
 Meshtarë që në mbledhjen e përgjithshme të Klerit Katolik Shqiptar nën kryesinë e Imzot Benardin Shllakut me dt. 26.VI.1951 firmuen Statusin e Kishës Katolike të Shqipnisë.  
 Imzot Benardin Shllaku, ipeshkëv i Pultit.  
 Dom Pjeter Dema, Vikar i Përgjithshëm i Arkidioqezës së Durrësit.  
 Dom Gjon Kovaçi Vikar kapitullar i Dioqezës së Sapës.  
 Dom Lec Sahatçija Vikar Kapitullar i Abacisë së Mirditës.  
 Dom Ernest M.Çoba Zëvendës Vikar Kapitullar i Arkidioqezës së Shkodrës.  
 Atë Marjan Prela O.F.M.



Dom Gaspër Gurakuqi.  
Dom Pjeter Tusha.  
Dom Mëhill Çuni.  
Atë Ejëll Sapaj O.F.M.  
Atë Bonë Gjeçaj O.F.M.  
Atë Klement Miraj O.F.M.  
Dom Zef Glaznoviçi.  
Atë Leonard Shajakaj O.F.M.  
Atë Çiril Cani O.F.M.  
Atë Zef Saraçi S.J.  
Atë Pashko Prelaj O.F.M.  
Atë Palë Çurçija O.F.M.  
Dom Nikollë Dragusha.  
Dom Mati Fishta.  
Dom Pashko Zojzi.  
Dom Nikollë Shllaku.  
Dom Vlash Muçaj.  
Atë Rrok Gurashi O.F.M.  
Dom Mikel Koliqi.  
Dom Luigj Gashi.  
Atë Antonin Fishta O.F.M.  
Dom Nikollë Bushati.  
Dom Ast Koka.  
Atë Pjeter Tuci S.J.  
Dom Lazer Dedi.  
Atë Rrok Vataj O.F.M.  
Atë Silvester Hila O.F.M.  
Dom Lazer Blushaj O.F.M.  
Atë Florian Berisha S.J.  
Atë Mark Papaj O.F.M.  
Atë Mëhill Troshani S.J.  
Dom Nikoll Luli.  
Atë David Pici O.F.M.  
Dom Ndoc Sahatçija.  
Atë Leon Kabashi O.F.M.  
Dom Pal Gjini.  
Atë Filip Mazrreku O.F.M.  
Dom Kolë Skoda.  
Dom Jak Gazulli.  
Atë Sebastjan Dedaj O.F.M.  
Dom Zef Oroshi.  
Dom Frano Illija.  
Atë Robert Ashta O.F.M.  
Atë Alfons Çuni O.F.M.  
Dom Jak Zekaj.  
Dom Ndoc Ndoja.

Dom Mark Dushi.  
Dom Anton Doçi.  
Atë Konstandin Pistulli O.F.M.  
Dom Zef Bici.  
Dom Luigj Kolaj.  
Dom Ndre Krroqi.  
Dom Prekë Nikçi.  
Atë David Pepa O.F.M.  
Dom Prekë Qafalilaj.

## **Shtojca II: Kishët e vjetra rreth Shkodre**

### *Kisha e Shën Mërisë Magdalenë tej Bunës*

Tej Bunës asht një kishë e vogël e Shën Mërisë Magdalenë, me gungë e me lterin gurit. Ka pasë një trupore druni punue artistikisht e me mjeshtri, Shën Mërija ndër gjunj me flokë të shprishun, me Krishtin në Kryq në dorë e një rrashtë. Ka pasë hajat para e një lter gurit me një kambë shkallë që u celebronte mesha tri ditë para festës e ditën e festës. Mbrenda ka një rrasë mermerit shkruie shqip e latinisht ku asht vorrue arqipeshkëvi i Tivarit e i Shkodrës tash 130 e sa vjet, kah e shifshe si mbrendë e ashtu edhe jashtë nën hajat dhe do vorre tjera.

Deri vonë kanë qenë pa themelet e qelës së hershme e rrethueme me murë të thatë.

Trimat, djelmtë kur delshin në Pazar, të gjithë bajshin kryq në krye të Pazarit.

Traditë para festës ishte se u celebronte një meshë natën e Shën Mërisë. Ndjesën e çilte famullitari i Shirokës, ditën e festës që prej orës 5 deri në orën 8 që u çelte mesha e madhe, që këndohej me armonium e kangëtarët e katedralës. Në kohën e Imzot Serreqit delte edhe daulla. Krejtë Pazari mbante festë dhe nuk çilte.

Mbas meshet daullaxhive e kangëtarëve u qitshin bastan dhe rrijshin aty deri vonë. Tue u ngjitë prej Pazarit binte daulla rrugës.

Kohën e Luftës Ballkanike kje prishë hajati i kishës dhe kisha. Prap në kohën e Imzot Pjetër Gjurës kje goditë hajati prej Zotni Lazër Pistullit. Hajati ka qenë deri tash vonë, porse kur ikën grekët prej Greqie kjenë qitë në kishë për banim të cilët prishën hajatin e dyert; çilne vorrin e Arqipeshkëvit të Tivarit. Kishte mbetë pa hajat e dyer që janë të nevojshme për një kishë.

Truporja e Shën Mërisë e cila u gjend në Sakristi nalt kje prishë e coptue e humbë edhe kjo trupore e moçme që shoqja e saj nuk di a ka me u vu në vend ndonjë herë.

### *Kisha e Shënandout tej Bune*

Familja e Tish Curanit (Vëlla me Njac e Luigj Curanin në rrugicën e Shirokaj, lagja e Serreqit) ka një dokument shkruie turqisht që iu çue Selim Efendisë, banues në Perash, e ish-nëpunës i Tapijajve, e pat mirësinë e na e përkthei shqip. Dokumenti, pra, thotë se Kadija e Valija (Pasha) i Shkodrës vjeten 1835 mbas Krishtit (ase vjetin 1254 t'Egjirës), i dha Mark Curanit, stërgjyshit të Curanëve që u përmendën ma nalt, lejen me e meremetue kishen e Shënandout e me mujtë me u ba funksionet fetare në te. Për këtë Valija e Kadija çuen përpara, për me pa kishën Hysen Efendinë me një tjetër. Kështu dokumenti që ruen edhe sot me kujdes të madh familja e Tish Curanit.

Po si kje puna që e pat këte leje Mark Curani?

Gojëdhana e familjarëve të Curanëve, prej të cilëve e ndjeva dje me veshët e mi thotë Pader Mark Harapi e kallëzon punën kështu: "Marku kishte një tregtore në treg në pazar të Shkodrës, ku rrajshin gjindja, jo veç me blé, por shumë e shumë herë edhe me lypë lëmoshë. Ndër të mbramët ishte edhe një ushtar turk, e Marku e niste gjithmonë të kënaqun tue i falë çka lypte, deri kafe e sheqer.

Shkojnë do vjet e ky ushtar kthen prej Stambolle i emnuem Pashë i Shkodrës. Një ditë, pa pritë pa kujtue, çon e thrrret Markun në kala. Me u thirrë në kala asokohe donte me thanë me iu shkurtue kryet. Kush e muer vesh këtë fjalë, u tmerrue. Se me çfarë frike u ngjit Marku përpjetë, ia merr mendja gjithkujt.

Pasha e pret me krahë hapët e i thotë: "Ti s'po më njef, por unë po të njof mirë e ndernat që më ke ba, kur ishe ushtar në Shkodër, nuk i kam harrue e sot due me t' i shpërblye. Lyp çka të dësh, e kam për ta ba. Marku i lypë lejen me ndreqë Kishën e Shënandout në Breg të Bunës e me mujtë e me çue meshë në te.

Pasha ia dha këtë leje me shkresë që shtëpia jonë ka ruejtë dhe e ruen si një visar.

Kisha e Shnandout tej Bunës: Kisha siç shifet sot ka qenë e rrethueme me avulli deri në Breg të Buenës. I kje marrë një copë oborrit, kur kje goditë rruga e Shirokës. Derën e oborrit e ka pasë kah Shiroka.

Kisha përmbrenda ishte e bukur, e tavanueme si shtëpiat e moçme. Mbrendë kishte çardak, shtrua me rrasa malit. Ashtu edhe mensa (Iteri) goditë prej gurit, gradinit me gurë të lëmuet, në lter kishte një kryq i madh; në anën e djathtë truporja e Shën Françeskut, që sot asht në katedrale; në krah të majtë truporja e Shënandout, që sot asht nalt në Sakristi kah Vasijejt. Lteri anash për mur ka qenë i zbukuruem me ornati gelqerejt e lule siç kanë qenë goviçat e shtëpiave pasanike, ka pasë belustrën me parmakë druni.

Me 1 gusht u çilte ndjesa, populli rrante si prej qytetit, ashtu prej Pazarit e Shiroket. Me 2 gusht katolikët nuk çilshin dugajët në pazar deri mbas meshës së madhe.

Kjo kishë ka qenë e moçme dhe tapinë (tarnakri pojenini) e ka familja e Ejëll Gjon Curanit.

Në luftën Ballkanike kje prishë prej malazezvet, me pretekst se Turqija kishte shti mbrendë municion, prishë hatullat, tavanin djegë e thye Krishtin në Kryq, pre hundët Shën Françeskut. Imzot Jak Serreqi, Arqipeshkëv i Shkodrës, në shej proteste i pat vu afër deres së zyrës së vet, që t' i shifshin gjithkush që shkonte nalt në arqipeshkvi.

Me 1 gusht shumë shkodranë, shirokas e katundarë merrshin bukën me vedi e flejshin në kishë nalt në çardak. Me 17 kallnuer u çilte kisha e u thonte mesha e predku e kungimi.

Ma vonë Dom Zef Puka pati pikëzue fuguren e Shëna Ndout Abat që sot gjindet në Katedrale. Por atë ditë, në krah të majtë të kishës u stoliste lteri me fuguren e Shënandout abat, ku u celebrue mesha prej priftentve të Shkodres.

Mbasi festa e këtij shejti bie në dimen, Imzot Jak Serreqi që asokohe ishte famullitar, blente një kalë qymyr dhe e ndezte para lterit dhe e bante një zjarr të madh, që të mos kishin ftohtë, si meshtari, ashtu edhe populli.

Shumë prej shehrit e Pazarit, prej Shiroke merrshin pjesë ndër funksione të kësaj kishë. Kisha e Shëna Prendës në Zus.

Sukën e Shlavrendit thonë se ka qenë një kishë. Kisha e Shëna Prendës asht e vogël dhe deren e të hymit e ka kah Taraboshi, gungen kah Buna. Në gungë ka lterin gurit brenda gungës.

Kjo kishë deri tash vonë ka qenë pa mbuloje. Në kohën e Imzot Pjetër Gjurës më 1921

kje mbulue një kishë prej Z. Kolë Palit dhe po atë vjetë kjenë ndezë kandila me xhama. Por mjerisht tash vonë ra brendë e mbeti e zbulueme.

Kjo kishë ishte kisha famullitare e Oblikës. Banorët, thuhet se ditën e Pashkëve u bënë myslimanë, pse prifti nuk i kishte pritë dhe kishte fillue meshën pa u mbledhë populli. Ka ma tepër se 60-vjet që myslimanët afër kësaj kishe ndertuen një xhami.

Gojëdhanat serbe thonë se Shën Gjoni i Elbasanit prej Zetet tue ikë, hyni në këtë kishë për të ba një Tedeum, porse tue dalë prej kishe, mbasi dera ishte e vogël iu desh me qitë para kryet, pse ishte i gjatë, por anmiqtë ia prenë kryet, dhe ky me krye në dorë iku deri në Elbasan ku aty mbet e kje vorrue.

#### *Kisha e Rrashit në Shtoj.*

Rranzë malit Maranaj, bri rrugës që ulet prej Rrjollit në Fushën e Shtojit, gjinden rrenojat e njasaj kishe të kuvendit e të mungades benediktinësh që dokumentat e vjetër e gojëdhana e popullit diftojnë se ishte shugurue Shejti Shën Gjon Pagëzuesi. Kumbonarja asht e madhe, e punueme me gur të latuem, një copë e së cilës edhe sot qëndron e paprishun. Tagrin e pronësisë përmbi ato rrëtime e kanë pasë gjithëmonë katolikët. Porse prej vitit 1865 nisën do kundërshtime prej anës së ortodoksve, të cilët u munduen me ba për vedi atë vend. Çashtja kje rrahë në Stambollë e së parit i kje njoftë e drejta e katolikëve, por në vitin 1869 prej ngatërresave prej një Valisë erdhi urdhni që u rrethue mos të mujshin ma as katolikët e as ortodoksët të kremtën e Shën Gjonit me vojtë e me thanë ndër ato rrëtime.

Shkëlqësia e Tij Imzot Lazër Mjeda Arqipeshkëv i Shkodres, e muer vesh punën e u ankue pranë qeverisë shqiptare edhe kërkoi që t'i dorëzohej katolikëve si vend, në mbështetje të dokumentave që i parashtrioi. Dy dokumentat e para janë nxjerrë nga "Acta et diplom. vëll. II nr. 119 fq. 30, nr. 320 fq. 77. I pari vj. 1356 e tjetri vj. 1376.

Prej këtyne dy dokumentave shifet çiltas mungadja e Kishës së Shë Gjonit; Pagëzuesit, në Shtoj larg prej Ballezës nja 5mil. e nën Ipeshkëvinë e Drishtit, asht e urdhnit të benediktinëvet katolik romak. I treti asht nxjerrë nga "Illirisch Albanische Forschungen", fq.270.

Aty lexojmë: "Në fushën e Shtojit e Shilalco rranxë malit Maranaj (në shek. XV Marimas, Marinay) në dioqezan e Drishtit, pesë milje larg prej shumë të resë, Kishës ipeshkvnore të Bazelit, gjinden katundi i Shën Gjonit me një kumbonare fort të naltë e punueme me gurë kater anëshe. Drishtjanët e mbajshin kuvendin si të qytetit të tyne, e mbas një vendimi të kjartë të shek. XV abati do të ishte vetëm një drishtjanë. Në luftën kundër Ballshës III mbajshin anën e Venedikut e hoqne shumë keq për shkak të kësaj Republike. Kuvendi kje pajisë bujarisht prej venedikasve, ndër të tjera të fala pata edhe katundin (Vila Veronika) vjetin 1445". Një tjetër asht i vjetit 1745 e ruhet në arkivin e Arqipeshkëvisë së Shkodres. Asht i nxjerrun nga vizita e Dioqezës së Shkodrës të bamun nga Imzot Pal Kamsi në vjetin 1745.

Tue folë për famullinë e Rrjollit nder të tjera thotë: "...Kjo famulli përfshinë edhe Gruden e Vogël e Rrashën, të dy kufitare e larg prej Shkodre nja dy orë. Në këto dy vende gjinden të krishtenë të fshehtë (laramanë). Rrjollit numëron 53 shtëpi katolike që bahen 420 shpirtën. Rrashi 10 shtëpi të krishtena të fshehta, e 62 shtëpi. Gruda 6 shtëpi të krishtena të fshehta 38 shpirtën. E kanë kishën abatore nën titullin e Shejtit Gjon Pagëzuesi, ndertesë shumë madhështore e thuheshe se ka qenë e etenvet benediktinë. Tokët e këtij kuvendi janë të zaptueme prej otomanëvet. Afër gjindet një pus shumë i

kthjellët. Kisha e mungadja janë rrenue prej motit..." (Nga Fletorja Klerit Katolik, viti 1931).

### *Ish-kisha e Shirokës*

Kisha e moçme e Shirokës derën ase faqaten e kishte kah Zogaj ase nga Burgu, gungën kah Zarufa. Kah oborri ose faqata e kishës së soçme kishte një hajat me parmakë, nga faqata një qoshk nja një meter mandej se hajati, ku ditën e Shëna Rrokut u stoliste me pelhurë. Për mur ishte lteri që u vendoste truporja e Sh' Rrokut, që sot gjindet në Katedrale të Shkodrës ble prej Imzot Pjeter Gjurës. Në hajat kishte edhe një derë të vogël për me hi në kishë, dhe ngjitë me hajat ishte sakristia. Kjo e kishte derën e të himit nga qela, ku meshtarit i duhej me hypë katër a pesë kambë shkallë me dalë në Presbiter.

Kisha përmbrenda. Thamë se faqaten e kishte nga Burgu, mbi derë kompanjelin me një kumbonë po njajto që sot njifet ma e madhja në kompanjelin e ri.

Kisha përmbrenda kishte presbiterin. Lteri ishte me gungë dhe prej guri. Gunga kishte një dritare të vogël. Shkallët për me hypë në lter ishin prej guri të latuem në trajtë mezolune; ishin katër a pesë kambë. Në lter ishte Tabernakulli, mbi te Troni. Në krah të djathtë ishte një trupore Zoje me Krishtin fëmijë. Në anë të majtë kishte truporen e Sh' Rrokut që sot vihet në mjedis të kishës për festën e Sh' Rrokut, po ne e majtë kishte një qemer që vijonte për me u ulë në sakristi.

Ngjitë me parmakë të presbiterit kishte një nikje në të cilën ishte vendosë truporja e madhe e Shën Kollit, pru prej familjes Koka, e cila kje prishë.

Gjysma e kishes ishte e shtrueme me çardak. Në fund të saj ishte shkalla me u ngjitë në çardak. Kishte 6 penxhere (dritare) të vogla pa farë stili. Në çardak hypshin vajzat e fejueme a të mëdha që vijshin me pa meshë; gratë dhe trimat nuk mund të hypshin.

Truporja e Zojës ishte drunit, tash a asht, nuk dihet.

Natën e Sh' Rrokut u godit lteri i Sh' Rrokut dhe u çil ndjesa, tue thanë Rruzaren, Predke e Litanitë, Tantum Ergo e Bekimi me të Shejtnueshmin Sakramend. Gjithashtu ditën e Shëna Rrokut në kumbonë të parë e deri në meshë të madhe, u thojshin meshët pa da.

Hajati që permendëm u mbushte plot me murgesha shtëpiake, me gra e fëmijë shkodranë etj., që shkojshin me fitue ndjesë tue marrë dhe ushqimin me vedi, si dhe shtroje për një natë dhe mjesditë.

Famullitari, pesë kandilave me xhama, u epte edhe qira tjerë për me i ndezë murgeshat që rrijshin deri në mjesnatë tue thanë uratë. Murgeshat ishin p.sh. Tone Radoja, Drandja e Prengë Isufit (halla jeme), Kusha Miruku (halla e Ndoc Mirukut) me të tjera.

Përveç uratëve këndojsin edhe kangët e Sh'na Rrokut, të Shën Kollit e të Zemres së krishtit.

Para hajatit ishin disa gurë të mëdhaj të biruem për të vendosë flamurët e Sh' Rrokut, Zemrës së Krishtit e të Zojës Nunciatë (Kongregacionit).

Para meshës së madhe, si sot u bante proçesioni, tue fillue fëmija e Shirokës të veshun me brakesha, çorapë të gjatë e këpucë të kuqe, për proçesion veshëshin qafaten e kuqe tue i pri flamurit me një shtizë.

Ma vonë kje prishë kjo kishë e mbas hartimit të Inxh. Kolë Idromenos, i thirrun edhe Kolë Arseni, kje krye si godinë në vjetin 1906 kisha e soçme. Kjo kishë u ndertue nën kujdesin e famullitarit të Shirokës Dom Gjon Bushatit, dhe kështu nuk u mblodh ma kush me fjetë natën e Shëna Rrokut, sikurse ma përpara.

Per volere potere, kje çue famullitar i nderti Z.Dom Pashko Zojzi i cili tue pamë se

kumbona kishte mbetë vendosun në pemë, ia hini me lypë tek Z. Lazer Pistulli etj., tue porositë shirokasit me bajtë ranë, ujë, gurë e gelqere, të cilat me gjithë qejf iu gjenden zanit të tij. Qiti punëtorët dhe ndertoi kumbonaren. Pruni edhe dy kumbonë e sahatin e shoqja e Ndre të Minit e kështu u rregullue edhe kumbonarja e Shirokës me tri kumbonë e sahat.

Kudo që ka vu kambën Dom Pashko Zojzi, ka goditë kishë, lterë e kumbonare si dhe banka, ashtu dhe i vëllai i tij Dom Luigj Zojzi. Volere potere, po të duen, mund të bajnë edhe të tjerët, siç ka ba Imzot Nikollë Tusha, Imzot Zef Skana, Dom Prend Brunga, Dom Ndre Simoni, etj.

Kështu edhe sot veprojnë. Me gjithëse të vorfen, po përmirësojnë kishët e tynë shumë famullitarë të zellshëm.

### *Qela e vjeter e Shkodrës*

Kjo ka qënë në rrugicën e Rrakacojve: shtëpi e moçme me kater oda nelt, me dy akshihane poshtë. Dera e oborrit shifet edhe sot me qemer. Ngjitë me qelë ka qënë kapela, një odë e gjatë kund nja 8 ose 10 metra dhe e gjanë nja 4 metra. Ka pasë një sakristi pa kurrfarë stili. Lteri po njaj që ka qënë me qelë të re, punue prej Kolë Idromenos. Anash kanë qënë dy lterë e mbi ta ishin eshtnat e dhjetë virgjinave shoqe të Shën Ursules, dhe mbi te një trupore e Shën Kollit 50 cm me material druni. Në anën e majtë një trupore e Shën Sebastianit, ishte në madhësinë e asaj të Shën Kollit. Kah e djathta ishte lteri i konakut shejt prej drunit si dhe arka me relike që sot asht te lteri i Shën Lorencit. Në krah të majtë kishte lterin e Zojës së Dhimbëshme drunit punue prej Balto Shirokës. Poshtë trupi i Shën Prosperit i venduem në arkën xhamit me një krye të madh e trupin e vogël, i veshun me pantallona e xhakëtë kadifeje, vazë agostareje me gjak të tij mbrendë.

Ky shejt u çilte e u nderonte ditën e Sh'Njonit me 24.VI, por fëmijëve u qitte hatanë se kishte trup të vogël e krye të madh.

### *Servitet në Shkodër.*

Me 28 qershor 1897 natën e Shën Pjetrit e Shën Palit u çil Kuvendi i motrave Servite, për do kohë Insituti, simbas dishirit të flakët të Imzot Pashko Guerinit, arqipeshkvit të Shkodres, mbante vetëm disa fëmijë të braktisun e jetima për me i shpështue mos të bijshin nder duer të të pafeve. Prep me ndihmen e këshillit të Imzot P.Guerinit, me tetuer 1897 u çil streha foshnjore, me gëzim të fëmijëve katolikë të qytetit.

### **Shtojca III: Si ka qënë Kisha Katedrale e oborri i saj**

Oborri ka qënë i rrethuem me avulli. Ka pasë tri dyer; një në ballë të kishës me pullaz, një kah rruga Geraj e një kah asht edhe sot. Ka pasë katër puse dhe sot ka vetëm një, atje ku lehet vetura. Në një shtëpi të ultë ka ndenjë një familje e cila ka pasë pusin para. Një pus tjetër ka qënë para derës së Kishës, p.sh. Pallati i Arqipeshkëvisë e sot shifet një gur i rrumbullakët.

Ngjitë me derë të oborrit, përballë kishës, ka qënë një jerevi e madhe e naltë nja gjashtë metra. Derën e të himit e ka pasë kah arqipeshkëvia, kishte mbrendë furrën me të cilën lejshin drutë e qymyrin, gjithashtu bajshin edhe kazanat.

Përballë pallatit arqipeshkvner ishte një shtëpi e naltë, që u përbante prej katër dhomash, d.m.th.një odë e madhe karshi arqipeshkvisë e cila në kohën e Imzot Jak Serreqit, atëherë famullitar ishte oda e kangtorisë, e dy të tjerat për sakristanat. Afër derës së shtëpisë ishte pusi. Ngjithë me këtë shtëpi ishte hani, u thirrte i Shan Dedës.

Me 1908 kje ngritë ndertesa që ma vonë u ba salla e teatrit. Kjo godinë ka qënë një odë me dy dritare e deren e stolisun mirë; pjesa tjetër e pastolisun, sa xhama, sa dyer. Këtu u mblidhte komisioni ose paria, sa herë u nevojiteshin për punë qeveritare, për me dhanë ushtarë e tjerë.

Me iniciativën e Imzot Serreqit kje krijue Daulla e Kishës; prej këtij kje goditë një çardak me parmakë hekuri e vinte karshi arqipeshkvisë, ku delshin e i bijshin daulles. Dilshin për çdo dielle e festa mbas bekimit për t'i ra daulles, në këtë rast u mblidhte populli i madh për të ndigjue. Pleqtë rrijshin kambëkryq tue bisedue dhe masa e re tue shetitë.

Kisha përmbrenda ishte pa tavan, por me trena të latuem e të zbukuruem, ashtu edhe presbiteri, përveç se gunga me kupël ishte e mistrueme. Lteri i madh ka qënë ashtu siç ka qënë deri tash vonë. Në gungë ka qënë fugurja e Zojës së Këshillit të Mirë e vogël në mur, të cilën e rrethojshin do engjëj të pikëzue edhe këta në mur. Mbi qemer, në ballë të kishës, ka qënë një kryq që sot gjindet nder vorreza në kapelë. Kisha ishte e bojatisun, oda e shtrueme me dërrasa.

Në atë kohë Katedralja lulëzonte fort, pse populli që merrte pjesë në meshë e funksione, ishte i madh, sepse ai që nuk shkante në meshë të madhe, nuk kryente borxh.

Kongregacioni ose kompanjtë e Zojës Rruzare ishin të detyruem me marrë pjesë në meshën famullitare, pra pleq e të rij, plaka e gra e nuse u mbushte kisha si nadjë, ashtu edhe mbasdite. Mesha e vajzavet ishte mesha e parë. Në këtë meshë shkojshin vajzat e fejueme e me çarçafë ase boçen në krye. Edhe mbasdite nuk rrinte kush pa marrë pjesë në bekim.

Ku sot asht dera e sakristisë, ishte arka e Kartofagut, mbi të ishte një poltron, ku famullitari mbas pjesës së Rruzares hypte e në poltron rrinte bante katekizëm.

Sakristanë ishin dy katundarë të pamartuem, Toni e Leka, të veshun me veladona me flokë zylyfë. Këta i mbante famullitari; shërbyen deri sa vdiqen. Mbas tyne vijnë Dedë Baltoja e Gjon Bombardoni. Mbas tyne vijnë përsëri Kolë e Nush Mazi.

Lulëzimi ma i madh ishte se Katedralja kishte në gjinin e vet 18 kompani (shoqni); të Korpit të Krishtit, Zojës së Shkodrës, Shejtnueshmes Trini, Shën Krygjës, të Shelbuemit, Shpirtit Shejt, të Ngjallunit të Krishtit, Shën Shtjefnit, Sh'Pjetrit e Sh'Palit, Sh'Filipit e Sh'Jakobit, Shën Kollit, Sh'Jozefit, Sh'Markut, Sh'Mërisë Magdalenë, Sh'Lorencit, Sh'Mëhillit, Sh'Njonit. Këto shoqni kishin (çaushat) kujdestarët e paguem, me qitë jashtë e me shti mbrendë flamurtarët, ku secili kishte raftin e vet me qira, fugure e me lule. Dy shoqinat e Korpit të Krishtit e e Zojës së Shkodres kishin qirat tri okësh të trashë me simbolin e shoqnisë dhe gjashtë copë qira ka pesë okësh me simbolin e Korpit të Krishtit e të Zojës së Shkodrës, kishin edhe rreliket e veta.

Diten e Korpit të Krishtit, posë 12 pleqve të Shoqnisë, merrshin pjesë në proçesion trima edhe gra, ashtu edhe malsorë e katundarë. Gjithashtu edhe nder festat e Zojës, si: Të Këshillit të Mirë në prill, si dhe në atë të tetorit (Zojës së Shkodrës). Proçesioni bahej rreth oborrit të kishës kështu merrshin pjesë edhe 16 shoqnitë tjera me 6 pleq të çdo shoqnie. Shkolla Stigmatine, françeskane, shoqnia e Zojës Rruzare, kongregacioni i Zojës Nunciatë, i Treti Urdhen merrshin pjesë në këto proçesione.

Kur ishte dita e Shën Shtjefnit, ndërsa arqipeshkëvi u ulte në fron te lteri i Sh'Jozefit me

kotë e stolë, delte një ndihmëtar i famullisë e u fillojshin litanitë. Fillonte procesioni tue i pri kryetari e flamuri i shoqnisë e gjithë pjestarët e saj mbas me qira të ndezun dhe në fund me rrelike në dorë, mbrenda kishet. Kështu për Rrëshaj, Sh'Pjeter etj., etj.

Kasa (lëmosha) u mblidhej pjestarëve të shoqnisë nder festa si edhe nder të dielle. Kur arqipeshkëvi celebronte Meshën Pontifikale, si: per Pashkë, Korp të Krishtit, Zojës së Shkodrës e Këshillit të Mirë, Sh'Pjetrit, Shejtnueshmes Trini, Sh'Jozefit, Shoqnia Servite, epte 1 napolon për meshë ne e dielle e festë atij që celebronte Meshën e Madhe.

Kompanitë paguejshin gradis 23 dhe të tjerat i merrnin shoqnitë herë njena, herë tjetra. Mbas vitit 1900 Franz Jozefi me inisiativën e Imzot P.Gjenovicit çoi për ta goditë Katedralën ku kje zbulue e çue muret mbi qemer dy meter, vu trenë hekurit dhe mbulue me zinko, që përpara ishte mbulue me tjegulla. Në fund të kishës ku sot asht lteri i Zojës së hirshme fabrikojshin tulla prej gjesos tue i vu masur mbrendë e mbandej bajshin betonin më se një meter. Me ta kje tavanisë kisha dhe presbiteri. Nder shtyllat ishin të pikturueme 12 apostujt, tavanin me zemren e Krishtit e figura tjera, gunga me ejë, etj.

Imzot Jak Serreqi figurën e madhe të Zojës së Këshillit të Mirë që kje vendosë në gungë pat ba dy braçaleta në kurriz për nga tre çira të një fabrike italiane të cilat i pati ngulë në gungë andej këtej fugurës së Zojës, pat pru fugurën e Korpit Shejt, truporen e Zembrës së Krishtit. Kje përmirësue trupi i Shën Prospit. Ka bamë pjanete, dalmastika, teniçele, pijala e vela të qendisun nder Stigmatine, etj.

Me 1905 ra termeti dhe prishi mbi lter të Shën Lorencit tavanin e pullazin. Ra edhe tavani që ishte i punuem me tulla gjesoje, gjithashtu u prishën edhe pikturat.

Në Shkodër ishte ndihmës arqipeshkëv Imzot Lazer Mjeda. Po në këtë vjet, ditën e Sh'Lodovikut u pagëzuen tri kumbonët e fretenvet. Kje emnue Ipeshkëv i Zadrimës Imzot Jak Serreqi. Famullitar në Shkodër ishte Dom Gjon Bushati.

Në këtë kohë me inisiativen e Kolë Idromenos u godit tavani i kishës Katedrale që asht sot. Në kupë të lterit të Madh u pikëzue të Ikunit e Zojës së Këshillit të Mirë. Kisha kje e pajisun me momente të bukura e të mira. Imzot Lazër Mjeda, ndihmës Ipeshkëv i Shkodrës, me të holla të veta bani një vepër shumë të madhe, sepse mbas gungës e ka kah oborri kah Vasijet, u mbledhshin pijanecat, ku edhe lojshin kumbar. Pra, çarti jerevinë, avullinë, hanin dhe gjithë dugajët ku rrinte Shan Deda, rrënoi shtëpinë e daullës, dhe goditi deren me hekur dhe avullinë me parmakë të hekurt. Mbylli siç asht sot pjesën që lidhë qoshën e kishës me arqipeshkëvi, edhe këto me parmakë hekurash. Ndreqi rreshtin e dugajëve ku ndertoi dhe një dhomë për kangëtarët, kurse daullën e çoi në shtëpi të kishës në rrugën Dardinj.

Në këtë rast gjetën rasën Shuk Serreqi me Kolë Shkrelin e Ndrekë Kiçin e kompania tue mbledhë prej popullit, një ditë të dielle, tue pretendue se Imzot Mjeda don me zaptue oborrin e kishës e kështu populli me qyskija e ternagopë shkuen me rrafshue arkun e të tjerat. Por Imzot P.Guerini lajmëroi Valinë i cili dergoi ushtarë e largoi popullin pa ba kurrnjë dam. Në këtë kohë Imzot Lazër Mjeda kje emnue arqipeshkëv i Shkupit.

Në vitin 1910 Imzot P. Guerini dha dorëheqjen e në vend të tij kje gradue Imzot Jak Serreqi Arqipeshkëv i Shkodrës. Imzot Gjon Bushati ishte famullitar i Shkodrës.

Në tetuer 1912 plasi lufta Ballkanike, ku Shkodra mbet e rrethueme. Serbia e Mali i Zi nisën me gjuajtë me topa, e populli me shpresë se kishën nuk do ta gjuente, u qasne ne Katedrale pa droje. Por kisha kje gjuajtë siç diftojnë gjylet e nguluna në mur, fugurja e të Shejtnueshmes Trini kje ba me bira prej shkrapnelit. Një gjyle i ra kompanjelit, por nuk mujti me u shprazë. Kështu kjo gjyle ra në sakristi, ku morën zjarr teshat që populli



kishte, edhe dyshekët. Morën zjarr rata e shugurueme, teshat e mira, Kelshejtët, Ostensorët e s'mbet gja pa u djegë, ashtu edhe çardaku i sakristisë. Zjarmi hini në kompanjel tue e prishë shkallët drunit sahatin, u dogjen trenët që mbajnë kumbonën e madhe e cila ra poshtë dhe u thye.

Imzot Gjon Bushati, pruni paramente, pjanetë e dalmatikat e bardha, të kuqe, jeshile, vjollca e të zeza, ashtu dhe ato të qendisunat që ia çoi Viktor Emanueli. Kështu për t'i ba dritë natën kishës për ata që flejshin kjenë përdorë qirat, e kompanjive. Këta qira kjenë përdorë edhe me shti të vdekunit në dhé. Kur krisi Lufta e Parë Botnore kje hjekë Imzot Gjon Bushati dhe vendin e tij e xuni Imzot Pjeter Gjura. Kur ishte kisha pa tavan, predikatorja ka qenë kah trimat ku asht tash truporja e Sh'Terezinës. Kur u pikturue kisha nga Inxh. artistik, kje hjekë e vu ku asht kenë truporja e Sh'Shtjefnit.

Monsinjor P.Gjuraj e ka shtrua kishën e sakristinë me rrasa, mbasi ma perpara ishte e shtrua me dërrasa. Bankat e kishës i ka punue Mati Daberdaku. Me 1923 Imzot P.Gjura pruni me ndihmen e popullit pesë kumbonët të cilat u pagëzuen ditën e Sh'Jozefit, me 19.III.1923 prej Imzot Lazer Mjedës. Të shtunden e Madhe po të këtij viti edhe kumbonët kjenë vu nën drejtimin e inxh. Kolë Idromenos. Në këtë ditë ranë për të parën herë.

Me iniciativën e Imzot P.Gjurës e Lazer Pistullit, në meshë të madhe delshin nder banka në presbiter të ndamë në dy pjesë ku këndoishin, si nder katunde. Nder festa u këndonte me harmonium drejtue prej Dom Zef Pukës. Ndër ditët e mëdha, në kohën e Imzot P.Gjurës për Pashkë e Këshndella, Zojës së Këshillit të Mirë e Zojës së Shkodrës, Korpit të Krishtit mesha u këndonte me daullë nën drejtimin e Z.Frano Ndojës. Në këtë kohë me iniciativën e Imzot Jak Serreqit kjenë bashkue dy kangëtoritë e Katedrales dhe ajo e Kongregacionit. Lec Gjushi kishte një za tenori, kurse Ndoc Celi një za basi, e të fortë. Të dy këta kjenë çue në bazë dhe patën këndue në Kishën e Shën Pjetrit ku lanë nam të madh.

Ma të paren daullë e prunë P.Thoz Kori O.F.M. ku pat pru edhe një profesor italian... Luigji. Prej kësaj daulle ka dalë mjeshtri Palok Kurti e ma vonë u krijuen daulla e Jezuitëve e prej nga doli mjeshtri Frano Ndoja, i cili pat dirigjue daullen e Katedrales.

#### **Shtojcë IV: Kremtimet e ndryshme në Shkodër**

a. 50-vjetori i Zojës së Paperlyeme.

Me 1906 kje festue 50-vjetori i Zojës së Papërlyeme me iniciativën e Imzot Jak Serreqit, aso festash nuk luten ma. Pat porositë Kolë Idromenon me pikturue në karton Zojën e rrethueme prej ejëve, ku mbërrinte deri në korniqe të kishës dhe një arkë bojë qielli e të bardhë vu në arkën mbi lter goditë prej Kolë Idromenos. Kje porositë populli që me 7.XI. të zbukurojshin rrugët, dritaret e dyert me fuguret e Zojës, blerime e drita. Vetimë populli iu përgjegj e s'mbet shtëpi, derë, mur pa u zbukurue. Derën që kje ba me blerim e drita kandilash, në krye të rrugicës së murgeshavet, shtëpia e Koliqve goditën me Gjokë Picin një arkë me gjysmë binarësh një meter nalt, kah vunë Zojën pa mëkat mbushë me kanella, ashtu edhe në rrugën e Gurakuqve me iniciativën e Pjerin Simonit e vëllazen, ashtu Darragjatejt te rruga e Gurakuqve.

Myslimanët u kercenuen që ta zhdukshin atë godi, por rusianët iu përgjegjën: "Pa ba dekën, s'kishte djalë që ta prishte. Në këtë vend patën ndezë kandila e disa teneqe me hi e vajguri. Kjo lloj flake kje pa nder shumë mahallë.

Oborri i kishës kishte shumë gota me voj të ndezun si me kenë ba tavan. Arqipeshkvia, balli i kishës a kumbonarja ishte me kandila e teneqe me hi e vajgurit nder të katër anët. Mbas funksionit filloi ndriçimi, daulla binte në oborr. Lagjet katolike ishin ndezë në dritë. Populli i madh ishte mbledhë në oborr të Kishës, njaty në oren 22 erdhi konsulla i Austrisë, Nëprefekti e kafazat. Ky dha urdher që daulla të delte nëpër qytet, mbas tue bertitë "E viva Marie"! Atë natë paten dalë edhe seminaristat, kleri jezuit e freten. Mesnatë fali Zoti një shi dhe populli shkoi nder shtëpi të veta, me pritë nadjen. Me lutë festen e Zojës patën ardhë ipeshkvijtë e abati i Mirditës Imzot Prengë Doçi mbajti ligjeraten, mbas meshe funksioni u ba rreth kishës.

b. Korpi i Sh'Prospirit Martir, Pajtori i Shkodrës

Eshtnat e këtij Martiri të Krishtit pushojshin nder vorrezat e Laurentit në Rasë. Vjetin 1767 kjenë nxjerrë prej andej e me 17 korrik të këtij vjetit kjenë vulosë prej Imzot Lendinit Nikoli, ipeshkëv i Porfyrit. Ma vonë Imzot Shtjefen Serimon, Ipeshkëv i Klosit, i shtini në një arkë të drunjtë.

Në Shkoder, Zotni Gjon Serreqi, i ati i Ejëll Serreqit S.J. e pat marrë në Venedik, pru në Shkodër e ruejtë me shumë nderime në shtëpi të vet. Por Sh'Prospri do që t'ia nderonte korpin jo vetëm një konak, por mbarë populli i Shkodrës.

Gjon Serreqi kishte një rob shpiet, të cilin dukej si me e pasë zaptue djalli, s'kishte punë të çlirohej. Një prift i dioqezës së Zadrimës, në za për shejtni, i tha Gjonit që t'ia epte Sh'Prospirin Kishës, Pra, në vitin 1845 kje çue korpi i Shejtit në qelë dhe kur të ngrihet kisha e madhe, të çohet dhe të lehet atje. Për një që u hoq Shejti shtëpiet, ai rob, që dukej i djemnuen, u lirue.

Në qelë të Shkodrës Sh'Prospri rrinte tue pritë ditën e të shkuemit në kishë të madhe, por ajo ditë po vononte me ardhë.

Me 29 maj 1884, kje shtie në një arkë tjetër, të cilën arqipeshkvi plak Imzot pashko Guerini, e vulosi me dyell të kuq.

Kur erdhi koha me u çue prej qelet në kishë të madhe, e veshen me një petk ma të bukur, e shtinë në një arkë ma të hijshme, e vune përbri edhe një enë me gjak të tij të derdhun për dishmi të Jezu Krishtit. Me 9 gusht 1901 i kje qitë në qelë nderimit e populli rrani me shumicë.

Me 11 gusht 1901, me lulëzim të madh, tue pri një varg i gjatë, prej vajzave Stigmatine, djemtë e shkollës françeskane, kompanitë e Katedrales, kompania e Zojës Rruzare, Kongregacioni i Zojës Nunciatë, Treti Urdhen, françeskanët, seminaristat e Kleri, printe daulla e Katedrales, e ndjekë prej mbarë popullit kje bartë e çue në kishë të madhe.

Kongregacioni i Shejtë caktoi me ia lutë festen në të diellën e dytë të korrikut.

Populli i Shkodrës ka pasë një nderim të madh për te.

Rishtas, për 18 vjet, në qelë të Shkodrës, lufta Ballkanike që rrenoi e shkrettoi qytetin tonë, pa kursye as Kishen e Madhe. Prandaj Shejtit iu desh m'u largue andej. Kje ruejtë me nderim në një odë të veçantë të qelës, prej kah, zhdukë syve të popullit, vijonte tue nda hire e nderna atyne që thirrshin nder travajë.

Në Kishë të Madhe për së dyti. Megjithëse mbas luftës, mujti me u ndreqë kisha e madhe me ngut, vendi i veçantë i shenuem për korp të Sh'Prospirit, lteri i Zemres së Krishtit, s'mujti me mbërrijtë në gjysmë me bartë në gji të vet këte Visar. Kje arsyeja që kje lanë Shejti aq shum në qelë të Shkodres.

Me 1931, me ndihmë të Zotit, erdh koha që Shejti mund të kthente në vendin e vet. Kje dita 29 qersher. Në oren 9.30 duel proçesioni prej oborrit të qelës, muer kah kisha e

madhe. Përbahej prej jetimëve, vajzave Stigmatine, xhakojve të fretenve e të seminarit. Gjashtë meshtarë, dy françeskanë e katër jezuit bajshin trupin e Shejtit, e mbrapa vinte Shkëlqësia e Tij Imzot Lazer Mjeda arqipeshkëv "cappa magna".

Në oren 10 filloi meshë pontifikale. Mbas ungjillit i nderti Imzot Gaspër Thaçi zhvilloi themen "Kisha nuk des".

Gjithë ditën populli shkante e hiqte mall në Shën Prosprin që ia ka dishmë syni tash sa vjet"

D.L.S. (Nga "Lajmëtari Zemres së Krishtit", 1931)

V.O. Para vitit 1901 trupi i Shejtit ishte i vogël e kryet e madh e fëmijëve u bante përshtypje. Trupi i Shejtit u çilte për nderim me 25 qershuer, ditën e Sh'Njonit, e populli shkante me iu lutë. Arka e dytë e Shejtit ishte me xhama që sot mban në gji 10 copë rrashta martirësh, të cilat atëherë ishin të vendosuna nder dy arkë që sot janë; njena te lteri i Shën Mërisë Magdalenë mbushë me rrelike, tjetra në lter të Shëna Ndout. Qela e vjeter ishte në të himë në rrugë të gjanë e para rrugicë që edhe sot shifet dera e oborrit, me qemer, ku kje kisha, e qela asht lulishte që para ishin Vëllaznit e Shkollës Katolike e mandej kje Seminari Françeskan.

Asokohe ishte famullitar Imzot Jak Serreqi, kur u bajt trupi i Shejtit d.m.th. 1901.

Inxhinier Kolë Idromeno Arseni, piktor e skulptor me za, pati hijeshue tue i veshë kryet e Shejtit në gjeso, duert e kambët dhe iu zbukurue arka, që sot mban trupin e Shejtit.

Qela e moçme ishte e gjatë e pa gungë, lteri i madh ishte po njaj si deri tash vonë kje në qelen e re, e sot gjindet në Katedrale. Ky lter mbante fuguren e Jezu Krishtit, anash ishin dy si lterë të vogjël ku më to pushojshin dy arkat me xhama që mbajshin mbrendë nga 5 copë rrashta të Martirëve.

Në anë të djathtë ishte një lter i vogël. Mbi te ishin tri truporet e Konakut Shejt. Këto tri trupore d.m.th. Zoja, Krishti Fëmijë e Sh'Jozefi, pushojshin mbi një arkë të gjatë me xhama e mbante rrelike të ndryshme martirësh dhe dy copa eshtnash të mëdha të Shejtes Ursul martire e sot gjindet te lteri i Shën Lorencit Martir.

Në anë të majtë të lterit të madh ishte lteri i Zojës së Dhimbëshme që mbante trupin e Shejtit siç kjenë në qelë të re, në fund të Baptistërit. Zef Prenka.

c. Dyqindvjetori i Shën Luigj Gonzagës

Me 13,14,15 u ba triditëshja e 200-vjetorit të Sh'Luigj Gonzagës. Nder këto ditë nadje në oren 7.30 u banë ligjeratat, ashtu edhe në oren 5.30 mbas dite. Ligjeruen Sh. Nd. Zotni Dom Gaspër Thaçi, famullitar i Dajçit të Zadrimës, Atë Zef Saraçi S.J., Atë Anton Harapi O.F.M. e Atë Çiprian Nika O.F.M.

Kisha qe stolisë ma së mirit prej Komitetit që qysh prej vjetit të kaluem, kje ngritë; trupi i Sh'Luigjit u vu në mjedis të Kishës rrethue prej 100 copë lilash e prej qirash. S'mbet kush pa ardhë nder funksione e deri ortodokës e myslimanë, kjenë pa me shumë lulëzim.

Me 15 u festue kremtja; natën e kremtes kje ba një ndriçim me kandila nder tanë kumbonaret e kishavet. Me 16 në oren 8 u tha mesha pontifikale prej Metropolitit Imzot Lazer Mjeda. Në këtë meshë u kunguene ma se 1700 djelm e vajza, ku morën një kujtim të Shën Luigjit me predk të shtypun mbrapa. Mbas meshe Metropolitit bani një predk, mbrapa lexoi telegramin që Shejti Atë Papë ia çoi Komitetit per këtë rasë. Mbrapa Imzoti bekoi dy flamurë të Kolegjës Saveriane.

Mbas dite në doren 2 filloi procesioni, i cili, edhe pse ra pak shi, kje ba gjithnjë e kaloi nëpër rrugë Canej, Rus, Fushë Qelë, Spitalit, Miss Durham, Arra e Madhe e kthei në

Kishë të Madhe.

Në këtë procesion ku morën pjesë të tanë nxanësit e nxanëset e mësojtoveve katolike, të tanë kleri, shoqnia "Bogdani" me daullë, kompania, daulla e Bashkisë, kleri e tetëdhjetë ushtarë, u da në shej karroja e triumfit e ngrehun prej kater kuajve, ku mjedis ejësh e lulësh, kje bartë truporja e Sh'Luigjit.

I kje dhanë me ngranë 650 të burgosunëve (shumë kjenë prej Shalet, Shoshit e Dukagjinit, duket se paten çue krye kunder regjimit) pa ndyshim besimit. Me 17 kje shfaqë melodrami i Jetes së Sh'Luigjit bamë prej meshtarit Atë Gjergj Fishta O.F.M. Shpenzimet u banë me lëmoshë të popullit e kjenë mbledhë 6000 korona argjendi. 25 napolona flori fali Presidenti i Republikës Ahmet Zogu.

Komiteti i fali Kishës së Madhe trupin e Sh'Luigjit e nja 650 metra pelhurë per stoli. Gjithë populli i Shkodrës mbet i kenaqun për lulëzim me të cilin u lut kjo kremte e shumë dobi u xuer kah shpirti prej mbrojtësit të masës së re Sh'Luigj Gonzagës.

Komiteti kje përba prej 25 djelmoçave shkodranë. Kryetar kje Z. Kolë Krajni e administratorë: Atë Gjergj Fishta, Atë Lorenc Viezzoli S.J. Atë Vinçenc Prennushi O.F.M. Atë Zef Naraçi S.J. e Dom Pjeter Gjura. S' duhet me harrue se mesha e madhe kje këndue prej 40 kangtarëve e 8 violinistave, drejtue prej shumë të Nderuemit Z. Dom Zef Pukës e të Atë Kornelo S.J.

(Marrë nga ditari i famullisë së Shkodrës)

d. 700-vjetori i Sh'Françesk Asizit

Me 29, 30 e 1 tetuer filluen funksionet e të kremtes së 700-vjetorit të Sh'Françesk Asizit, në oren 6 mbas dreke.

Kisha Katedrale kje stolisë per bukuri me të holla që mblodhi Komiteti; prej Z.Kolë Idromenos kje pikëzue Sh'Françesku, në Lumni e ky kuader kje vu në lter e rrethue me drita.

Nder ato tri ditë kje thanë pjesa Rruzare e mbrapa u banë ligjeratat prej Atë Gjergj Fishtës, prej Dom Gaspër Thaçit e prej Imzot Luigj Bumçit. Bekimin e të parës natë e dha Atë Pashko Bardhi, Provinçiali i Fretenve, në të dytën natë e dha Imzot Luigj Bumçi, ipeshkëv i Lezhës dhe në të tretën natë e dha Imzot Gjon B. Della Pietra, Delegat Apostolik.

Me 1 tetuer në mesnatë u tha mesha me kangë prej Dom Pjeter Gjurës e u banë 1500 kungime trimash enga të rijtë.

Me 2 tetuer, në oren 8 filloi, mesha pontifikale këndue prej Imzot Lazër Mjedës arqipeshkvit tonë e mbrapa bani predkun nadje e në këtë meshë u kunguene nja 900 vetë. Në oren 3.30 filloi procesioni nëpër qytet e mueren pjesë të tanë kongregacionet, kompaninat e shkollat. Paradite në oren 11.30 i kje dhanë me hangër 140 të vobektëve. Të shtunden, me 1 tetuer në mbramje, u kje ra të tana kumbonëve të qytetit.

Komiteti me qender në këtë zyre e i për bamë prej Dom Pjeter Gjurës, Atë Gjergj Fishtës, Atë Vinçenc Prennushit O.F.M., të Atë Zef Saraçit S.J. e Atë Mark Harapit S.J. prej ZZ. Kel Palit Kryetar, Tef Prelës anëtar, Filip Gjonej sekretar, Kristo Jakovës, Cuk Radojës, Cuk Bardelit, Lec Kukës, Gjon Hilë Gegës, Zef Harapit, Kolë Demës, Kolë Jovanit, Lin Jorganxhisë veptoi me shumë kujdes e zell e tanë populli mbet i kënaqun shpirtnisht e korpnisht.

Kje lypë me iu ngjitë një rrugice emni i Sh'Françeskut e i kje dhanë rruga Karl Topija. U porosit në Trieshtë një medalje më fytyrë të Shejtit që do të vehet në mur të kuvendit të

motrave Stigmatine.  
(Marrë nga ditari i famullisë së Shkodrës)

dh. 700-vjetori i Shënandout

Prej 7 deri me 13 mars 1932 kje java Antoniane për kremtimin e 700-vjetorit të dekës së Shëna Ndout. Për këtë qëllim, qysh me 9 qershier 1931, Shkëlqesia e Tij kishte mbledhë në pallatin Arqipeshkvner të ndertin Atë Vinçenc Prennushi O.F.M., Provinçiali Françeskan, Imzot Gaspër Thaçin, famullitar, e tjerë rregulltarë e shekullarë për formimin e një komiteti tue marrë kryesinë e nderit vetë Shkëlqësia e Tij Imzot Lazër Mjeda, arqipeshkvi ynë. Kryetar efektiv Imzot Gaspër Thaçi me nënkryetarë: ZZ Lec Boriçin e Ndreka Kaçulinin anëtar; Z. Lazer Pistullin, që s'e pranoi de facto pse i sëmundë, kështu që iu la barrë kjo zyre, Ndihmës famullitarit Dr. Tomë P. Laca. Nder sa mbledhje posë anëtarëve shekullarë që kjenë, mjaft morën pjesë P. Provinçiali ose P. Bardhi, Pader Anton Harapi, krahu i djathtë i Imzot Kryetarit. U caktue: 1) M'u ba java Antoniane 2) M'u ba një sheti Padovë-Romë 3) M'u ba gost e të varfenve 4) Një triditëshe nder freten per festë të Shejtit. Java Antoniane duel ma së mirit. Për këtë rasë Katedralja kje zbukurue ma së mirit me pelhura që u blenë për të tana shtyllat; për kunorë velash në mjedis të kishës mbi trupore të Shëna Ndout naltue një gajther të madhnueshëm rrethue me lila, qira e lule. Nalt, kunora rrethue mbrendë me gota elektriku. Ashtu edhe në lterin e madh fugurja e Zojës rrethue në gota të mëdha (tue hjekë ata bojna të vjetrueme) filloi këtu, të shtundën, ndertimi i kishës më punëtorë e me ndihmën e motrave Stigmatine, Moter Provinçialja e M-Konsile Muzhani. Për ditë nadjë mesha me kangë, për gra në oren 7.30 te lteri i Shejtit mbrapa konferenca; pastaj në lter të madh, para rrelikes së Shejtit, si Queris Miracula e bekimi me rrelike prej çelebrantit.

Në mbramje në 6 Rruzarja, pastaj konferenca e mbrapa bekimi lumnisht.

Të hanën me 7, në oren 5.30, do t'u barte truporja e shejtit me procesion prej kishës së Fretenve deri në Katedrale, për shkak të shiut u la për të nesërmën. Megjithëkëtë në 6 Katedralja mbushë. Xhakojt e seminarit me një meshtar të famullisë premtuen Rruzaren. Mbrapa Imzot Gaspër Thaçi çili javen me themën "Rilindja shpirtnore". Bekimin e dha P. Guardiani (E. Paliqi) tue pasë për asistenta dy françeskanë. Sherbyen seminaristat, të cilët erdhën mbarë; ashtu apostolikët e xhakojt e fretenvet. Në të tanë javen, në mbramje, kori françeskan nën drejtimin e Pader Martin Gjokës.

Të martën me 8, në oren 8.15, bartja e trupores së Shëna Ndout privatisht, megjithëkëtë populli u mbledh si ranë kumbonët e fretenvet e të Katedralës.

Në orën 7.30 filloi mesha, ku kënduen kolegjarët e françeskanëvet. Mbrapa Pader Anton Harapi mbajti konferencën "Të pertrimt e grues katolike". Mbrapa si Queris Miracula në lter të madh kremtin i relikes dhe Bekimi.

Dr. D. Thomë P. Laca (Marrë nga ditari i famullisë e Misioni që u ba në Shkodër në muejin tetuer të vitit 1896 dhanë prej misionarëve jezuit).

Fugurja e Zojës së Hyjnueshme e Jezu Krishtit tue dekë, së pari në Shkodër pruni hire të panumërta e solli mëkatnorë të mëdhaj, njaja vetë prap tue u dukë në kishë të madhe të këtij qyteti, shprazi hire e të mira gjithfarësh permbi këtë popull nepër mision që iu dha. Binte shi me rrëshkë e moti gjithnjë u diftonte i keq. Reja e zezë nuk iu dante qiellit të kandshëm e të bukur të Shkodrës; për net të mira pak uzdajë ishte. Erdh Zemra e Krishtit e moti në ças u mbajt i mirë deri sa ngjati Misioni i Shejtë. E shka po tham vet per mot? Njerëz, mkatnorë ndërroi e suell Zemra e Krishtit. E njimend, porsa u ndie, ditën e festës

së Zojës së Shkodres, që të ejten që vinte po fillonte Misioni, ky za që kje zani i Zemres së Krishtit, porsi vetimë u përhap nder të gjithë shtëpiat e qoshe të Shkodres e përshkoi zemrat ma të ftohtat e me një trishtim të ambël i çoi prej gjumit. E kur të ejten mbasdite ra kumbona e bekueme e Kishës së Madhe, në atë za të trashë u ndiente zani i ambël e i mrekullueshëm i Zemrës së Krishtit. Ai thirrte Shkodrën në pendim e në pendesë. Kështu u çil Misioni e në lter të madh kje vu fugurja e Zemrës së Krishtit që asht e kishës së Jezuitëve e në anë të majtë ka shkohet në kishë kje vu bajraku i Zemrës së Jezu Krishtit, me gjithë ato nevojtarë që ka rreth vedit. Me shumë lulëzim u ba fillesa e Misionit e të tanë shkodranët në atë kohë që ra kumbona, mbyllë dugajët e veta, lanë punën e me tuba shkuene te kisha me ndie zanin e Zemrës së Krishtit. E bani predkun i nderti Misionar e njikaq Zemra e Krishtit tingëlloi nder zemrat e gjithkujt, për gojë të meshtarit, sa në vaj shumkush a zhgrehën tue e pa jetën e mbrapshtë që kishin shkue, një kjahmet të madh na kishte zemra; e kur u thonte mishirë o Zot, mishirë o Krisht, loti s'e pritte lotin, e verdh fytyrë e u ishte zbehë, njikaq pendim e mëni për mëkate të veta që kishin marrë. U mbarue predku bukur vonë, e mbrapa kje dhanë bekimi në të Shejtnueshmin Sakramend. Kështu kje ba përgjithë natë sa ngjati Misioni, e populli tue dalë prej kishet e tue kthye në shtëpi, por sidomos fëmijët, ia fillojshin uratëve të Zemrës së Jezu Krishtit që për mëshirë të vet na ka lanë gjallë me e pa këtë ndjesë të madhe e me i ndreqë hesapet e shpirtave tanë.

Të premtën e të shtundën s'kje ba kurrkund mësim, e kështu fëmija kjenë të lirë me shkue ne kishë e m'u mësue nder uratë e nder punë të shpirtit. Të shtundën kjenë rrëfye te tanë fëmijët, djem e vajza, e të diellën iu dha me shumë lulëzim kungimi shejt tue iu falë për kujtim të kësaj ndjese ka një kryq. U banë edhe tre proçesione rreth kishës nder të cilët nder tre vende u ndalue misionari e bani me kryq me dorë predikime të shkurta dhe të rrepta, që përshkuen zemrat më të fortat. Ah po! Janë njerëz të cilët kishin ardhë në kishë për me pa, por tue ndie fjalët e Zemrës së Jezu Krishtit që delshin prej gojës së meshtarit të bardhë, iu kthye mendja, iu perkul zemra e u kthyen kah Krishti. S'ishte kush që tue ndie ato fjalë shgjetore, s'do të thoshte me Sh'Palin "Fol o Zot, çka lypë prej meje, pse qe sherbëtori yt gadi me të ndigjue". Do të kallëzoj edhe nder predke të proçesionit, ashtu edhe të tjera predke, të tanë populli bërtite të madhe: "Mëshirë, o Zot; mëshirë, o Krisht" e kështu loti shumkuj i cikëronte në faqe aq, per sebet të atyne fjalëve. Zemra e Krishtit ia kishte zbutë zemrën e i bante me lotue mëkatet.

Të premtën (30 tetuer) kje ba predku i hallallit, e njikaq Padre Misionari me kryq në dorë foli për këte nade, sa të tanë populli për një gojë bërtiti: "Hallall! Hallall!"

E përnjimend në turr gjindja shkuen te krygja me e puthë tue i thanë me za të naltë, "hallall" fajtorëvet të vet. Do t'i bajshin hallall njatyne që kishin folë keq per te, do atyne që u kishin shkarkue e marrë ndera, dikush fali gjakun e babës, dikush të kushrinit, dikush të ilakasë, ndiç kurrkush s'mund t'i thonte Zemres së Krishtit me jo. Në mbramje në 1 e gjysem sahati rrahi kumbona e madhe, e kje kumbona e hallallit, perse te tanë shtëpiat e hallallisen me shoqishojnë. S'mjaftoi të premtën mbramje, por edhe të diellen kje dhanë kungimi me të madh gazmend tue iu falë secilit kah një kryq e shumkuj edhe kah një fugure me amanet të Misionarit. Kungime kjenë ba 5000 e ma tepër. Por unë thashë ma sipri se doli fugurja e Zemrës së Krishtit. Padre Misionari, porositi me pru qira e peshqeshe te Zemra e Krishtit, e njimend gjindja prunë sende sado të vogla. Prandej u mbush lteri me qira sa u dukte si me e ndezë flakë, ia filluen peshqesheve e populli i devoçëm s'la gja pa pru te Zemra e Krishtit; pelhurë, peshqirë, riza, bohçe, grykësa,

çarçarfa, facoleta, pëlhurë mëndafshi e pambuku fort të bukura, xhamadana, breza, çorapë e këpucë; madje edhe sende arit, sikurse florijtë, medajat të kushtueme, relike, sahata kjenë çue edhe fugure, zemra të bukura, lule letrash e pemë gjithfarësh. Po, deri fëmija i vogël e të vorfent prunë çka i mjaftoi zemra, të tanë e diftuen dashuninë e vet per Zemrën e Jezu Krishtit. Por një dashuni ma të madhe e diftuen do që ia falen zemrat e veta Zemrës së Jezu Krishtit, tue i ba kurban jo vetëm veset e këqija, por edhe hallallet me të cilat kishin fye Zotin, due me thanë prunë letra lejet, zare, domino, letra me kangë të këqija e libra të mbrapshta e të zez. Kje mbushë gjithkah lteri i Zemrës së Jezu Krishtit me asi peshqeshesh sa s'ishte vend ku me i vu. Këto tesha nder të dielle që erdhën mbas misionit kjenë shitë n'oborr të kishës e me gjithë paret që u mblodhën në cashë janë ba njiqind napoliona arit. Priftit e qelës i kanë porositë një fugure të madhe të Familjes së Shejtë e një fugure drunit (statua) e Zemres së Jezu Krishtit e cila ka m'u vu në Kishë të Madhe në lter që asht shenjue per te. Kështu të diellen me 1 të nandorit, festa e të gjithë shenjtëve u mbyll ndjesa e misionit me shumë shyret e popull shumë. Mesha e predku i mbramë ngjatën deri mbas mesditet. Mbasi u dha bekimi me krye me ndjesë të plotë dhanun prej shejtit Atë Papë, populli s'mujt me e lëshue kryqin prej gazmendit të Zemres së Krishtit, pru për sebet të atyne misionarëve të bekuem. Që atë ditë e mbrapa populli i Shkodrës asht xé ma fort per punët e fesë e me diftue vetveten të krishtenë përnjimend. Tash në Shkodër bajraku i Zemrës së Krishtit asht açik; s'asht marrë si përpara me u diftue taman i krishtenë, me i kundershutue atyne që flasin keq. Kangët e vallet e ndyta janë harrue, por ka rrokë djelmninë devocioni, urata e kangët e fesë shejte. Ashtu bre, o Shkodër, qindro tue e mbajtë fenë e të parvet, të bijë nder mend mundet, hallet, frikët grahinat e gjakun që derdhën për hater të saj. Mos të rrejë i krishteni i koritun, eretiku tinëzari e mbaju gjithmonë me Zemren e Krishtit e mos u daj kurr devocionit të saj. Një shkodran (Marrë nga "Elçija e Zemres Krishtit, viti 1897).

Imzot Ernest M. Çobës, ka një kuadër origjinal folklorik, ku paraqitet personeli që muer pjesë para 100 vjetëve në kremtim. Vepra asht e perfundueme nga Dom Injac Dema. Kuadri asht i gjanë 8 metra dhe i naltë 3.50 meter.

Dokumenti i kuadrit: Bekimi i Gurit të Kishës së Madhe: 7 Prill 1858

Veper e piktorit prof. Simon Rrota e e perfundueme nga Dom Injac Dema

Te qendra: Imzot Gjon Topiq O.F.M. ipeshkëv i Shkodrës. Rreshti i parë: (në e djathtën e atij që këqyrë): 1. Atë Djegu nga Torini O.F.M. sekretar i Imzot Topiq. 2. Dom Mikel Naraçi (Vogli) nëndiakon, ndihmës famullitari. 3. Dom Pal Serreqi (18 vj.) 4. Dom Ejëll Radoja, presbiter asistens, famullitar i Shkodrës. 5. Imzot Luigj Çurçija O.F.M. ipeshkëv i Lezhës. 6. Ustah ... muratori i kishës. 7. (poshtë Kolë Suma (fëmijë, me dhuntina në tabake). Rreshti i parë. (n'e majtën e atij që këqyrë): 1. Dom Ejëll Tanushi (Zorba) diakon, ndihmës famullitari. 2. Dom Mëhill Feri (Shejtani) xhakue 20 vj. 3. Dom Pashko Babi (Sheqeri): xhakue 15 vj. Poshtë: 4. Pjeter Çoba (fëmijë). 5. Gurash Shënkolli. 6. Dom Zef Gurakuqi (fëmijë 14 vj., me fugure e Zojes). 7. Gjush Rrota (fëmijë). 8. Dom Ndoc Spathari (fëmijë 8 vj.). 9. E shoqja e Bajraktarit të Shoshit Marka Dungës. 10. Margjela e Bibë Dodës. 11. Dom Pal Shantoja (fëmijë). 12. Dom Pjeter Gjollala (fëmijë). 13. E shoqja e Batalakit. 14. Drandja, e bija e Gaspër Muzhanit (e shoqja e Palok Zadrimes). Rreshti i dytë: (n'e e djathten e atij që këqyrë): 1. Dom Zef Lisna (32 vj.) 2. Atë Zef Guagliata S.J. 3. Dom Lorenc Ashiku (31 vj.) 4. Dom Ndre Logoreci (23 vj.). 5. Dom Ndre Goka (38 vj.). 6. Bibë Doda, princ i Mirditës. 7. Dom Mikel Shirqi (xhakue, 22 vj.).

8. Tush Kapidani. 9. Konsulli i Ruisisë Illiç. 10. Konsulli i Francës, Hiacint Hecquard. 11. Syndekenini. 12. Avni Pasha, Vali i Shkodrës. 13. Hafiz Daut Efendi Boriçi. 14. Konsulli i Anglisë Spiridion Bonati (59 vj.).

Rreshti i dytë: (n'e majtën e atij që këqyrë). 1. Dom Zef Bumçi (62 vj.). 2. Imzot Pal Dodmasej, ipeshkëv i Pultit. 3. Imzot Pjeter Saverini O.F.M. ipeshkëv i Sapës. 4. Jak Vasija (53 vj.). 5. Dom Agustin Barbullushi (xhakue 23 vj.) 6. Marjani nga Palmonova O.F.M. 7. P. Simon Berisha ndihmësfamullitari. 8. Dom Pal Ramadani, ish famullitar i Shkodrës. 9. Atë Klaud Stanisla Neri S.J. Rektor i Jezuitëve. 10. Dom Pjeter Çasi. 11. Dom Mati Radovani (24 vjeç). 12. Atë Dario Bucciarelli O.F.M. 13. Dom Ndue Shllaku (29 vj.). 14. Atë Albert Cracchio O.F.M. 15. Atë Gianpiero de Bergamo O.F.M. 16. Drandja e Arsenit. 17. Gjin Barbullushi (50 vj.) në vj. 1860 u rrenuen tue punue në Kishë). 18. Dom Jakë Zorba (40 vj.). 19. Çun Mula, bajraktari i Hotit. 20. Jak Bisaku (Bojaxhija) (84vj.). Arkitekti i Katedrales inxhinieri austriak. 22. Simon Shiroka. 23. Marash Uci. 24. Gjon Viçi (sakristan). 25. Nikë Luca. 26. Bajraktari i Oroshit Marka Prenga. 27. Terezja e Dodmasej (E ama e Imzot Dodmasej (70 vj.) 28. Mati Papa. 29. E ama e Dom Jak Satës (Bushatit). 30. E ama e Dom Ejll Radojës. 31. E shoqja e të birit të Filip Lllupit. 32. E shoqja e Simës Zef Simonit. 33. E motra e Dom Ndre Sarahoshit. 34. E reja e Jak Biankut.

Rreshti i tretë: (n'e djathten e atij që këqyrë): 1. (Permbi kryet e Imzot Topiq) Gjon Serreqi (i ati i Atë Ejll Serreqit). 2. Jak Zefi (i ati i Imzot Lazer e Dom Ndre Mjedës). 3. Pema. 4. (mbi kryet e Pemës) kafazi i konsullit të Francës. 5. (prap mbi kryet e Pemës) kafazi i konsullit të Anglisë. 6. Prekë Nikolla (i ati i Dom Zef Pukës). 7. Haxhi Myftari, kafaz i konsullit të Austrisë. 10. Kolë Çoba. 11. Kafazi i konsullit të Greqisë. 12. Loro Kraja. 13. Jak Gjonej (84 vjeç). 14. Ndoc Gjinaj (Xhuxha). 15. Lukë Gjura (i ati i Imzot Pjeter Gjurës). 16. Ndrekë Suma (Hiqizani). 17. Kolë Markiçi. 18. Bajraktari i Shoshit. 19. Mati Ujka. 20. Bajraktari i Nikçit. 21. Koçobashi. 22. Plaka nga Vermoshi. 23. Bajraktari i Shkrelit Marash Vata. 24. Ndrekë Shiroka. 25. Tush Lazri. 26. Bajraktari i Shalës Mark Lula. 27. ... Puka. 28. Ndoc Çeka. Suma.

Rreshti i tretë: (n'e e majtën e atij që këqyrë). Kafazi i konsullit të Ruisisë. 2. (permbi Kolë Zadrin) Ndoc Kiri. 3. Kolë Kaurri (i ati i Imzot Jak Serreqit). 4. Shan Katrina (Leka). 5. Haxhi Gjoni. 6. Tush Gjona (Dodmasej). 7. Gjokë Muzhani. 8. Zef Simoni. 9. Dom Mati Begu (i ri 18 vj.). 10. Atë Ludovik del Szaso. 11. (permbi Atë Ludovikun) Filip Lllupi (84). 12. Ejll Çoba. 13. Shan Hila. 14. Dom Zef Shestani. 15. Zef Zorba. 16. Gjon Curani. 17. Dedë Jakupi. 18. Lacë Pistulli. 19. Tomë Volaj (29 vj.). 20. Gjergj Benusi (mësues 57 vj.). 21. Kamsi. 22. Pjeter Marku (i ati i Dom Loro Cakës). 23. E ama e Dom Lazer Liznes. 24. Mani. 25. Boriçi (Gjyshi i Lecit). 26. Gakati (Dragusha). 27. Berdica. 28. Gjokë Duçja (Nikaj). 29. Gjyshja e Shaqe Kadarës. 30. Vatë Shkreli. 31. Thaçi (Gjyshi i Imzot Gaspër Thaçit). 32. Pashko Saraçi (i ri, i ati i etenve Ndoc e Zef Saraçit). 33. ... Bazhdari (Gjyshi i Atë Gjon Bazhdarit). 34. Tusha Vasa. 35. Zadrina (i ati i Atë Gaspër e Shtjefen Zadrimës). 36. Mati Milet. 37. Arsen Idromeno, arkitekt. 38. Jak Vjerdha. 39. E shoqja e Ndoc Gjinaj. 40. (permbi te) Loro Çefa. 41. Zef Ndokillija. 42. Ndoc Mazi. 43. Jak Pilota. 44. (mbi Jak Pilotën) Staka. 45. (nën Jak Pilotën) Ninja e shoqja e Nushit. 46. Jak Speci (mësues). 47. (nën Jakë Speci). E ama e Dom Loro Nënshatit. 48. Tush Rrokacolli. 49. (permbi Tush Rrokacolli) Ndoc Lacë Bufli. 50. Madamë Apostollaqi. 51. (permbi madamën Apostollaqi) Jak Pepa. 52. Dr... Simoni. 53. Konsullesha e Francës: Madama Hecquard. 54. Mati daberdaku. 55. (në mes Gjon Viçit e



Marash Viçit) E ama e Dom Ndre Cakës. 56. (përmbi te) E shoqja e Foto Cakës. 57. (Permbi Gjon Viçin) E ama e Hilës së Vashës. 58. (përmbi krye të Nikë Lucës) Gjon Dushi. 59. Ndoc Ndreca. 60. (Përmbi Ndoc Ndrecën) Mark Vuka. 61. (permbi krye të Mark Prengës) Kolë Ashiku (farmacist). 62. Ndoc Toska. 63. Nikollë Gera. 64. Bumçi. 65. (nën kryet e Bumçit) Pashko Keka. 66. Kakarriqi. 67. (nën krye të Kakarriqit) Kolë Koliqi. 68. Sekuj. 69. Pashko Gurakuqi. 70. Lush Krroqi. 71. I ati i Palok Kurtit. 72. I ati i Frano Ndojës. 73. Topalli. 74. (nën Kurtin e Topallin e Ndojës) i atii Cin Jakovës. 75. Baxhari (katundare). 76. Grue Çunajsh. 77. Mar'Ndou Gjyshi i Tush Bernardin Shllakut). 78. E ama e Dom Gjon Vatës. 79. I ati i Simon Kryqit. 80. Geci. 81. Nalla (Gjoka). 82. (nën krye të Gecit) E shoqja e Anastas Papnikut. 83. Kominaci. 84. Baba. 85. (nën Babën) Cungeli. 86. Gjergj Ndoka (gjyshi i Frrok Gjush Sheldisë). 87. E ama e Dom Nikollë Dojanit me të birin 1 vjeti). 88. Prela. 89. Pali. 90. (nën Palin) Darragjati. 91. Zojzi. 92. Filip Çulli (Guraziu). 93. Kushë Micja (mësuese). 94. I ati i Hilë Marinit. 95. Gjystja e Hilë Marinit. 96. Boriçi. 97. Palok Krandja. 98. (nën te) Tina e Nikë Gjergjit. 99. Beltoja (Pilafi). 100. Grizha (Naraçi). 101. Gjon Mark Pyka. 102. Lacë Kolë Shiroka. 103. Kumrija. 104. Një grue Çunajsh. 105. Kolë Kaçulini. 106. Harapi. 107. Tereze Berdica. 108. Lush Bushati. 109. Mileti. 110. Lufi. 111. (permbi Lufin) Shaperkata. 112. Çapaliku. 113. I ati i Filip Shirokës. 114. Ndoc Simoni Gjadri. 115. Shpori. 116. Harusha. 117. Shpori. 118. Dema (Gjyshi Imzot Pjeter Demës.). 119. Pjeter Marubi arkitekt e fotograf.

### **Kremtja e Zojës së Shkodrës**

Edhe në kje se në qytetin e Shkodrës, simbas shumë historianëve e nder të tjerë dhe të Atë Marin Sirdani, me titull "Nana e Këshillit të Mirë" nuk u njof Zoja e Bekueme, e prandaj duket se këtë titull e muer pse në Gjenacan u nderonte në këtë (e kështu i mbet edhe fugurës që mrekullisht në Gjenacan); prapëseprapë qysh në kohë të vjetra, sikur na ban dishmi Biemi e tjerë, u thirr me titullin "Zoja e Shkodrës" "La Madonna de Scutari". Prandaj edhe para se t'u ndertonte Kisha Katedrale sikur gjindet në kalendarin kishtar të vj.1857 u lutte me miq e kremtja fokloristike e Zojës së Shkodrës në tetuer; atëherë të hanën II mbas së dielles së tetorit, dhe me ndertimin e Katedrales mbas III dielle të tetorit.

Për gjithë vjetë nga fshatrat e malsinat rrajshin sikurse rrajnë edhe sot, te kisha e madhe, jo vetëm për meshë pontifikale e predk, por edhe për t'u gjetë në proçesionin e divoçëm me relike të Zojës, të cilën e printe truporja e drunit e Zojës së Shkodrës e bartun nga paria e qytetit.

Në proçesion silleshin kompanierët (të cillët tash nuk ekzistojnë ma) me flamurët e ndryshëm, tue thanë Rruzarën e tue këndue kangë të divoçme. Ma vonë marrin pjesë kongregacionet dhe shoqnitë, shkollat fetare. Edhe sot vazhdon me të njajtin divocion kjo kremte, burra e gra, qytetarë e fshatarë, e mbushin Kishën e Madhe për gjithë meshë që krye një gjysmë ore celebrhet e veçanerisht në Meshën Pontifikale e proçesion, që vullnetarisht siellet pjesa e madhe e popullit të pafarë.

Qysh në vjetin 1956 kremtja e Zojës së Shkodrës (me vendim të Episkopatit katolik Shqiptar) u la për ditën e dielle, kështu edhe vesparet e Zojës, këndohen si këndoheshin netët e kremtes, u lanë për t'u këndue ditën e festës për mbramje.

### **Misionet në Katedrale**

Kontribut të madh dhanë për zgjimin fetar dhe reformimin moral të katoliçizmit në qytetin e Shkodres (sikurse edhe në të gjithë Shqipninë) predket e të Vertetave Kryesore (dhe të mbrameve të njëherit) që u zhvilluen në Kishën Katedrale, me titull "Misione". Në të parin Mision, përpara se të fillonte vepra e madhe e "Misionit Shëtitës" shqiptar themelue nga Apostulli i zellshëm Atë Dedë Pasi S.J. vj.1898 dhe apostulli i Shkodrës Atë Jungu me ndihmën e Dom Pashko Babit e Atë Misionarin prej Sagramova O.F.M. në vjetin 1881, fryti kje shumë i madh. Por Misioni që bani bujë ma të madhe kje ai që u dha në tetuer 1896 nën kryesinë e Atë Dedë Pasit me ndihmë të Atë Jak Jungut, Atë Genovicin e atë Ejëll Serreqin. Në këtë rast u ekspozuen për të parën herë kuadrot e Kolë Idomenos, që edhe sot stolisin Kishën Katedrale.

Në vjetin 1923, nën kryesinë e Atë Frano Genovicit me pjestarë Atë Ejëll Serreqin e Atë Pashko Gjadri, banë misionin e frytshëm nepër vendin tonë.

Gjush Sheldija "Nika", dorëshkrim, viti 1956. Guidë Turistike për Qarkun Shkoders, viti 1957, etj., etj.

---

## **Gjush Sheldija (1902 - 1976)**

### **Shënime biografike**

-- nga Kolec Çefa

Në fushën e arsimit dhe të edukimit, gjatë periudhës së para luftës, Gjush Sheldija i dha ndihmesë modeste shkollës e kulturës shqiptare.

Ushqyer nga mjedisi patriotik, i rritun në shkollën e jezuitëve, pajisë me përvojë të pasun nga specialistë të letrave shqipe, Gjushi ka meritën se punoi me zell e me vullnet punëtori si veteran i arsimit kombëtar, se mblodhi material të shumtë e të gjithanshëm, se trajtoi tematikë të pasun në kulturën shqiptare, se qe veprimtar i palodhun në shoqni të ndryshme patriotike, si: "Bogdani", "Rozafa", "Shoqnia Antoniane", dhe pjesëmarrës aktiv në shumë veprimtari kulturore të qytetit tonë, sidomos ato teatrore.

Ka lindë me 12 korrik 1902, në Shkodër. Studimet i bani në vendlindje, ku mori maturën pedagogjike, por në pamundësi të studimeve të larta jashtë shtetit për shkaqe ekonomike, ka studiue vazhdimisht si autodidakt, veçanërisht: histori, etnografi, folklor, gjuhësi etj.

Ka njohtë 4 gjuhë të hueja, si: italisht, frengjisht, gjermanisht e latinisht.

Gjatë vjetëve 1921-1944 ka shërbye si arsimtar në fshate e qytete të atdheut; ka marrë pjesë aktivisht në Revolucionin e Qershorit 1924, për këtë asht arrestue e dënue me burgim nga qeveria e Zogut; në fillim të diktaturës ka punue si, herë në muzeum, herë në bibliotekën e qytetit e pastaj, si pensionist i vetmuem, ka mbyllë sytë, më 1976.

Shfrytëzues sistematik e i pandërpreme i kohës së lirë, Gjushi ka një veprimtari të dendun e të larmishme, si:

- 1) krijime origjinale në poezi, prozë e dramatikë,
- 2) artikuj me karakter arsimor, etnografik, historik e arkeologjik,
- 3) mbledhës i pasionuem i materialeve, ndër ma të ndryshmet, i biografive e i kujtimeve të personave historikë, letrarë, luftarë, i toponimisë etj.

Ka botue artikuj e studime në revista e gazeta të vendit, si edhe jashtë shtetit, veçanësisht, në revistat e vjetra shkodrane, si "Hylli i Dritës", "Leka", "Kumbona e së dielles", "Shkodra", "Shkëndija" e Tiranës, apo në gazetatat, si: "Balli i Rinisë", Tiranë, "Afrimi", Vlonë, "Gazeta shqiptare", Bari, si edhe në gazetatat e Shkodrës.

Ka pasë marrëdhënie pune, shoqni e miqësi me Fishtë, Mjeden, Koliqin..., ka bashkëpunue me punëtorin e palodhun të letrave shqipe, A. Zef Valentinin, të cilin e ka ndihmue në punën e tij të shumanshme, siç e dishmojnë letrat e ruejtuna ende gjatë këtij rrebeshi të pamenduem e të paparishikuem. Valentini, Cordignano, Armao etj. e falënderojnë për ndihmën e dhanë, ndërsa autorë të sotëm e falënderojnë ndër letra personale, por jo me shkrim ndër veprat e tyre.

Ka shkruar disa artikuj për historikun e shkollës, si: "70 vjet shkollë: shkolla e Shirokës, 1874-1944", "Shkollat e moçme dhe arsimtarët e vjetër të Shkodrës, shek. XIX-XX", "E para shkollë muzike në Shkodër"; shënime me karakter biografik: "Mësuesit e moçëm shkodranë".

Gjushi punoi mjaft edhe në fushën e krijimtarisë letrare. Ka shkruar novela, tregime, poezi, drama, komedi, monologë e dialogë, të botuem në organet e kohës, disa të mbetuna në dorëshkrime, disa të shfaquna në salonet teatrore të kohës. Në dramaturgji po veçojmë "Kupe Dane" (me dy akte e pesë tablo) dhe dramën "Brahim Gjoci", "Atdheu mbi të gjitha", me një prolog e dy akte; komedi me një deri në katër akte, si edhe përktihme dramash shfaqë në sallat e Kolegjit Saverian nga shoqnia "Bogdani"

Rrallë janë arsimtarë që kanë mbledhë material kaq të shumtë, kaq të larmishëm e kaq të dobishëm. Lidhun me mbledhjen e materialeve në bazë, Gjushi asht një pikë referimi ku duhet drejtue vëmendja e mësuesve të rij, për të mbledhë visarin e popullit. Për ilustrim po përmendim disa historikë, si: "Historiku i teatrit në Shkodër, 1879-1944", me pasqyrë të të gjitha shfaqjeve, të autorëve e të aktorëve etj.; "Historiku e karnevaleve të Shkodrës, 1860-1949", "Historiku i bandave muzikore të vendlindjes, 1874-1944"; "Pazari i Shkodrës dhe artizanati në shek. XIX-XX", pastaj qinda faqesh të daktilografueme për tabakët e Shkodrës, për esnafet, për terzitë, dyfekqinjët e Shkodrës, për veshje, doke e zakone, për humorin e humoristët tanë, ahengun e ahenggjijtë me biografitë e tyre, shënime e biografi për veteranët e historisë sonë etj.

Për hir të rrethanave ekonomike, të detyrimeve familjare a ma shumë të gjendjes politike, Gjushi s'arriti të përmbledhë në vepra të plota ndihmesën e vet folklorike, etnografike, letrare, historike. Sinteza do të qit'et në pah ma qartë veprimtarinë e tij të shpërndame në revista e gazeta, tashma të rralla, të shkrueme e të harrueme ndër pseudonime sot të panjohuna, si: Gjeto Kola, Nji mik, Sheboja, Magister, Nji bashkëpunëtor i ri, Korespondenti, Dikush, 67, 647 etj.